( Punim Diplome për Master )

# UNIVERSITETI I PRISHTINËS

## Fakulteti Filozofik

## ( Dega Histori )

# LËVIZJA KOMBËTARE ILEGALE NË LLAP GJATË VITEVE ( 1981 – 1990 )


**Mentori-ja:**
**Prof. Dr. Emine Bakalli**

**Kandidati :**
**Avdi Gjata**



**Prishtinë, 2011**




**Harta Gjeografike e Rajonit të Llapit**

**P ë r m b a j t j a :**

H y r j a.....6

K A P I T LL I I P A R Ë

1. Koncepti gjeografik i trevës së Llapit.....11

2. Gjendja e shqiptarëve të Llapit 1945-1981.....18
3. Formimi i grupeve ilegale në Kosovë e veçanërisht në rajonin e Llapit 1981-1989.....28
4. Veprimtaria e organizatave ilegale gjatë viteve 1981-1989 në Llap.....32
5. Demonstrata e vitit 1981 në komunën e Besianës.....39
6. Organizimi i mbledhjes për fillimin e demonstratës të 1 e 2 prillit 1981 në Besianë.....44
7. Dënimi i grupeve ilegale shqiptare në Llap gjatë viteve 1981-1990..... 51

K A P I T LL I I D Y T Ë

1 Fillimi i fushatës antishqiptare e Beogradit dhe rezistenca shqiptare.....89
2. Rezistenca e llapjanëve kundër marrjes së Autonomisë nga Serbia.....93
3. Diferencimet ideo-politike të shqiptarëve në Llap.....100
4. Formimi i partive politike legale në krahinën e Llapit.....104
5. Të burgosurit politik shqiptar dhe partitë politike në Llap.....107
6. Qëndrimi i Shqipërisë ndaj ngjarjeve në Kosovë.....110
7. Shtypi shqiptar për ngjarjet e vitit 1981-1990 në Kosovë.....114
8. Shtypi i huaj rreth ngjarjeve të vitit 1981-1990 në Kosovë.....122
9. Vlerësimi i demonstratave të viteve 1981-1990 nga diplomatë të huaj.....125
Përfundimi.....129

# H y r j e

Ballkani si një pjesë e kontinentit të vjetër të Evropës pothuajse gjatë gjithë historisë ka qenë burim i konflikteve të cilat sollën edhe luftëra me përmasa botërore. Pas Luftës së Dytë Botërore, vetëm Federata Jugosllave doli si shtet shumë i fuqishëm e veçanërisht gjatë qeverisje së Titos, që ishte një vend mjaft stabil.

Edhe pse gjatë Luftës së Dytë Botërore shqiptarët kishin marrë pjesë në luftë në anën e shteteve antifashiste, Kosova dhe pjesët tjera shqiptare në Jugosllavi u pushtuan prapë nga qeveria komuniste e drejtuar nga Titoja.

Qëndresa e popullit shqiptar nuk fillon vetëm në dekadat e fundit të shek XX ose vetëm gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj, por ajo fillon shumë më herët se Konferenca e Bujanit se Kuvendi i Prizrenit, se Kryengritja e Drenicës (1945) se shumë e shumë ngjarje të rëndësishme në historinë tonë.

Vitet, pas Luftës së Dytë Botërore ishin vitet e koha kur shqiptarët pa dëshirën e tyre, mbetën në kuadër të Serbisë, e të ish Jugosllavisë. Nuk ishte hera e parë që shqiptarëve iu shkaktohen padrejtësi, por ky ishte mashtrimi më i madh që pushteti komunist jugosllavë në krye me Titon ia bënë shqiptarëve.

Kosova dhe viset tjera në Jugosllavi pas vitit 1945, përsëri u robëruan, dhe shqiptarët përsëri u detyruan që të fillojnë rezistencën ashtu siç i kishte mësuar historia gjatë shekujve me radhë.

Vendosja e administrimit ushtarak(8 shkurt 1945), bëri që shovinistët serbo-malazez me yllin e partizanëve e kthyen Kosovën në kasaphanë të vërtetë. Në emër të pastrimeve nga elementët armiqësor, dhjetëra e mijëra shqiptar u zhdukën pa gjurmë. Në pamundësi për ta duruar këtë dhunë dhe gjenocid, populli gjeti rrugën tjetër të rezistencës ilegale e cila ishte e vetmja rrugë e mundshme dhe e suksesshme. Lëvizja patriotike ilegale në Kosovë filloi në vitin 1945 dhe vazhdoi deri në vitet 1998 me aktivitete të ndryshme e shpërthyese si në vitet 1968, 1971, 1981, 1989, dhe në vitin 1997 kur u formua UÇK-ja e cila iu vu ballë për ballë me ushtrinë e Serbisë.

Pas Plenumit të Brioneve (1966), Kosova fillo të merr frymë më lehtë edhe pse shqiptarët edhe më tutje nuk besonin se do të përmirësohet gjendja e tyre në kuadër të Jugosllavisë që jetonin në trojet e veta shekullore. Në kuadër të situatës së re të krijuar filloi të krijohet krahu i intelektualëve shqiptarë përparimtar që kishte përfunduar studimet në qytetet e republikat tjera të ngre zërin edhe legalisht duke kërkuar të drejta politike, kulturore dhe arsimore të përcaktuara me kushtetutë.

Mirëpo, kërkesat më të fuqishme të shqiptarëve ndodhën në vitin 1968 kur rinia studentore përparimtare vendosi që me anën e demonstratave të kërkoi realizimin e të drejtave të tyre, pasi Beogradi mundohej që t'i neglizhoi ato. Edhe përkundër të gjitha masave që mori për shuarjen me gjak me anën e tankeve dhe policisë dhe ushtrisë që vritet popullit Murat Mehmeti dhe plagosja e shumë djemve e vajza kosovare, nuk mundën që ta shuajnë rezistencën e popullit liridashës shqiptar.

Kjo rrugë e rezistencës vazhdoi edhe gjatë viteve 1980- 1981 që diçka vetëm pritej që të ndodhte.

Vdekja e Titos në vitin 1980 krijoi një vakum të madh të një lidershipi politik në Jugosllavi që filloi edhe të de stabilizohet Jugosllavia. Deri sa Autonomia e Kosovës nuk i plotësonte aspiratat e popullit shqiptar i cili dëshironte që të jetë i lirë me të drejta të plota me popujt tjerë në Jugosllavi, e jo nën diktatin serb.

Ndërsa në anën tjetër, kërkesat e shqiptarëve, ngjallën te serbet nacionalizmin që ishte maskuar nën blozën false të një barazie e zgjedhjeje të çështjeve nacionale të kombeve e kombësive.

Për këtë arsye në Kosovë vazhdonin organizimet e riorganizimet e lëvizjes shqiptare për krijimin e Republikës së Kosovës e t'i kundërvihet organizimit serb që kishte filluar e shihej në horizont që kërkonin nga forumet më të larta shtetërore, zvogëlimin e kompetencave të krahinave të garantuara me kushtetutë, Për këtë qëllim në vitin 1977 është botuar, plani dhe projekti serb i miratuar nga Akademia Serbe dhe nga dy Kryesitë e Republikës së Serbisë që është botuar edhe 'Libri i Kaltër'.

Derisa, bosht i kësaj teme është- Lëvizja Ilegale Kombëtare Shqiptare në Llap gjatë viteve 1981-1990, këtu do të shtjellohen e sqarohen deri diku zhvillimi i ngjarjeve nga krijimi i grupeve dhe fillimi i demonstratave në Kosovë e posaçërisht në rajonin e Llapit pasi deri më sot nuk është e studiuar sa duhet kjo temë.

Tema 'Lëvizja Ilegale Kombëtare Shqiptare në Llap 1981-1990', është shkruar kryesisht në bazë të aktakuzave dhe aktgjykimeve të organeve gjyqësore si: prokuroritë publike të qarkut, gjykatat e qarkut, Gjykata Supreme e Kosovës ku epen të dhëna gjatë hetimeve të anëtarëve të grupeve, të dhënat rreth numrit e të burgosurve prej një viti deri në pesëmbëdhjetë vjetëve.

'Pranvera e përgjakshme shqiptare 1981', është referendumi më i miri i një populli për të shprehur dëshirën që u la me gjak, në këtë pjesë të Ballkanit dhe Evropës.

Nga të dhënat e mbështetura nga materialit në dispozicion kam kuptuar se punën e tyre ilegale asnjë organizatë nuk e ka ndërprerë plotësisht. Ata zbuloheshin, arrestoheshin e dënoheshin veprimtarë, por asnjëherë nuk u bulua lidhja dhe rrjeti i tyre i plotë. Ka ndodhë që p.sh. sot të zbulohet e arrestohet një grup, po natën e ardhshme, është dashur që të shpërndahen afishe e materiale në gjithë qytetin e në

fshatra të shkruhen parulla me qëllim që populli, mos të mendoi se qe u zbulua dhe u shua Lëvizja Shqiptare.

Kjo burim i pa shtershim shpirtërore ishte në çdo familje e shtëpi shqiptare dhe se rrënjët e veprimtarisë ishte vet populli dhe nuk kishte forcë që ta asgjësonte një popull të tërë.

Në temë kemi edhe grupe ilegale që nuk i takojnë asnjë organizate po me vetë iniciativë të rinisë i kanë formuar grupet ilegale dhe kanë vepruar edhe të pavarur gjatë gjithë kohës derisa është zbuluar e dënuar grupi.

Më tej në këtë punim shtjellohen temat dhe të dhënat rreth demonstratave të studentëve të universitetit të Prishtinës, gjatë marsit e prillit 1981, si dhe demonstratat gjithë popullore e posaçërisht në komunën e Besianës me 1 e 2 prill 1981.

Pastaj vazhdojmë me organizimet para, gjatë dhe pas demonstratave të vitit 1981; Diferencimet ideopolitike ndaj shqiptarëve, Qëndrimet e Shqiptarëve të Kosovës për demonstratat e vitit 1981 Organizimi i Organizatave Ilegale dhe lëvizjet e tyre për suprimimin e Kushtetutës së vitit 1974 dhe heqjen e Autonomisë së Kosovës. Grevat e minatorëve të Trepçës dhe protestat e demonstratat e popullit kundër marrjes së Autonomisë së Kosovës.

Problemet që do të shtrohen dhe do të trajtohen në këtë temë janë të një natyre shumë interesante sepse kemi të bëjmë me punën ilegale të organizatave, grupeve dhe anëtarëve të saj që është mjaft vështirë të mos ketë lëshime kronologjike.

Në Kapitullin e parë janë përfshirë temat të cilat trajtojnë: Konceptin gjeografik të krahinës së Llapit, Gjendja e shqiptarëve pas luftës së Dytë Botërore, pastaj, formimi i grupeve ilegale në Kosovë; Demonstratat e studentëve të 11 e 26 marsit 1981, dhe 1 , 2 e 3 prillit 1981; Veprimtaria e organizatave dhe e grupeve ilegale në Llap për çlirimin e Kosovës. Gjithashtu në këtë kapitull flitet edhe për organizimi i demonstratave gjithë popullore në Besianë, organizimi i mbajtjes së mbledhjes, për fillimin e demonstratës të 1 e 2 prillit në Besianë dhe në fund epen të dhëna statistikore rreth dënimit të grupeve ilegale të Llapit.

Në kapitullin është trajtuar reagimi i popullit për mbrojtjen e autonomisë së Kosovës , rezistenca e popullsisë së Llapit për ruajtjen e autonomisë, për diferencimet ideo politike të shqiptarëve. Jepen të dhëna për formimin e partive legale në Llap, pastaj qëndrimi i Shqipërisë ndaj ngjarjeve të demonstratave të Kosovës, shtypi shqiptar dhe

shtypi i huaj për pranverën e përgjakshme 1981, dhe vlerësimi i demonstratave nga diplomat të huaj për ngjarjet 1981-1990 në Kosovë duke i kushtuar një vëmendje shumë të rëndësishme.

Natyrisht deri më tani , për këtë periudhë 1981-11989, është shkruar bukur mirë nga shumë autor dhe pjesëmarrës në demonstrata siç është edhe libri:'Histori e një organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981' Prishtinë 2008, i autorit Mehmet Hajrizit.

Me këtë periudhë u morën edhe autorë shqiptarë edhe të huaj si:Ana Lala, Dr. Jakup Krasniqi, Mr Ukshin Hoti, Dr. Ram Buja, Volfgan Pertisch dhe Robert Philer , Neol Malkolm , Jens Reuter,Sinan Hasani, Shaban Braha, Ditari personal i Enver Hoxhës, Mehmet Krajën, e shumë autor të tjerë.

Analizën shkencore të këtij punimi jam munduat ta mbështes në burime arkivore të gjetura në Arkivin e Kosovës dhe Arkivin e LPK-së. Në Arkivin e Kosovës janë shfrytëzuar fondet e Komitetit Krahinor, Dhomave shoqërore-politike të Komunave dhe Fondin Federativ. Në këto fonde ruhen materiale të rëndësishme e të vlefshme të kohës për këto ngjarje, pastaj janë shfrytëzuar edhe aktakuzat e aktgjykimet e gjykatave të Kosovës.

Në Arkivin e LPK-së janë marrë dokumentet para vitit 1980, 1981, e veçanërisht ato të vitit 1982, dokumente, thirrje e intervista si brenda ashtu edhe jashtë vendit të diasporës shqiptare.

Janë shfrytëzuar edhe shtypi i kohës. Kryesisht kam konsultuar 'Rilindjen' 'Zërin', Zërin e Popullit, NIN, të cilat ruhen në Bibliotekën Kombëtare dhe universitare të Kosovës në Prishtinë, si edhe shumë fejtone të gazetarëve të ndryshëm që u botuan pas luftës në Kosovë.

Për punën, studimin e shtjellimin e problemeve, janë shfrytëzuar edhe intervistat si memoriet, kujtimet e bashkëkohësve dhe aktorëve të ngjarjeve të kohës si dhe literatura e shkrime të botuar me rastin e përvjetorit të demonstratave të Kosovës nga autor të ndryshëm.

Gjithashtu gjatë punës së këtij punimi Diplome për Master kam bërë përpjekje që analizën ta mbështes në të dhëna autentike e të jem sa më objektiv.

## K a p i t u l l i i p a r ë

# Koncepti gjeografik dhe politik i trevës së Llapit

Krahina e Llapit shtrihet në pjesën veriore të Kosovës dhe është një tërësi mikrro - gjeografike e historike që luajti një rrol të veçantë gjatë shekujve. Përmes territorit të kësaj krahine kalon lumi Llap, i cili popullsisë së kësaj ane ia krijon kushtet e nevojshme për jetesë. Lumi Llap buron në Malin e Argjend ( Monte Argentorum ose Albanikos), me një lartësi prej 1789 m, të cilin më vonë serbët e quajtën Kopaonik. [1]
Kjo hapësirë përfshinë një sipërfaqe prej 945 km, që përputhet përafërsisht me territorin e ujë mbl edhësit të lumit Llap dhe me territorin administrativ të sotëm që ka komuna e Podujevës, (Besiana). Besiana si qytet në rajonin e Llapit, është qendra më e rëndësishme ekonomike, politike, administrative, arsimore, kulturore shëndetësore dhe lami të tjera shoqërore. Në këtë qendër gravitojnë rreth 120 fshatra, edhe pse një pjesë e tyre në aspektin administrativ u përkasin qendrave të tjera si: Prishtinës, Vushtrrisë dhe Mitrovicës. Në aspektin administrativ, në kuadër të komunës së Besianës, përfshihen 78 fshatra, ndërsa, në kuptimin e ngushtë, disa nga këto shtrihen në territorin e Gallapit të Llapit.[2]

Gjatë historisë, rajoni i Llapit ka pësuar ndryshime territoriale dhe administrative. Në periudhën e pushtetit osman ky rajon i Llapit përfshinte një territor të gjerë dhe herë ishte i organizuar në aspektin administrativ si Nahija e Llapit e herë edhe si dy nahije: Nahija e Llapit me qendër në Podujevë dhe Nahija e Kosovës me qendër në Kosovë ose Bellasicë, si quhej ndryshe. Rajoni i Llapit në aspektin territorial e pësoi pas Kongresit të Berlinit më 1878, kur më shumë se gjysmën e tokave të tij i pushtoi Serbia, ndërsa popullsia u detyrua që të shpërngulet me dhunë.[3]

Podujeva, nga kjo kohë e deri më në vitin 1912, për shkak të afërsisë së kufirit turko-serb, u bë qendër e rëndësishme politike e strategjike. Andaj për këtë arsye, rrethi i Llapit nga kjo kohë e deri në çlirimin e Kosovës, mbeti e pushtuar nga serbët, duke përjashtuar kohën e Luftës së Parë Botërore dhe Luftës së Dytë Botërore që ishin nën Austro-Hungarinë dhe Gjermaninë.

---

[1] Shefki Sejdiu,Sejdiu, Gjurmë lashtësie në onomastikën e trevës së Llapit, Trashigimia etnokulturore dhe historike e Llapit, Prishtinë 1995, 215-219.
[2] Fehmi Pushkolli, Llapi gjatë historisë, Prishtinë 1998, f. 7
[3] Sabit Uka, 'Vendosja dhe pozita e shqiptarëve në Kosovë, 1878-1912,Prishtinë 1994, f. 253 .

Llapi, si rajon në të tri anët është i rrethuar me male. Nga ana perëndimore, kufiri e ndanë me një vijë natyrore komunën e Mitrovicës, sepse i mbahet shpateve lindore të maleve të Shalës së Bajgorës.[4] Nga ana veriore dhe lindore malet të cilat e ndajnë rajonin e Llapit nga Serbia, e përbëjnë edhe Qafa e Përpellacit, Qafa e Merdarit dhe Qafa e Tullarit, ndërsa nga jugu kufizohet me Fushën e Kosovës e cila fillon nga fshati Besi-Barilevë (Barilaj).

Podujeva është qendër e urbanizuar dhe ka një sipërfaqe prej 663 km me 78 fshatra. Në këtë komunë llogaritet se jetojnë diku rreth 130 mijë banorë.[5] Sipas shënimeve të Dr. Asllan Pushkës të vitit 1995, pasi që mungojnë regjistrimet e rregullta të popullsisë, kjo krahinë duhet t'i ketë diku rreth 150-170 mijë banorë.[6]

Krahina e Llapit shtrihet në pjesën më veriore të Kosovës dhe ka një pozitë shumë të rëndësishme gjeopolitike, strategjike, ekonomike dhe ushtarake, pasi që ky territor gjendet në qendër të Ballkanit. Nëpër këtë rajon kalojnë rrugët transitore që lidhin rrugët me Adriatikun e me Maqedoninë e Egjeun. Pozita gjeografike e këtij rajoni ka qenë me rëndësi edhe gjatë historisë, qysh nga koha e vjetër e deri më sot, pasi përmes kësaj lugine kalonte edhe rruga Naissus- Lissus (Nish- Lezhë).

Territori i Podujevës, qysh nga parahistoria ka qenë i përshtatshëm për popullzim për shkak të rrafshit rreth lumit Llap dhe viseve kodrinore e malore në viset për rreth, por edhe pozita strategjike e gjeografike. Këtë e vërtetojnë gërmadhat e kështjellave, pjesërisht të hulumtuara që e rrethojnë territorin e Llapit, duke filluar nga Kështjella e Kulinës, e Ballofcit ( Ballshit) e Brainës (Gjytetit) e Llapashticës e të tjera. Rajoni i Llapit edhe gjatë mesjetës ka pasur një dendësi të madhe të popullsisë. Pas shpërnguljes së shqiptarëve me dhunë nga Toplica më 1877-78 u shtua numri i popullsisë edhe në rajonin e Llapit. Me vendimet e Kongresit të Berlinit u caktua kufiri në mes Serbisë dhe Perandorisë Osmane që prekej me rajonin e Llapit[7].

Popullsia e këtij rajonit është plotësisht shqiptare. Të gjithë shqiptarët e rajonit të Llapit e kanë përvetësuar fenë islame, gjatë sundimit të Perandorisë Osmane, ku edhe u ndërtuan xhamitë për lutje fetare, që para kësaj kohe shqiptarët ishin të besimit të

[4] Musa Gashi, Kushtet natyrore dhe demografike, Mitrovica me rrethinë, Mitrovicë 1979, f.11
[5] Asllan Pushka, Bazat ekonomike-gjeografike të Llapit, Trashigimija etnokulturore dhe historike s Llapit, Prishtinë 1995, f, 23
[6] Po, aty.

[7] S. Uka Dëbimi i shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit 1877-1878, Prishtinë 1994, f. 79

krishterë, që e dëshmojnë edhe themelet e kishave katolike, e ortodokse ,duke filluar nga Labuca e deri në Podujevë.[8]

Shekulli i XIX është i shënuar në historinë kombëtare për shkak se në këtë kohë filloi lufta për pavarësi kombëtare dhe për formimin e Shqipërisë. Formimi i Lidhjes së Prizrenit për llapjanët pati një rëndësi historike. Ajo ngriti dëshirën e vetëdijen kombëtare shqiptare dhe nxiti popullin shqiptar të luftojë për çlirim, për bashkim, për autonomi e për pavarësi. [9]

Shpallja e pavarësisë, ishte një akt me rëndësi jetike për popullin shqiptar. Ajo shënonte, përmbysjen e zgjedhës së egër shekullore të Perandorisë Osmane dhe realizimin e aspiratave liridashëse të shqiptarëve. Pra, edhe pas 80-vjetëve, shqiptarët janë të detyruar të vazhdojnë të njëjtën rrugë të rilindjes për çlirim, liri e bashkim të trojeve të tyre[10].

Më këtë u hap e lindi një epokë re në historinë e shqiptarëve dhe nga kjo kohë, Shqipëria u bë shtet i pavarur dhe sovran që pati një rëndësi të veçantë për shqiptarët.

Andaj, çështje me rëndësi ishte njohja ndërkombëtare e Pavarësisë së Shqipërisë dhe njohja e kufijve të saj. Për këtë qëllim Fuqitë e Mëdha, thirrën Konferencën e Ambasadorëve në Londër më 17 dhjetor 1912 nën kryesinë e Eduard Grejit dhe u vendos që Shqipëria të ishte autonome e nën kontrollin e Fuqive të Mëdha, ku me rastin e caktimit të kufijve të Shqipërisë i bënë një goditje të rëndë popullit shqiptar[11].

Kjo, padrejtësi u bë duke ia lënë më shumë se gjysmën e popullit dhe territoreve etnike të tij, e duke ia dhënë grekëve, serbëve dhe malazezëve, megjithëse vullnetarët shqiptarë me luftë e kishin çliruar Kosovën dhe Maqedoninë Perëndimore më 1912 nga okupacioni pesëqind-vjeçar osman.[12]

E njëjta padrejtësi historike u konfirmua edhe pas Luftës së Parë Botërore në Konferencën e Paqes në Paris më 1919 nga Fuqitë e Mëdha e cila padrejtësi zgjati deri në fillimin e Luftës së Dytë Botërore.

Pas Luftës së Parë Botërore në rajonin e Llapit, gjendja politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, arsimore dhe shëndetësore, jo që nuk u përmirësua, po ajo u keqësua edhe më shumë, pasi që ushtria serbe filloj ta vendoste pushtetin e vet.

[8] F. Pushkolli, vep. e përmendur, f. 8
[9] Grup Autorësh, Historia e Popullit Shqiptar II, Tiranë 2002, f. 78
[10] Q. Pllana, Metamorfozë shqiptare apo udhëkryqi i ri shqiptar, Prishtinë 1993, f. 192.
[11] Rexhep Qosja, Strategjia e bashkimit kombëtarë, Tiranë 1998, f, 217.
[12] Esat Stavileci, Rrugtimet dhe labirintet e Kosovës dhe të shqiptarëve, Prishtinë 2009, f, 117

Shqiptarët nuk mund të pranonin vendosjen e pushtetit serb, sepse ky do të ishte ripushtim i territoreve shqiptare dhe me këtë do të vërtetohej se do të mbeteshin edhe më tutje nën sundimin e pushtetit okupues serb.[13]

Shqiptarët nuk gëzonin të drejta themelore kombëtare dhe demokratike. Ata nuk kishin të drejtë përdorimi të gjuhës në punët publike, të drejtë shkollimi në gjuhën shqipe, të drejtë të kulturës kombëtare dhe të drejtë qytetare, por u mohohej edhe e drejta natyrore për jetë, sepse për vrasjen e tyre nuk përgjigjej asnjë njeri, përpara organeve të pushtetit, por ata lavdëroheshin si serb me vetëdije të lartë kombëtare dhe mbrojtës të Serbisë. Një prej formave të politikës asimiluese serbomadhe gjatë viteve (1918-1941), ishte kolonizimi i trojeve shqiptare dhe shpërngulja e shqiptarëve për Turqi, Shqipëri apo në ndonjë vend tjetër.[14]

Politikën e tillë shtypëse, shqiptarët e kundërshtuan me lëvizje të rezistencës së armatosur dhe të paarmatosur. Lëvizja kaçake ishte formë e rezistencës së armatosur, kurse agjitacioni kundër shpërnguljes, për mos shkuarje në shërbim ushtarak, për të drejta kombëtare e fetare ishin forma të qëndresës së paarmatosur [15]

Në vitin 1945 u bë e qartë se Jugosllavia bënte të gjitha përgatitjet për aneksimin e Kosovës. Andaj, gjatë kësaj kohe, grupet e organizatat atdhetare shqiptare e veçanërisht, NDSH-ja, shtruan tezën që: 'Meqë nuk po lejohet bashkimi me Shqipërinë, atëherë nuk do të bashkohemi as me Serbinë'.

Ky mendim shtroi bazën për Kosovën e barabartë, gjegjësisht Kosovën Republikë. Ky synim u bë bazë programore e luftës së shqiptarëve për shtetësinë e Kosovës. Për këtë arsye, pasi doli nga burgu i parë, Adem Demaçi, filloi që ta vazhdoi veprimtarinë politike dhe zgjerimin e idesë për domosdoshmërinë e luftës së pakursyer për bashkimin e tokave shqiptare. Për këtë qëllim ai formoi lëvizjen e njohur me emrin Lëvizja Revolucionare e Bashkimit të Shqiptarëve, ku e hartoi edhe Programin e Statutin e saj.[16]

Ani pse organizata veproi ilegalisht, ajo arriti të kishte disa dhjetëra anëtarë, por edhe disa mijëra udhëtarë në këtë drejtim. Këta të rinj, ishin edhe bartës të aktiviteteve politike, jo vetëm në Llap e Prishtinë, por edhe në mbarë Kosovën që

---

[13] Rexhep Qosja, Çështja shqiptare, Historia dhe politika, Prishtinë 1994, f, 182
[14] Dr.Hakif Bajrami, Programi kombëtar politik i shqiptarëve, Prishtinë 2002, f. 110.
[15] Limon Rushiti, Lëvizja kaçake, Prishtinë 1981, f.76.
[16] H. Bajrami, Dosja Demaçi, Prishtinë 2004, f. 147.

vazhduan të ndikojnë tek arsimtarët e studentët, që të lartësojnë edhe më tepër vetëdijen kombëtare dhe duke i orientuar brezat e rinj, që të luftonin për bashkimin e Shqipërisë.

Ideja për organizimin e demonstratave të 68-ës, doli në odën Llapiane të Gjatave në fshatin Bajçinë të Komunës së Besianës e cila kishte një traditë të hershme kombëtare që nga Pavarësia e Shqipërisë.[17]

Në kuadër të aktivitetit, një pjesë e anëtarëve të Grupit të Organizatorëve të Demonstratave të 68-ës, tubohen në fshatin Bajçinë në familjen 56 anëtarësh të Rexhep Gjatës e cila asokohe ishte një nga familjet më të mëdha të Llapit e njohur për burrëri, bujari e mikpritje në mbarë rajonin e Llapit[18].

Në vargun e këtyre zhvillimeve politike e kombëtare, duhet theksuar demonstratat e vitit 1968, që kërkesat kryesore ishin: Vetëvendosja, Bashkimi, Kushtetuta, Universiteti dhe mbi të gjitha Republika. Këto demonstrata nxorën në shesh problemin e madh shqiptar në Jugosllavi, që deri atëherë ishte kamufluar me mjeshtri nga regjimi jugosllav.[19]

Sakrificat ishin të mëdha, por edhe efektet qenë të jashtëzakonshme, sepse u shpejtua themelimi i Universitetit, u miratua kushtetuta e Kosovës, me të cilën u krijua një hapësirë e gjerë politike për veprim, u themeluan institucione kulturore e shkencore që ndikuan në zhvillimin e mëtejshëm të Kosovës.[20]

Zhvillimi dhe avancimi i statusit politik të Kosovës, nuk i ndali Llapjanët që ta ndërpresin aktivitetin e tyre politik e kombëtar, po ato, entuziazmuan edhe më shumë ata që të futeshin në grupe dhe organizata politike ilegale që u formuan në Llap, Kosovë apo në botën e jashtme. Praktikisht nuk ekziston asnjë grup ose parti politike në të cilën nuk u anëtarësuan llapjanët, e bile shumë nga ata, ishin edhe ideator udhëheqës e formues të organizatave, jo vetëm në Kosovë po edhe në Evropë, Amerikë, Kanada, Australi e vende të tjera.

Aktiviteti i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare nuk u ndal vetëm me kaq. Ajo e vazhdoi organizimin e punës dhe sistemimit të radhëve të saj, edhe më shpejtë e me këmbëngulje më të madhe se deri më tani. Organizimi vazhdoi deri në shpërthimin e

---

[17] Adil Pireva, Gjashtëdhjetëeteta shqiptare, Prishtinë 1994, f,57.
[18] Po aty.
[19] Selatin Novosella, Kosova 68, Prishtinë 1993, f, 33
[20] G. Autorësh, Vep. e perm, f, 361

demonstratave të viti 1981, nga studentët e Prishtinës. Pastaj, demonstratat nuk u shuan asnjëherë më, por vazhduan deri në fillimin e luftës nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, për çlirimin përfundimtar të shqiptarëve në Jugosllavi. Kosova e rajoni i Llapit, kanë një histori të lashtë të luftës për çlirim e bashkim kombëtar, administrativ e territorial gjatë shekujve. Në fund të shek IX dhe në fillim të shekullit XX ky territor ishte bërë arenë luftërash për liri e pavarësi të shqiptarëve në një anë dhe lakmuesve okupatorë në anën tjetër.

## Gjendja e shqiptarëve të Llapit (1945-1981)

Realitetet premtuese që u krijuan gjatë Luftës së Dytë Botërore për statusin e ardhshëm të Kosovës pas luftës nuk u realizua dhe për këtë shkak, shqiptarët u përballën me dhunën, vrasjet, presionin e mashtrimet e klasës politike serbe e Jugosllave. Deri atëherë, udhëheqësit e Partisë Komuniste të Jugosllavisë*, nuk patën ngurruar të premtonin se pas çlirimit ata do të zbatonin me korrektesë parimin e të drejtës së vetëvendosjes deri në shkëputje, si për shqiptarët ashtu edhe për të gjithë popujt e tjerë në Jugosllavi.[21]

Shqiptarët e Kosovës e viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi, jo vetëm që iu ndalua të bashkoheshin me Shqipërinë, ashtu siç ishin deklaruar gjatë luftës së Dytë Botërore e në Konferencën e Bujanit, por ata u pushtuan përsëri dhe u ndanë në katër njësitë e Federatës Jugosllave: në atë të Kosovës, Maqedonisë, Serbisë, dhe të Malit të Zi.[22]

Regjimi serb, nga koha e pushtimit, të muajt nëntor 1944 dhe aneksimit të Kosovës, korrik 1945, pareshtur ka zbatuar propagandë dhe politikë të përgatitur shumë më herët të mbështetur në projektet serbomëdha për shpërnguljen, asimilimin dhe asgjësimin fizik të shqiptarëve.[23]

Me gjithë përkufizimin e qartë të së drejtës për vetëvendosje, në të drejtën ndërkombëtare në radhë të parë, në Kartën e Kombeve të Bashkuara të drejtën për vetëvendosje e 'rezervuan vetëm për veten e tyre', duke ua mohuar këtë të drejtë popujve të tjerë dhe duke mbrojtur rajonet e veta koloniale dhe duke ua ndaluar e

[21] Ana Lalaj, Kosova-Rruga e gjatë drejt vetëvendosjes, Tiranë. 2000, f. 29.
[22] G. Autorësh,vep e përm, f. 339
[23] E. Stavileci, vep e përm, f. 43.

penguar rrugën e shtetësisë dhe të pavarësisë, popujve të pushtuar, pikërisht siç veproi, gati për njëqind vjet Serbia me Kosovën dhe shqiptarët dhe siç vazhdoj të kontestoj pavarësinë e saj, të cilën e kanë njohur më shumë se 75 shtete të botës.[24]

Aneksimin e Kosovës, shqiptarët në Jugosllavinë e Titos e konsideruan si mohim të luftës së tyre dhe si tradhti të udhëheqjes së LNÇ-së dhe politikës së tyre, deri në çlirimin e fundit nga Serbia. Çështja e popullit të Kosovës dhe statusi politik shtetëror i saj, krijuan pakënaqësi të reja në vazhdimësi. Jugosllavia Socialiste dhe Serbia e vazhduan luftën kundër shqiptarëve duke i burgosur, arrestuar, duke i ndjekur e përndjekur, duke i asgjësuar dhe duke i dëbuar nga vatrat e tyre deri në vitet 70-ta.[25]

Formë tjetër e një presioni drastik ndaj shqiptarëve, ishte edhe inskenimi i veprave penale e proceseve gjyqësore, si dhe dënimi politik i grupeve dhe intelektualëve shqiptarë, gjatë gjithë kohës së pas luftës. Në kushtet e prapambetjes së përgjithshme të krahinës, të frymës armiqësore ndaj pakicave, të izolimit të shqiptarëve nga atdheu mëmë, gjithçka që intrigohej për ta konsiderohej kombëtare, e plotësisht e mundur dhe detyrimisht e mundshme. Mblidheshin informata prej kujtdo dhe bëheshin vlerësime pa asnjë të dhënë të verifikuar për shumë qytetarë dhe anëtarë të LKJ në Kosovë. Për të gjithë këta ishin hapur 120.000 dosje.[26]

Nuk u kursyen as udhëheqësit politikë, anëtarë të KQ të Jugosllavisë, të Komitetit Krahinor të Kosovës- (Metohisë), deputetë federativ e krahinorë, student e intelektual. E tërë kjo veprimtari antishqiptare që mbështetej në dhunë dhe në terror ishte formë e institucionalizuar e pushtetit serb që zbatohej me qëllim të pastrimit etnik të shqiptarëve nga trojet e tyre etnike shekullore.

Mirëpo, sado i fuqishëm që ishte terrori, dhe mjetet e ndryshme të dhunës që i përdorte, asnjëherë nuk arriti ta realizonte qëllimin kryesor të politikës së shtetit që ta thyente krenarinë dhe rezistencën e popullatës së robëruar e cila të gjitha i ka ngulitur në kujtesën e tij historike.[27]

Kosova, nga viti 1970 e veçanërisht pas vitit 1974, përjetoj një zhvillim të dukshëm, duke e krahasuar me vetveten, si në aspektin ekonomik, politik, kulturor e sidomos në atë arsimor që ndikoi në emancipimin e vetëdijes kombëtare. Meritore për këtë është,

---

[24] Po aty.
[25] Hajredin Hoxha, Procesi i afirmimit nacional i kombësisë shqiptare në Jugosllavi, Prishtinë 1983, f. 180.
[26] ‘ Rilindja’, 8 tetor 1966.
[27] Ethem Çeku, Mendimi politik i Lëvizjes Ilegale në Kosovë 1945-1981, Prishtinë 2003, f,191

padyshim klasa politike e atëhershme së bashku me inteligjencën e cila po formësohej ngadalë po sigurt.

Me ndryshimet kushtetuese të vitit 1974 dhe me vendimet e LKJ-së, thuhej se u arrit barazia e plotë dhe e gjithanshme politike-juridike e kombeve dhe kombësive të Jugosllavisë dhe tretmani e barabartë të kombësive me kombet e Jugosllavisë.[28]

Edhe, përkundër një zhvillimi të madh e një liberalizimi politik në Kosovë, realiteti ndryshonte çdo ditë dhe një mendim i tillë ishte në kundërshtim me shkallën e ngritjes së vetëdijes kombëtare të shqiptarëve të Kosovës e në veçanti të rinisë studentore. Përkundër të mirave që kishte Kushtetuta e vitit 1974, ajo i kishte sanksionuar gjërat vetëm si të momentit në mënyrë statike për kohën dhe hapësirën.[29]

Si pasojë e kësaj pakënaqësie, shqiptarët vazhduan organizimet e grupeve politike ilegale që me programet e tyre, parashikonin avancimin e zgjidhjes kombëtare. Në vazhdën e këtyre proceseve një grup i madh atdhetarësh i përbërë nga një numër intelektualësh, studentësh e punëtorësh më 1975, nënë udhëheqjen e z. Adem Demaçit u arrestuan për të tretën herë me radhë, ku dënohen deri me 15 vjetë burg të rëndë për çështje politike.[30]

Për të njëjtën veprimtari edhe gjatë viteve 1979 e 1980 u bënë përsëri arrestime dhe dënime të disa grupeve ilegale politike të disa individëve të cilët kishin vepruar për avancimin e formimin e shtetit të Kosovës dhe bashkimin me Shqipërinë.[31]

Periudha në mes viteve 1968-81, është koha e lulëzimit dhe forcimit të veprimtarisë ilegale kombëtare shqiptare në Kosovë. Është koha kur veprojnë shumë organizata, grupe e individ që ishin zgjeruar aq shumë sa gati e kishin marrë epitetin e partive politike, pasi numri i anëtarëve e përkrahësve të lëvizjes kalonin disa qindra-mijëra simpatizant.[32]

Nga viti 1981 e këtej, gati gjysma e popullsisë së Kosovës në forma të ndryshme kanë kaluar nëpër duar të policisë. Andaj, popullit të pambrojtur shqiptarë të Kosovës nuk i kishte mbetur rrugë tjetër, veçse të organizohej në grupe dhe organizata legale e ilegale, që t'i kundërvihej shtypjes e dhunës që të çlirohej një herë e përgjithmonë.

---

[28] H.Hoxha-S Popovci, ' Barazia e pakicave kombëtare', Rilindja , Prishtinë 1984, f, 34.
[29] Ukshin Hoti, Filozofia politike e çështjes shqiptare, Prishtinë 1966, f, 96
[30] Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut, Prishtinë, nr. 239/75
[31] Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, nr. 153/79, dhe nr. 47/80 etj
[32] Avdi Gjata, Bajram Kurti, Begzat Baliu e Resul Bedo, Gjaku i lirisë, Prishtinë 1966, f, 8

Para, e gjatë vitit 1981, kishte vërshuar një ekspansion i veprimtarisë ilegale në Kosovë, duke i përfshirë edhe viset tjera shqiptare në ish Jugosllavi..[33]

Në këtë rrafsh nuk mbeti anash as diaspora shqiptare që në lëvizjen ilegale kombëtare kishte dhënë një kontribut jashtëzakonisht të madh politik e material.

Në këtë fazë, lëvizja fillon botimin e gazetave, librave, e programeve të veta ilegale të cilat ishin më efikase e më të përshtatshme për organizim e komunikim me qytetarët dhe popullin për t'i shpalosur konceptet e veta politike. Kështu botohen gazetat: 'Zëri i Kosovës', 'Bashkimi', 'Liria', 'Lajmëtari i Lirisë', e botime të tjera individuale e grupore[34].

Gjatë kësaj kohe, lëvizja ilegale merr karakter më të fuqishëm intelektual, pasi në kuadër të saj ishin angazhuar edhe intelektual të njohur kombëtar të cilët angazhohen për organizimin e luftës çlirimtare, jo vetëm me shkrime, po edhe me punë konkrete siç e kërkonte koha.

Në këtë fazë, për herë të parë pas Luftës së Dytë Botërore, ndodhë fenomeni i rëndësishëm për lëvizjen ilegale në Kosovë, ku fillon bashkëpunimi, bashkërendimi i udhëheqësve të Lëvizjes me politikën zyrtare të Shqipërisë. Nga kjo kohë, Shqipëria do të jetë, herë më e hapur e herë më e fshehur, po megjithatë ishte përkrahësja më e madhe e luftës çlirimtare të Kosovës.[35]

Rritja e nivelit të organizimit e zhvillimit të lëvizjes kombëtare ilegale të Kosovës, paraqitet nevoja e një çështjeje shumë të rëndësishme siç ishte problemi i unifikimit të organizatave dhe grupeve ilegale politike në një lëvizje të përgjithshme unike apo në një front të përbashkët mbarëkombëtarë.

Bartësit e veprimtarisë ilegale të shqiptarëve në Jugosllavi, pas Luftës së Dytë Botërore ishin:

Bartësit e drejtë për drejtë të ngjarjeve të vitit 1981, politika zyrtare i cilësoi si irredentist, nacionalist, separatist, armiq të shqiptarëve dhe kundërrevolucionare. Ndërsa koha e formimit të grupeve ilegale në Kosovë, fillon që nga ditët e para pas Pavarësisë së Shqipërisë më 1912, pastaj pas Kuvendit të Prizrenit më 1945 e që vazhduan aktivitetin e tyre në vazhdimësi të pandërprerë deri në krijimin e shtetit të Kosovës.

---

[33] Sabile B. Keçmezi, Të burgosurit politikë shqiptar në Kosovë, Prishtinë 2009, f. 88
[34] E. Çeku, Shekulli i ilegales, Prishtinë. 2004, f. 60
[35] Haki Kosumi, Rritja e Lëvizjes Ilegale në Kosovë 1981-1990, punim në dorëshkrim.

Bartësit kryesor në zonën e Llapit, sipas të dhënave statistikore ishin:të rinjtë-nxënësit me shkolla të mesme të kryera, student të rinj me diplomë fakulteti, shumica të papunë por edhe të punësuar. Kishte edhe nga ata që i përkisnin inteligjencies, por ishin më të rrallë. Shumica absolute kishte prejardhje fshatare, por kishte edhe punëtorë, si dhe të shtresave të tjera shoqërore, por më pak.[36]

Gjithashtu një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e ilegales shqiptare pati edhe emigracioni i pasluftës, që në tërësi paraqet aktivitet të vetëdijshëm, të përgatitur dhe organizuar armiqësisht nga pozita e nacionalizmit shqiptar.[37]

Kjo veprimtari kombëtare nuk është diçka e re, është një vazhdimësi e lëvizjeve të mëhershme atdhetare patriotike të cilat janë përpjekur që taktikën dhe strategjinë e vet si dhe platformën ideo-politike t'ua përshtatin kohës, lëvizjeve politike dhe ngjarjeve në vend e botë, në mënyrë që të kenë sukses  më të madh në realizimin e qëllimeve të veta.[38]

Kjo nuk është ndonjë meritë  e veçantë e iniciatorëve të organizimit të grupeve ilegale sepse po të mos i organizonin këta, do t'i organizonin të tjerët, ndoshta me shumë pak vonesë, gjë të cilën e dëshmuan grupet e organizuara më vonë.[39]

Për këtë qëllim, mund të konstatoj se grupet janë produkt i rrethanave objektive reale të krijuara në kohë të caktuar si rezultat i ngritjes dhe zhvillimit të vetëdijes kombëtare.

Veprimtarinë patriotike të këtyre grupeve në këtë periudhë, gjatë viteve 1970-1980 në Llap e karakterizojnë përpjekjet e tyre për ndërlidhjen e tyre aksionare dhe lidhshmërinë organizative, masivizimin, ngritjen dhe aftësimin ideo-politik të anëtarëve nëpërmjet leximit të literaturës patriotike, kryesisht të marrë nga Shqipëria. Gjatë kësaj periudhe aktiviteti më i dendur ishte forcimi i aktivitetit në radhët e anëtarëve të organizatës, grupit e nëngrupit ku pastaj shkruanin e shpërndanin trakte e parulla me përmbajtje kombëtare  kundër okupatorit.[40]

Të gjithë anëtarët e grupeve kishin për detyrë të rekrutonin e zgjeronin grupin me bashkëmendimtarë me qëllim të shtrirjes së lëvizjes deri në vendet më të skajshme të

---

[36] U. Hoti, vep. e përm, f. 107.
[37] Sinan Hasani, Kosova të vërteta e mashtrime , Prishtinë 1987, f.167
[38] Jakup Krasniqi, Kosova rrugë e gjatë, drejtë vetëvendosjes 1981-1991, Prishtin 2010, f, 131.
[39] I. Shala,  29 vjetorit i demonstratave  të vitit 1981, Epoka e Re, Prishtinë, 2010.
[40] Metush Zenuni, 'Lëvizja popullore e Kosovës dhe roli i saj në formimin e  UÇK-së (Punim diplome për Master), Prishtinë 2009,  f. 41.

vendit, për të formuar grupe më të mëdha që më vonë të kenë mundësi të formohen organizata me një shtrirje gjithë kombëtare. Grupet dhe organizatat ilegale kishin edhe programet, statutet e qëllimet e tyre të punës dhe të organizimit. Për të kuptuar përmbajtjen dhe organizimin politik të këtyre grupeve, më së miri është të mbështetemi në përmbajtjen e programit, sepse aty janë të shprehura në mënyrë të sakët platforma, qëllimet, mënyra dhe mjetet për realizimin e qëllimeve programore.[41] Programet ndryshonin bukur shumë në mes grupeve të ndryshme, varësisht nga rrethanat dhe koha si është organizuar grupi, mosha e organizatorëve dhe niveli i përgatitjes intelektuale.[42]

Lirisht mund të konstatojmë se në vija të përgjithshme kanë qenë të përafërta si: realizimi i statutit të Kosovës nga Autonomia në Republikë edhe ajo si fazë e parë e pastaj bashkimi me Shqipërinë. Mënyra e realizimit ishte graduale, duke filluar nga format më të lehta të rezistencës në mënyrë legale po edhe kombinimi i tyre e deri te format më të larta të veprimit siç është rezistenca e armatosur dhe kryengritjet.[43]

Platforma politike ishte ideologji nacionaliste kombëtare e kombinuar me ideologji komuniste që imponohej nga ekzistenca e shtetit komunist Jugosllav dhe ai i Shqipërisë, kur dihej se grupet ilegale nuk vepronin për përmbysjen e sistemit komunist Jugosllav e shkatërrimin e Jugosllavisë, po, për krijimin e shtetit të Kosovës në kuadër të asaj Jugosllavie Komuniste.

Emërtimi i grupeve ilegale dhe i organizatave me terma ideologjikë, bëhej më shumë për çështje të politikës ditore, sesa që përmbanin elemente komuniste, gjë të cilën e dëshmojnë, statutet, programet e grupeve e organizatave ilegale. Ato emërtoheshin pasi që organizatorët ishin të vetëdijshëm se politika shtetërore jugosllave do t'u kundërvihet me të gjitha masat e mundshme të dhunës në emër të ruajtjes së revolucionit socialist Jugosllav, gjë të cilën edhe e zbatoi gjatë demonstratave të vitit 1981 e që e quajtën kontrarevolucion[44] Për këtë shkak është i nevojshëm shqyrtimi i ngjarjeve të vitit 1981 në kontekst të definimit të kontrarevolucionit.

---

[41] Bajram Kosumi, Koncepte për mendimin e ri politik, Prishtinë 2001, f. 83.
43 A. Gjata, vep e përm. f, 9.

[42] A. Gjata, Kujtime
[43] Lefter Nasi, Aspekte të shtypjes kombëtare e politike të shqiptarëve në Kosovë 1981-1989. Tiranë 1995, f, 54.
[44] Avdi Gjata, vep. e përm, f, 9

Realisht gjatë historisë shqiptarët nuk ishin në gjendje t'i kontribuonin krijimit të çështjes shqiptare. Gjatë historisë atë ua krijuan të tjerët. Mirëpo, doemos duhet të jenë në gjendje që t'i kontribuojnë zgjidhjes së saj të drejtë. Dhe, zgjidhja e drejtë e çështjes shqiptare është bashkimi i tyre në kontekst të proceseve integruese të Evropës.[45]

Si komb i viktimizuar në funksion të baraspeshës midis Fuqive të Mëdha dhe të ruajtjes së paqes ( e cila edhe ashtu nuk u ruajt) në të kaluarën, me suprimimin e ndarjes ideologjike të Evropës do të duhej të mundësohej realizimi i interesave vitale të kombit, të renditjes në rendin e popujve të barabartë dhe të avancuar në Evropë[46]. Mirëpo, problemi i çështjes shqiptare, nuk qëndron te bashkimi..., por te rrugët për realizimin e këtij qëllimi. Kur thuhet se bashkimi do të bëhet në integrimin Evropian, mund të thuhet se është thënë gjithçka, por edhe asgjë.

Në vitin 1981 u shtrua kërkesa për krijimin e Kosovës në Republikë. Në prapavijën e kërkesës është se problemi shqiptar në Jugosllavi është si krijim i barabartë me të tjerët si shtet që i gëzonin republikat (shtetet) në Jugosllavi. Politika zyrtare, atëbotë, kërkesën e tillë e shpalli si kërkesë kundërrevolucionare, duke e shpjeguar ndoshta jo tërësisht pa bazë, se Kosova, me t'u konstituuar në Republikë, do ta ushtronte të drejtën e vetëvendosjes dhe do t'i bashkëngjitet Shqipërisë.[47]

Në analogji me Gjermaninë qëndron edhe çështja shqiptare e konstituivit të Kosovës në Republikë (tani e jetësuar) dhe çështja e bashkimit, e cila duhet të realizohet në kontekst të proceseve integruese të Evropës, jo për inat, e as me gjithët tjerët, por sepse ajo (Republika) është e drejtë elementare e konstituimit të kombit në Jugosllavi dhe e zhvillimit të tij të barabartë me të tjerët.[48]

Pozita e shqiptarëve esencialisht është rezultat i thyerjes dhe i kompromisit midis dy etnikumeve (austro-gjermanëve dhe sllavëve), por edhe i presioneve të mëdha nga jashtë që e pengonin vlerësimin e drejtë dhe real të faktorit ndërkombëtar dhe madje pjekjen e faktorit shqiptar, i cili duhej ta bënte një gjë të tillë në favor të interesave shqiptare.[49]

---

[45] U. Hoti, f. 87.
[46] Po aty, f, 88.
[47] Po aty. f, 88
[48] Po aty. f. 89
[49] Po aty, f. 89

Në periudhën prej shpërthimit të demonstratave në vitin 1981, aktiviteti i grupeve ilegale në Llap karakterizohet me një punë gjithnjë në rritje dhe zgjerim horizontal të lëvizjes. Qëllimi i organizimit ishte shumë i qartë dhe ishte kuptuar nga të gjithë anëtarët se lufta ishte e gjatë e duhet të punohej sa më shumë, pasi nuk kishte kthim prapa, por duhej që çështja e Kosovës të sensibilizohej e propagandohej sa më shumë për të arritur deri në realizimin e kërkesës popullore Kosova-Republikë.[50]

Gjatë punës së tyre ilegale, anëtarët përdornin sistemin e punës të ashtuquajtur sistem i treshit që rëndom fillonte nga treshet si; (2+1, d.m.th. dy veta, që nuk dinin për njëri-tjetrin dhe njëri, që dinte për dy të tjerët), dhe kjo pastaj rritej me progresion gjeometrik në dhjetëshe (3x3+1), në qindëshe (99+1) dhe mijëshe e kështu me radhë.

Nga të dhënat zyrtare se janë zbuluar 9 organizata pak si më të mëdha dhe i 93 grupeve ilegale në tërë trojet shqiptare në jugosllavi, nuk do të thotë se edhe është shuar aktiviteti armiqësor i nacionalistëve dhe i separatistëve shqiptarë ndaj Jugosllavisë socialiste.[51]

Gjithashtu edhe gjatë viteve 1984, por edhe në vitin 1985 janë zbuluar edhe disa grupe , kryesisht të formuara rishtas, që më i rëndësishmi ndër këto grupe ishte grupi i ashtuquajtur si grupi diversant i përbërë prej disa anëtarëve[52].(Rifat Kafexhollit e Shaqir Ruhanit),i dënuar dy herë për veprimtari nacionaliste.

Mirëpo, disa organizata dhe individë të pazbuluar dhe disa grupe armiqësore të përtëritura dhe të formuara rishtas e vazhdojnë edhe më vonë veprimtarinë armiqësore, por me taktikë të re. Kështu, në vitin 1983 u zbuluan dhe iu ndërpre puna e dhjetë grupeve të ndryshme armiqësore si në Prishtinë, Podujevë, Ferizaj, Gjilan e Prizren, Gjakovë me 134 anëtarë, ndër të cilët 48 ishin nxënës, 44 student, 6 profesor e mësimdhënës, 18 punëtorë , një teknik, një milic, një gazetar, një nëpunës dhe nëntë të papunë.[53]

Sipas një të dhëne, prej vitit 1981 deri më 1986, shërbimi i punëve të brendshme kishte zbuluar 8 0rganizata Ilegale dhe 88 grupe. Numri më i madh i këtyre

---

[50] Hydajet Hyseni,, Ngjarjet në Kosovë nuk janë Kundërrevolucion, 'Zëri i Kosovës', Biel, Zvicër, 1996.
[51] Shtypi botëror për ngjarjet në Kosovë, '8 Nëntori', Tiranë 1981, f. 13.
[52] U. Hoti, vep e përm, f. 108
[53] Po aty.

organizatave kishin zanafillën pas vitit 1981,[54] por kishte edhe grupe të tilla që ishin vazhdimësi e organizatave të pazbuluara nga organet e SPB-së.

Të dhënat e përmendura, që kanë të bëjnë me zbulimin e organizatave, të grupeve ilegale dhe të individëve që janë marrë me 'veprimtari armiqësore' rëndom përcilleshin me shpjegime se nga ato, në orientimin e tyre ideologjik e përmbanin një fondament marksist-leninist, ose shumica e të rinjve të burgosur kishin qenë të indoktrinuar nga kjo ideologji. Jepeshin të dhëna se për vepra penale ishin përgjigjur rreth 1298 veta, ndërsa ishin dënuar rreth 1019 veta . Mirëpo, nuk jepeshin kurrfarë të dhënash se sa nga ata, në të vërtetë, ishin të indoktrinuar me këtë ideologji marksiste [55]?

Mos, afrimi i numrit të indoktrinuarve shqiptar me ideologji komuniste, dëshmon më së miri se këtu nuk ka të bëjë me problemin ideologjik po me çështjen e pa zgjidhur nacionale të shqiptarëve në Kosovë.

U shpjegua më tutje se deri në vitin 1989 e kishin përjetuar 'kontaktin e afërt të llojit policor', d.m.th. se deri në vitin 1989 e kishin pësuar: 584.373 veta, që përafërsisht do të thoshte, çdo i katërti shqiptar, ishte keqtrajtuar fizikisht [56] Programet e të burgosurve politikë, sipas pohimeve politike, kryesisht mbështeteshin në ideologjinë marksiste-leniniste të frymëzuar nga Shqipëria, prandaj Republika u duhej për të ndërmarrë hapin tjetër të bashkëngjitjes me Shqipërinë.[57]

## Formimi i grupeve ilegale shqiptare në Kosovë e veçanërisht në Llap (1981- 1989)

Përfundimi i Luftës së Dytë Botërore, shqiptarëve nuk ua solli rezultatet e shumë pritura për çlirim e bashkim kombëtar. Ata u detyruan që ta vazhdojnë luftën për ruajtjen e identitetit kombëtar e territorialë. Për ta arritur atë, shqiptarët ishin të vetëdijshëm se vetëm me një strukturë politike të organizuar mirë, mund të arrihej tek aspiratat historike për çlirimin e Kosovës dhe bashkimin me Shqipërinë. Grupet dhe

---

[54] S. K-Basha, Organizatat dhe grupet ilegale në Kosovë 1981-1989. Prishtinë 2003, f. 33.
[55] U. Hoti, vep e përm, f. 103.
[56] Blerim Reka, Enigmë gjithnjë e pazgjidhur, ' Rilindja', 13.05.1990, Prishtinë.
[57] Po aty.

organizatat politike në rajonin e Llapit vazhduan të formohen edhe pas Luftës së Dytë Botëror.

Për këtë qëllim në trevën e Llapit u formua Komiteti Nacional Demokratik i Shqiptarëve me kryetar Mulla Ramë Govorin e Hertizës që ishte vazhdimësi e NDSH-së nga LNÇ e Kosovës.[58]

Në vitin 1949 është Formuar Komiteti i NDSH-së me kryetar Sabit Kapitin, pastaj organizata e NDSH-së me Shaban Shalën të cilin Sigurimi i Shtetit e mbyti në burg në vitin 1963. Nga viti 1953 e deri në vitin 1964 janë burgosur disa grupe politike dhe intelektuale, në mesin e tyre ishte edhe z. Adem Demaçi. i cili kur doli nga burgu e formoi Lëvizjen Revolucionare të Bashkimit të Shqiptarëve (LRBSH-së), e cila me programin e statutin e saj, gjeti përkrahje në të gjitha viset shqiptare. [59] Për këtë arsye Adem Demaçi u bë sinonim i luftës politike dhe i rezistencës shqiptare në Jugosllavi që u burgos disa herë e që i mbajti më se 28 vjet burg të rëndë. Për këtë qëllim gjatë vitit 1975 dënohet për herë të tretë me radhë së bashku me 19 anëtarë të grupi me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P. nr. 230/ 75 me 15 vjet burg.

Në vazhdën e organizimit të lëvizjes atdhetare, është edhe grupi i 68-së i cili është formuar e konsoliduar në fshatin Bajçinë në odën fshatare të Gjatajve, ku kishte lindur ideja e organizimit të demonstratave të 27 nëntorit të vitit 1968 në Kosovë.

Demonstratat e përgjakshme, por krenare, kanë filluar me 27 nëntor 1968 në disa qytete të Kosovës; në Prishtinë, Podujevë, Ferizaj, Gjilan për çka dënohet grupi prej 10 vetash nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë me aktgjykimin P. nr. 23/ 69. në krye me Osman Dumoshin që dënohet me pesë vjet burg[60], ndërsa me 22 e 23 dhjetor demonstrata bëhen edhe në Tetovë të Maqedonisë ku dënohet grupi prej 11 vetave nga Gjykata e Qarkut të Shkupit.

Ndërsa nga Gjykata Komunale e Prishtinës dënohet grupi i të rinjve, prej 35 anëtarëve me nga një muaj burg, deri në një vit në krye me Shefqet Asllanin e që pjesa më e madhe e tyre, ishin nxënës të shkollave të mesme dhe zejtar.[61]

Referati që është lexuar në demonstratë e ka shkruar Adil Pireva, ndërsa redaktuarën e tij e ka bërë Ismajl Dumoshi i cili ishte profesor i gjuhës shqipe dhe njëherësh

---

[58] Sinan Hasani, vep. e përm, f, 147.
[59] F. Pushkolli, Hasan Ramadani, Prishtinë 2004, f. 82
[60] A.Pireva, vep e përm, f. 44.
[61] S. Basha, vep. e përm, f. 176

intelektual i shquar e atdhetar që shtëpia e tij, falë bujarisë së nënës Sadijes, ishte bërë një çerdhe e ngrohtë vendtakimi të ajkës së inteligjencies shqiptare të asaj kohe.[62]

Në këtë periudhë, ilegalja shqiptare, kishte hyrë në fazën e një zhvillimi më të lartë të organizimit dhe veprimit. Tash ajo kishte shtruar para vetes ndërtimin e një fronti të gjerë, për tu përballur me ofensivën e politikës jugosllave në njërën anë e për ta realizuar programin e vet politik në anën tjetër.[63]

Me kalimin e kohës e viteve edhe kërkesat e Lëvizjes Ilegale Shqiptare ndryshojnë. Nga vitet 1968 e deri në vitet 1981, organizatat ilegale patriotike paraqiten me kërkesa më të moderuara, duke u munduar që ato t'i përshtaten rrethanave të reja politike në Evropë e në Botë.

Veç, veprimtarisë ilegale në Kosovë, ishte aktive edhe veprimtaria legale e cila zhvillohej nëpërmjet propagandës individuale dhe të organizuar nga arsimtarët, profesorët, studentët dhe intelektualët. Gjithashtu, ishte edhe një pjesë e inteligjencies dhe e disa politikanëve, që mendonin se demonstratat rrezikuan edhe këtë autonomi që me mund e kishte fituar Kosova dhe se 's'ka qenë koha për rezistencë në formë demonstratash' nga se 'Kosova është Republikë', po udhëheqja e Kosovës, nuk diti ta shfrytëzojë atë, pasi angazhimi i intelektualëve më së shumti është orientuar në lëmin e kulturës, arsimit, dhe të informimit. Kjo veprimtari dhe ky aktivitet ndikoi në përforcimin e vetëdijes kombëtare tek një pjesë e popullit për të përgatitur për sfidat e ardhshme të vendit.

Me të drejtë mund të llogaritet se iniciatorët dhe organizatorët kryesor ishin kategoria e vjetër e patriotëve, të cilët më herët kishin vuajtur dënimin me burg por që nuk ishin penduar e thyer gjatë vuajtjes së dënimit, nëpër burgjet e Jugosllavisë. Kështu një numër i madh i tyre, posa dolën nga burgjet iu bashkuan organizatave të tyre ilegale për të ndihmuar aktivitetin 'armiqësor', siç ishin: Adem Demaçi, Isuf Gërvalla, Rexhep Mala, Rexhep Balidema, Gjeladin Rekaliu, Ilaz Pireva, Metush Krasniqi, Kadri Halimi, Sabit Kapiti, Ibrahim Demolli, Salih Salihu etj, deklaron në veprën e tij, Kosova të vërteta dhe mashtrime, Sinan Hasani.[64] dhe vazhdon: Që në fillim të demonstratave shihej se ato ishin vepër e armikut, të brendshëm dhe të jashtëm. Demonstruesit këndonin këngë nacionaliste dhe mbanin parulla të shkruara:

[62] A.Pireva, vep e përm, f. 81.
[63] E. Çeku, vep e përm, f.190.
[64] S. Hasani,…vep e perm, f. 181.

‘Lufta nacionalçlirimtare nuk u solli lirinë shqiptarëve’, ‘Rroftë Adem Demaçi’, ‘Rroftë Kadri Halimi’, ‘Lironi të burgosuri politikë’, ‘Rroftë Enver Hoxha’, ‘Rroftë Ismajl Qemajli’, ‘ Rroftë Shqipëria’ etj.[65]

Në bazë të vlerësimeve të bëra nga LK e Komitetit Krahinor, kryetari i Komiteti të Krahinës Autonome të Kosovës, dha këtë deklaratë për opinionin publik:

‘Komiteti Krahinor i LK të Kosovës’, e vlerësoi se ky aksion është organizuar nga ana e një grupi elementesh armiqësorë, kundërshtarësh të përbetuar të rendit tonë kushtetues, të shoqërisë socialiste dhe të vetëqeverisje, si dhe kundër platformës ideologjike dhe politike të LKJ-së dhe vëllazërimit e bashkimit të kombeve e kombësive tona.[66]

Këto forca reaksionare dhe platforma politike e tyre, nuk ndryshojnë aspak nga platforma e forcave të tjera reaksionare me të cilat komunistët dhe popullsia e kësaj Krahine i kanë qëruar hesapet në të gjitha fazat e deritashme të zhvillimit tonë socialist.[67]

Edhe pse anëtarët e grupeve zbuloheshin shpesh ,asnjëherë nuk ka ndodhur që të zbulohet tërë organizata. Së këndejmi ata që mbeteshin të pazbuluar vazhdonin aktivitetin e vet organizativ, duke angazhuar njerëz të rinj e të devotshëm për çështjen e atdheut në mënyrë konspirative konsolidonin radhët dhe ruanin lidhshmërinë patriotike..[68]

Si përfundim, lidhur me realitetin e ri të krijuar politik në viset shqiptare mund të thuhet se: demonstratat e vitit 1968 i kishin dhënë fund një lufte ilegale me parulla e propagandë, në të gjitha nivelet. Ishin krijuar kushte dhe raste për paraqitjen e një force intelektuale dhe politike ofensive aktive, e një populli të robëruar, për ta manifestuar kërkesën e vet legale, dhe legjitime për liri, në një formë që ishte më afër’ veprimit luftarak, me mjete të tjera për ndërrimin e pozitës shoqërore të një populli të okupuar, plus të ndarë, përmes veprimit me armë, dhe me luftë të armatosur’[69]

Edhe pse organizimi i Lëvizjes Ilegale Shqiptare vazhdonte të organizohej për demonstrata e rezistencë të vazhdueshme, ato arritën të shtypeshin deri te

---

[65] Po aty.
[66] Po aty.
[67] Po aty.
[68] Ramë Buja, Çështja e Kosovës dhe shkatërrimi i Jugosllavisë, Prishtinë 2006, f. 231.
[69] Shih Statuti i LRBSH-së, neni 1-4, në AK, Dosja Demaçi, 1964 Prishtinë, f. 17.

demonstratat e vitit 1968, të cilat patën vlerë të shumëfishtë, drejtë avancimit kualitativ të rrugës për liri e bashkim kombëtar të shqiptarëve në të ardhmen.

## Veprimtaria e organizatave ilegale shqiptare në Llap për çlirimin e Kosovës gjatë viteve (1981-1990)

Menjëherë pas luftës së Dytë Botërore, kishte filluar aktiviteti politik i shqiptarëve për çlirimin e Kosovës nga individ, grupe e organizata ilegale në Kosovë që angazhoheshin për çlirim e bashkim kombëtar të shqiptarëve në Jugosllavi. Në pamundësi për të ndryshuar gjendjen e krijuar, situatën e rrjedhat politike në Jugosllavi, shqiptarët ndryshuan taktikën e veprimit të luftës së tyre, që vazhduan pastaj me kërkesën për të drejta e liri të barabartë të shqiptarëve me popujt tjerë në Jugosllavi.

Ithtarët e këtyre ideve, nga radhët e popullit shqiptarë, më së shumti ndërlidhen me grupet dhe organizatat ilegale shqiptare, nacionaliste e irredentiste më (1950, 1953, 1957, 1961, 1966, 1968 e më vonë), që janë formuar ekskluzivisht nën ndikimin e forcave atdhetare shqiptare, si brenda ashtu edhe në diasporë. Po ashtu janë zbuluar edhe nëpër shumë vende të Kosovës, si në Besianë, Prishtinë, Pejë Gjakovë, Gjilan, Ferizaj, Vushtrri, Prizren etj. Një numër i madh i tyre, janë zbuluar, arrestuar, pushkatuar e internuar për vite të tëra në tërë ish Jugosllavinë. Ato paraqitnin një lidhshmëri të aktivitetit atdhetar të organizatës NDSH-së, ONDSH-së e LRBSH-ve që kryesisht përbëheshin nga nëpunësit, studentët, nxënësit e shkollave të mesme, profesorët, intelektualët e fshatarët shqiptarë.

Megjithëse, në platformën politike të tyre, ende mbizotëronte ideologjia properëndimore, ato ndryshonin nga organizatat atdhetare klasike para Inforbyros e Plenumit të Brioneve që i përgjigjej plotësisht reaksionit shqiptar të vjetër e të ri në Jugosllavinë e Titos [70].

Andaj, për këtë qëllim në të njëjtën anë u gjendën edhe komunist edhe ballistët edhe legaliteti, edhe të ashtuquajturit 'marksist-leninistët e vërtetë' të shqiptarëve të

[70] S. Hasani, vep e përm, f. 168

Kosovës e të trojeve shqiptare në Jugosllavi[71] që edhe një numër bukur i madh ishte nga rajoni i Llapit.

Organizatat dhe partitë politike në rajonin e Llapit e kanë zanafillën në vitet e para të pas luftës së Dytë Botërore siç është formimi i Komitetit Nacional Demokratik i Shqiptarëve gjatë viteve 1947-1949 me kryetar Mulla Ramë Govorin e Hertizës.

Gjatë nëntorit të vitit 1949, ishte formuar Organizata Nacional Demokratike Shqiptare (ONDSH)-së, nën udhëheqjen e Sabit Kapitit, Nuhi Gashit dhe Shaban Shalës, të cilët u dënuan në qershor të vitit 1953 me vendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë me nr. 76/53 prej 20 deri në 1 vit burg.[72]

Gjithashtu është formuar edhe organizata NDSH-së në krye me atdhetarin e njohur Shaban B. Shalën nga fshati Letanc, të cilin Sigurimi Shtetëror gjatë hetimeve në vitin 1964 e mbyti në burgun e Prishtinës së bashku me Fazli Grajçevcin.[73]

Në vitin 1961 gazetari dhe shkrimtari z. Adem Demaçi, nga fshati Lupç i Poshtëm i Podujevës, gjatë vitit 1961 e formoi organizatën me emër 'Lëvizja Revolucionare e Bashkimit të Shqiptarëve'(LRBSH). Me bashkëpunëtorët e vet e kishte shkruar edhe Statutin e kësaj organizate, ku në pjesën e përgjithshme shkruante se: 'Qëllimi i parë dhe i fundit i lëvizjes tonë asht çlirimi i krahinave Shqiptare,' të 'aneksueshme prej Jugosllavisë dhe bashkimi i këtyre krahinave me nënën e vet –Shqipërinë'[74].

Ndërkaq vazhdon: 'Lëvizja jonë, për me e mbërrij qëllimin e lartë përmendur, ka me i përdorë të gjitha mënyrat dhe mjetet që i vijnë për dore, prej atyre politiko-propagandistike, që janë mjetet paqësore e deri te lufta e armatosur dhe kryengritja e përgjithshme popullore që janë mjete jo paqësore.[75]

Nga aktet gjyqësore të vitit 1964, shihet se aktivitetet armiqësore të organizatave apo grupeve e veçanërisht, gjatë vitit 1963, u manifestuan sidomos me nxjerrjen e flamurit shqiptar, shkrimin e parullave armiqësore nëpër vende publike, në paraqitjen e grupeve dhe individëve kundër gjendjes ekzistuese politike e ekonomike në Kosovë e Metohi, etj.[76]

---

[71] Po aty, f. 169
[72] Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë .nr. 76/53 në Prishtinë
[73] Sadri Rexhepi, Shaban Shala ,Trashëgimia etnokulturore dhe historike e Llapit, Prishtinë 1995, f. 332.
[74] H. Bajrami, vep e përm. f, 113.
[75] Po aty.
[76] S. Hasani, vep e përm, f. 173

Për këtë arsye, pas zbulimit të saj, 44 persona u dënuan me burg të rëndë prej 3 deri 15 vjet, 36 të tjerë u dënuan për kundërvajtje, deri në dy muaj, kurse iu tërhoq vërejtja përmbi 300 personave që iu kishin bashkëngjitë propagandës së tyre, duke i frikësuar se nëse edhe një herë merren në organet e sigurimit do të likuidohen . Ndër të dënuarit ishin edhe 9 anëtarë të LKJ-së, në mesin e tyre edhe dy sekretar të Partisë[77].

Gjatë atij viti, dënohen edhe dy grupe e të rinjve nga gjykatat për kundërvajtje që ishin vazhdimësi e ONDSH-së, prej 30 ditësh deri në 12 muaj. Kryesisht këta ishin nxënës të shkollave të mesme që në krye të njërit grup ishte nxënësja e shkollës së mesme Elhame Shala që e kishte qëndisur flamurin shqiptar dhe poeti i më vonshëm Zeqir Gërvalla nga fshati Lupç ( Klysyrë) i Besianës që sot gjendet në Amerikë pas luftës së fundit..[78]

Edhe pas zbulimeve të një numri të madh të organizatave, e grupeve ilegale si në Kosovë ashtu edhe në Llap, aktiviteti i tyre atdhetar nuk u shua asnjëherë, po ai vinte duke u forcuar e zgjeruar pandërprerë si në rrafshin horizontal, ashtu edhe në at vertikal.

Në një atmosferë të tillë, filluan përgatitjet për organizimin e demonstratave në Kosovë nga studentët dhe intelektualët shqiptarë. Bartës kryesor të këtyre demonstratave ishte grupi i të rinjve i LRBSH-së nën drejtimin e Osman Dumoshit, që ishin liruar më parë nga burgjet jugosllave, si edhe studentët e tjerë që e kishin pranuar idenë e kësaj organizate.

Organizatorët e demonstratave të vitit 1968, dënohen me ligjin jugosllav si demonstrata kundër shtetit dhe bashkim me Shqipërinë, me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë; P. nr. 23/69, me burg prej 5 viteve deri në 3 vjet burg,[79]si edhe Aktgjykimin e Gjykatës Komunale; P. nr. 28/69 të 10 prillit 1969. Edhe përkundër masave të marra nga organet shtetërore, grupe, organizata e parti politike ishin formuar e kishin vepruar në Kosovë, ashtu edhe në botën e jashtme. Nxitjen më të madhe për formimin dhe veprimtarinë e tyre, padyshim e kishin bërë demonstratat e vitit 1968 dhe e shtetit shqiptar-Shqipëria. Por, mbi të gjitha, ndikoi edhe ndjenja patriotike, dëshira për bashkim kombëtarë, ndjenja për liri dhe zhdukja e robërisë shekullore. Njëherësh, ndikuan edhe problemet sociale, ekonomike e shoqërore. Të gjitha këto i

[77] Po aty.
[78] S. K. Basha, Të burgosurit politikë shqiptarë në Kosovë 1945-1990, Shkup, 2009. f, 174, 175.
[79] S. Novosella, vep e përm, f, 31

shtynë Llapjanët që të futeshin në grupe e parti politike dhe të merreshin me veprimtari ilegale që ishin formuar brenda e jashtë rajonit të Llapit.

Në mesin e viteve '70' politika jugosllave u detyrua të bëjë disa hapa politiko-juridik rreth çështjes së Kosovës. Ajo nxori Kushtetutën e Kosovës (1974) me të cilën bëri një avancim të autonomisë së Krahinës, por nuk e realizoi statutin e kërkesës së demonstratave të vitit 1968.[80]

Si duket, invadimi sovjetik në Çekosllovaki më 1968 e kishte shqetësuar shumë Titon dhe e kishte bindur se atij i duheshin të gjithë kundërshtarët e politikës ruse që mund t'i gjente në Ballkan.[81]

Përkundër liberalizmit të situatës politike në Kosovë, gjatë viteve 70-80-ta, aktiviteti politik ilegal në Llap nuk ishte ndërprerë, për të cilën gjë, dëshmojnë vazhdimet e burgosjeve politike edhe gjatë vitit 1974, që për herën e tretë arrestohet z. A Demaçi me grupin e tij prej 19 anëtarësh me aktgjykimin P. nr. 239/75 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë që dënohen prej 15 viteve deri në 4 vite burg të rëndë.[82]

Përmirësimet në fushën e përfaqësimit politik të Kosovës në Jugosllavi, nuk arritën të pengonin punën atdhetare që përsëri në janar të vitit 1975, rishtazi kishte pasur turbullira në kryeqendrën e Kosovës në Prishtinë. Agjencia e lajmeve 'Tanjug', lajmëronte se më 14 janar 1975 pesë shqiptarë të Kosovës ishin dënuar për arsye të 'veprimtarisë armiqësore ndaj shtetit' me ndëshkime që shkonin ndërmjet tre e nëntë vjetëve burg.[83]

Në vazhdën e këtyre veprimeve edhe gjatë vitit 1979 arrestohen edhe anëtarët e organizatës; 'Lëvizja Nacional-Çlirimtare e Kosovës dhe Viseve Shqiptare në Jugosllavi' të formuar nga Metush Krasniqi, Sabri Novosella, Jusuf Gërvalla, Shefqet Jashari e Rifat Jupolli. Ky grup u dënua me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë me nr. 47/80 prej 8 vjet, deri në 3 vjet burg.[84]

Në kuadër të këtij grupi, dënohet edhe Rifat Jupolli nga fshati Shajkofc (Albanik) i Besianës që ishte me punë të përkohshme në Gjermani ku edhe dënohet për anëtarësim në Lëvizjen Ilegale dhe bartjen e literaturës së ndaluar shqiptare në Jugosllavi me 5 vjet burg së bashku me Avdyl E. Lahun nga Vendenisi me 4 vjet burg

---

[80] Neol Malkom, Kosova një histori e shkurtër, Prishtinë 1998, f. 339
[81] Po aty.
[82] Sabile, K- Basha vep e përm, f. 180.
[83] Jens Reuter, Shqiptarët në Jugosllavi, Tiranë, 2003, f, 55.
[84] Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë nr. 47/80

që ishte referent i studentëve në fakultet dhe dajë i A. Demaçit. Të gjitha këto organizata e grupe politike ilegale, shtriheshin në rajonin e Llapit të Kosovës dhe krahinat tjera shqiptare në Jugosllavi. Forcimi i organizatave ilegale 'armiqësore' shqiptare me veprimtarin e tyre vazhdonin përsëri rrugëtimin e tyre edhe gjatë viteve 1977-79 dhe veçanërisht gjatë viteve 1980-81. Gjatë vitit 1979 në kuadër të kompleksit të Universitetit të Prishtinës u shpërndanë pamflete e trakte Në këto pamflete i bëhej thirrje opinionit studentor e atij shqiptar që të përgatitej e të jetë vigjilent pasi situata në Jugosllavi e Kosovë ishte tendosur tepër shumë. Për këtë qëllim ishte e nevojshme të bëhej një rezistence më e organizuar ose organizimi i një demonstrate e cila do ta njoftoj opinioni shqiptarë për planet dhe projektet serbe të cilat i kishte miratuar udhëheqja më e lartë e Serbisë dhe ajo e Jugosllavisë për zvogëlimin e kompetencave të krahinave autonome pasi me kushtetutën e tyre ato gjoja i kishin tejkaluar kompetencat e veta, shkruhej në Librin e Kaltër që ishte botuar në Beograd, në vitin 1976-1977 po që është tërhequr nga tregu. Për këtë na ka njoftuar profesori ynë i mesjetës Muhamet Tërnava në vitin 1979 [85].

Gjatë vitit 1979 dhe 1980 u zbuluan dhe u dënuan tetë grupe nacionaliste-irredentiste dhe u identifikuan 680 persona që vepronin nga pozita 'armiqësore' e kundër të cilëve nuk u ndërmorën masa përkatëse politike e as masa të tjera ligjore.[86]

Shërbimi i Sigurimit Shtetëror, vetëm në vitin 1979 identifikoi rreth 400 persona që vepronin armiqësisht ndaj Jugosllavisë. Mirëpo, në bazë të qëndrimeve që kishte marrë Udhëheqja Politike e Krahinës dhe organet më të larta të vendit për 'qasje selektive', procedura u hap vetëm ndaj 65 personave[87].

Ndërkaq u pa se në këtë veprimtari armiqësore ishin përzier edhe të dënuarit e mëparshëm politik, pjesëtarë të organizatës armiqësore të Adem Demaçit, të vitit 1964 dhe organizatorët e demonstratave të vitit 1968. Gjatë hetimeve u vërtetuan të dhënat për ekzistimin e organizatës armiqësore 'Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës dhe të krahinave të tjera shqiptare' e cila në të vërtetë është vazhdim i organizatës armiqësore ' Lëvizja Revolucionare e Bashkimit të Shqiptarëve' nga viti 1964.[88]

---

[85] M. Tërnava na njfton për vendimet e Kryesisë së Serbisë lidhur me 'Librin e kaltër' dhe planet serbe.
[86] S. Hasani, vep e përm, f.185.
[87] Po aty. f. 186.
[88] Po aty.

U gjet edhe para projekti i statutit të saj prej 15 pikave dhe dokumentet e tjera që tregonte se ekzistonte Komiteti Qendror i kësaj organizate dhe Komiteti i Rinisë. Në Statut, si qëllim themelor i kësaj organizate theksohej 'çlirimi i të gjitha krahinave të ndara e të robëruara nga Jugosllavia dhe bashkimi i tyre me shtetin amë RPS të Shqipërisë'[89]

Ndër organizatat që vepronin brenda dhe jashtë Kosovës e që kishin programe-projekte për çështjen shqiptare në Jugosllavi mund t'i veçojmë këto organizata:

- Lëvizja Revolucionare e Bashkimit të Shqiptarëve (LRBSH)-ja.
- Organizata Marksiste Leniniste e Kosovës (OMLK)-ja
- Organizata Ilegale 'Partia Marksiste Leniniste e Shqiptarëve në Jugosllavi (PKMLSHJ)-
- Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës (LKÇK)-ja.
- Organizata Ilegale 'Fronti Nacional Çlirimtar i Kosovës (FNÇK)-ja.
- Organizata 'Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës (LPRK)-ja' që më vonë u transferua në Lëvizje Popullore të Kosovës (LPK)-ja.[90]

## Demonstratat e vitit 1981 në komunën e Besianës

**Foto e një demonstrate të rinisë së Kosovës gjatë vitit 1981**

[89] Po aty.
[90] E. Çeku, vep e përm, f. 221.

Demonstrata e studentëve e filluar në mars të vitit 1981 është ngjarje e shënuar në historinë e popullit shqiptar që fryma e saj u shtri në popull që kaloi në një demonstratë të përgjithshme gjithë popullore. Demonstrata filloi në Prishtinë, por shumë shpejtë u përhap edhe në pjesët tjera të Kosovës. Ato shpërthyen e u shtrinë edhe në rajonin e Llapit ku qendra e tyre u bë qyteza e Besianës e cila llogaritet se në at kohë kishte afër 20.000 banorëve e që është e vetmja qendër urbane në këtë rajon. Aty punonin dy shkolla të mesme: Gjimnazi '8 Nëntori' ku mbanin mësim viti i parë e i dytë, dhe shkolla teknike 'Gjuro Xhakoviqi', sot Isa Boletini, që shtrihet në jug të qytetit ku mësimet i ndiqnin viti i tretë e i katërt.

Numri i nxënësve llapjan kalonte mbi 4.700 nxënës, kurse numri i mësimdhënësve arrinte afër 138 profesor që njohurit e tyre shkencore e kombëtare ia shpërndanin vajzave e djemve të kësaj krahine.

Pakënaqësia e qytetarëve dhe e fshatarëve Llapjan me regjimin e pushtetit të Jugosllavisë ishte shumë e madhe si në atë politik, social ashtu edhe në atë ekonomik e shoqëror. Rajoni i Llapit ishte në nivelin më të ulët të zhvillimit ekonomik, sociale edhe në kuadër të vet Kosovës. Rinia e cila kishte arritur një shkallë bukur të lartë të emancipimit kulturor e shkencor nuk shihte ndonjë perspektivë për të ardhmen e vet, andej ishte i detyruar që të mendoj dhe angazhohet për t'i hapur vetes rrugë drejtë ardhmërisë.

Pas masave që kishte marr Sigurimi Shtetëror Jugosllav në bashkëpunim me atë të Kosovës për burgosjen e organizatave ilegale në Llap e veçanërisht grupit të Adem Demaçit në vitin 1974-75, 'veprimtaria subversive shqiptare' filloi të forcohet e zgjerohet edhe më shumë e gjatë viteve 1974-75, e veçanërisht, gjatë viteve 1979-80.[91]

Gjatë viteve 1979-1980 u zbuluan dhe u dënuan tetë grupe nacionaliste dhe irredentiste shqiptare me 680 persona që vepronin nga pozita 'armiqësore' e kundër të cilëve në

kuptimin e plotë të fjalës nuk u ndërmorën masa përkatëse as politike e as masa të tjera ligjore.[92]

---

[91] S. Hasani, vep. e përm, f. 185.
[92] Po aty

Kur, demonstratat e studentëve shpërthyen në Universitetin e Prishtinës, në organizimin e tyre, kanë marrë pjesë edhe një numër i madh i studentëve nga Llapi të cilët i kishin krijuar organizatat e grupet e tyre ilegale qysh në vitet 1974-75-ta që vepronin në vazhdimësi, me një organizim, herë më të lartë e herë më të ulët.

Organizatat e grupet ilegale shqiptare të viteve 1981-1989 që u zbuluan nga sigurimi shtetëror i Jugosllavisë e që u dënuan nga ligjet e gjykatat jugosllave me burg deri në 15 vite ishin:

- Organizata ilegale 'Përsëri në Këmbë' nën drejtimin e Salih Salihut e Gjyla Krasniqit (Shota e Llapit) i formuar në vitin 1974/75[93]
- Grupi Revolucionar për Bashkimin Kombëtarë nën drejtimin e Fehmi Berishës e Ramadan Dibranit.
- Lëvizja Nacional Çlirimtar e Kosovës e drejtuar nga (Isuf Gërvalla)-dega në Besianë (Komiteti i Besianës) drejtuar nga Beqir Hajrizi nga Bardhashi më vonë (LPRK)-ja
- Grupi ilegal i formuar nga Nexhmi Balaj e Avdullah Rama nga Besiana në vitin 1979.
- Grupi ilegal 'Liria' i krijuar nga Bajrush F. Behrami, nga fshati Dobratin (Gegaj), më 1978. e Kadri Llugaliu që më vonë i bashkohet (LPRK)-së.
- Fronti Nacional Çlirimtar- Dega në Llap në drejtimin e Afrim O. Zhitiu-të nga fshati Llugë (Lugasi), në Besianë.
- Organizata Marksiste-Leniniste e Kosovës (OMLK)-ja- dega në Llap, nën drejtimin e Sabri Kiçmarit nga fshati Ballsh- (LPRK)-ja.
- Organizata Komuniste për Bashkimin e Trojeve Shqiptare e formuar në vitin !979, nga Naim H. Shala, Barilë.
- Grupi Ilegal i Llapit i formuar më 1978 nga Hamit R. Hamiti, nga fshati Repë (Rrepë) dhe Avdi Hysen Gjata e Fatime H Gjata, fshati Bajçinë.

-Organizata 'Përsëri në Këmbë' e ndërroi emrin dhe e mori,'Shaban Shala' e formuar nga Salih Xh. Salihu-Besianë; Xhylë-a A. Krasniqi-(Shota e Llapit) nga fshati Bajçinë, e Avdi Latifi nga fshati Pollatë.

---

[93] Salih Salihu, Epoka e Re, 12.mars 2002, Karakteri revolucionar dhe kryengritës i ngjarjeve të viti 1981,

Të gjitha këto grupe e organizata ilegale,vazhdonin të vepronin pandërprerë në gjithë rajonin e Llapit, duke e zgjeruar e forcuar grupin me anëtarë të rinj me qëllim që të bëhet ngritja shtrirja sa më e gjerë e grupeve dhe të jenë sa më masive..[94]

Veçanërisht, i kushtohej rëndësi ngritjes së vetëdijes të rinisë që të bëhen sa më të vetëdijshëm se populli shqiptar është i robëruar nga pushteti serbo-jugosllav, prandaj kundër kësaj gjendjeje të rëndë duhet të bëjmë një përgatitje sa më të mirë për organizimin e demonstratave e kryengritjeve të armatosur.[95]

Organizatat dhe grupet ilegale të Llapit, nuk e kishin të kufizuar veprimtarinë e tyre vetëm në këtë rajon ato e shtrinin aktivitetin e tyre edhe nëpër fshatrat e qytetet tjera të Kosovës, përmes lidhjeve familjare, miqve e shokëve të studimeve, si edhe lidhjes më të fuqishme dashuria atdhetare. Këtë mendim e dëshmojnë aktakuzat dhe aktgjykimet e ngritura nga gjykatat e Jugosllavisë, ndaj të gjithë të burgosurve politik, ku akuzohen për bashkëpunim të përbashkët në veprimtarinë 'armiqësore' të këtij grupi me grupin tjetër, apo të këtij anëtari me anëtarin e grupit të rajonin tjetër.

Veprimtaria e tanishme e grupeve ilegale karakterizohet me një përpjekje më të lartë për veprim sa më unik, profesional, e aksione më të koordinuara, në mënyrë që të përforcohen e masivizohen në pikëpamje organizative, teorike, politike si edhe leximin e literaturës të ashtuquajtur 'literaturë marksiste' që kryesisht kishte prejardhje nga diaspora e Shqipëria.[96]

Arritja e shkallës më të lartë të punës profesionale të anëtarëve është ruajtja më e madhe e konspiracionit gjatë komentimeve politike më qytetar, zbulimin e bashkëpunëtorëve të sigurimit shtetëror, ruajtja e autorëve të shkrimeve e komenteve politike në shtypin ilegal që shumëzoheshin e dërgoheshin për botim, nëpërmjet rrugëve ilegale në revistat që botoheshin jashtë vendit. Shkrimet bëheshin kryesisht nga gazetarët e autorët tjerë, që ishin edhe anëtarë të grupeve ilegale që punonin në mjetet e informimit të Kosovës si në Radiotelevizionin e Prishtinës, Rilindje, Zëri, etj, siç janë Ismet Begolli, Sherif Konjufca, Mustaf Xhemajli, Bajrush Behrami, Avdi Gjata, Musa Jupolli, Afrim Zhitiu, Sejdi Veseli, Bajram Ajeti, etj.[97]

---

[94] Intervistë me Fatime Gjatën, më 22. 03. 2011 në Besianë.
[95] Kujtime, A. Gjata. Prishtinë.
[96] Po aty.
[97] Intervistë me Ismet Begollin i burgosur pol. më 23. 12. 2010 në Besianë

Parulla, Kosova Republikë dhe parullat tjera i shkruanin kryesisht nëpër vende e sheshe publike, rrugë, mure të shtëpive që ishin më shumë të frekuentuara nga popullata, shkolla, ndërtesa, institucione shtetërore, autobus, trena, asfalte, në objektet e ndërmarrjeve të mëdha e të vogla, në të gjitha anët e krahinës së Llapit e të Kosovës. [98]

Shpërndarja e pamfleteve e parullave, kishte për qëllim që të demaskohej politika e LKJ-së, politika e 'barazisë kombëtare', e sistemit 'vetë qeverisës' dhe bllokut të shteteve të pa inkuadrimit që kishin arritur të gëzonin një autoritet të rrejshëm për gjoja zgjidhjen e drejtë të barazisë nacionale e veçanërisht Jugosllavia Komuniste në krye me Titon. Tërë kjo veprimtari propaganduese, praktikisht ishte thirrje për organizimin e mëtejshëm të popullit, për forcimin, zgjerimin konsolidimin e aktivitetit kombëtarë të shqiptarëve.[99]

Situata e krijuar politike në ish Jugosllavi, gjatë viteve të 80-90-ta, dhe shpërthimi i demonstratave e protestave të dhunshme nëpër të gjitha shtetet e bllokut të mos-inkuadrimit, është dëshmia më e mirë që populli shqiptar i Kosovës, paska pasur të drejtë që e kundërshtoi pushtetin 'vetëqeverisës jugosllav', pasi në të gjitha këto shtete, paska sunduar diktatura, qenkan shkelur e shkelen të drejtat nacionale e kombëtare të popujve të vegjël që jetojnë në to.

Gjatë, hetimeve e dënimeve të anëtarëve të Lëvizjes Ilegale Shqiptare është dëshmuar se në kuadër të lëvizjes, kishte edhe të dënuar të mëhershëm politik nga Llapi që janë të njohur për veprimtari 'armiqësore', kundër pushtetit jugosllav siç janë: Mulla Ramë Govori, Rrustem Statovci, Ramadan Ajvazi, Sabit Kapiti, Adem Demaçi, Selman Berisha, Ilaz Pireva, Xheladin Rekaliu, Osmon Dumoshi, Sabit Syla Ahmet Haxhiu, Ibrahim Demolli, Januz Berisha, Sabit Syla, etj.

Në materialet propagandistike, programet e statutet e tyre, organizatat shqiptare Bashkimin e Kosovës me Shqipërinë apo krijimin e Republikës së Kosovës në kuadër të Jugosllavisë, e parashikonin që të kaloi nëpër disa etapa:

Në etapën e parë të revolucionit parashihej demaskimi e zhveshja e udhëheqjes dhe sistemit vetëqeverisës të Jugosllavisë, pastaj, ngritjen e forcimin e vetëdijes politike kombëtare të popullit në bazë të propagandimit e literaturës legale e ilegale shqiptare

[98] Kujtime, A. Gjata.
[99] Mirvete Dreshaj-Baliu, Jusuf Gërvalla, Prishtinë 2010, f. 205.

që botohej në vend dhe jashtë Kosovës. Për etapën e dytë të revolucionit ishte planifikuar, presioni i pareshtur me anë të protestave e demonstratave për lëkundjen e çrregullimin e brendshëm të udhëheqjes jugosllave, ndërsa për fazën e tretë atë përfundimtare parashihej kryengritja armatosur dhe lufta e drejtpërdrejtë. [100]

## Organizimi i Mbledhjes për fillimin e Demonstratës së 1 e 2 prillit 1981 në Besianë

Më 25 mars 1981 nga anëtarët e organizatave dhe grupeve është vendosur që në shtëpinë e Xhemajl S. Salihut të mbahet mbledhja, ku do të merren vendime të rëndësishme pas shpërthimit të demonstratave të 11 e 26 marsit në Prishtinë. Një, ndër ato vendime ishte edhe marrja për fillimin e demonstratës edhe në rajonin e Llapit. Në mbledhje ishte ftuar edhe Gani Koci, i cili ishte student i Shkollës së Lartë Pedagogjike të Prishtinës nga Salih Salihu që gjithashtu ishte student edhe kryetar i grupit ilegal 'Përsëri në Këmbë'. Grupi ishte formuar gjatë viteve 1976-77 ku disa anëtarë të grupit ishin pjesëmarrës edhe organizator të demonstratës të 11 marsit të vitit 1981 në Prishtinë. Në tubim kishin marrë pjesë edhe këta anëtarë: Xhylë. A. Krasniqi, (Shota e Llapit), Xhafer. Rr. Jashari, Pajazit A. Jashari, Avni R. Ahmeti, Bedri. H. Avdullahi, Rexhep, Xh. Salihu, etj.[101]

Me kërkesën e shumicës së anëtarëve të grupit në këtë mbledhje është marr vendim që organizata të emërohet me emrin e ri 'Shaban Shala', emër të cilin do ta përqafojnë më shumë qytetarët e Llapit, sipas mendimit të shumicës së anëtarëve, pasi atdhetari Shaban Shala nga fshati Letan ishte bërë sinonim i punës dhe organizimit të veprimtarisë patriotike kombëtare te Llapjanët..[102]

Në mbledhje ishin caktuar detyrat, përgjegjësitë e obligimet e çdo anëtari të grupit. Për rregullimin shtizës e sigurimin e flamuri, është caktuar Avdi Latifi që njëherit ishte zdrukthëtar, për shkrimin e parullave ishin caktuar Fehmi Berisha e Bedri Avdullahu, për bartjen e flamurit Gjylë Krasniqi, kurse anëtarët e tjerë ishin ngarkuar për punë të tjera e veçanërisht për njoftimin e shokëve, miqve të afërmve etj, përmbajtjen dhe

[100] Ethem Çeku, vep. e . cit. f. 231.
[101] Salih Salihu,Epoka e Re', Fejton, 13 mars 2002,
[102] Shih ,Aktgjykimi, P-K. Nr. 153/81

daljen në demonstratë me 1 prill 1981, e cila do të filloj në ora 11.oo . Ndërsa kryetari i grupit Salih Salihu është caktuar që të bëjë koordinimin e punës në kuadër të organizatës dhe organizatave tjera, pastaj që ta përcjellë zhvillimin e demonstratës në Prishtinë e t'i njoftoi udhëheqësit e demonstratës në Besianë, për marrjen e mëtutjeshme të vendimeve dhe qëndrimeve në nivel të Kosovës.[103]

Demonstrata në Besianë ka filluar në orën 11.oo, tek shkolla e sotme ekonomike ' Isa Boletini' nga nxënësit e kësaj shkolle që marshimi i protestuesve vazhdonte përgjatë rrugës kryesore të qytetit 'Nëna Terezë' drejtë shkollës tjetër të mesme, gjimnazit '8 Nëntori' e cila është në dalje të qytetit. Edhe përkundër tentimit të mësimdhënësve të shkollës dhe aktivistëve të tjerë politikë që u munduam t'i ndalin nxënësit e klasës së parë e të dytë të Gjimnazit '8 Nëntori', që mos t'i bashkohen demonstratës në rrugë, ishte shumë e kotë. Në ballë të demonstratës ishte flamuri kombëtar, kuq e zi me shqiponjën dy krenare në duart e Gjylë Krasniqit që më vonë në popull është e njohur si 'Shota e Llapit', që shoqërohej nga shokët dhe anëtarët e grupit si Pajazit Jashari, Naser Mustafa, Mehmet Begolli, Bedri Blakçori, Bedri Ajeti, Naim Latifi, Qefsere Gjata, Bedri Abdullahu, Bedri Blakqori, Avni Ajeti, Arsim Hasani Bejtush Zhugolli, Valbona Sh. Shala, Naim Latifi, Mehmet Begolli, Milaim Podvorica, Rukije Selimi, Magbule Shala, Ibush Llapashtica, Rukije Ajvazi, Fexhrie Konushefci, Nebih Maloku, Shahin Svishta, Elife Podvorica, Nazmi Ajeti e qindra e mijëra nxënës dhe student të tjerë

Të gjithë këta nxënës e që ishin edhe organizator të demonstratës arritën t'i thyenin të gjitha pengesat e krijuara nga arsimtarët dhe makineria policore ku më në fund arritën të hyjnë në qendër të qytetit që i priste me padurim masa tjetër demonstruese..[104]

Demonstruesve më vonë iu bashkuan edhe punëtorët e ndërmarrjeve të Besianës siç ishin: Kombinati i Drurit, Fabrika e Materialit Ndërtimor (Tjegullave), Ndërmarrja e Pyjeve (Javori) etj. Diku nga ora 13.00, pothuajse i tërë popullsia e Llapit ishte në Besianë Gjatë kësaj kohe i tërë qyteti ishte në demonstratë, ku pjesëmarrësit, filluan të brohorisin parullat: 'Bashkim Unitet', 'Republikë Kushtetutë, ja me hatër, ja me luftë', 'Lironi shokët nga burgu', 'Rroftë Adem Demaçi', 'Rroftë Enver Hoxha',

[103] Po aty.
[104] Kujtime, Fatime Gjata.

‘Demokraci’, ‘Liri’, Vetëvendosje’, Trepça punon, Beogradi ndërton’ ‘Kush s’bashkohet është tradhtar’ e tjera e tjera.

Pjesa më e madhe e demonstruesve në qendër të Besianës, mbanin në duar bishta të veglave të punës të cilat i kishim marrë në Kombinatin e Drurit, pastaj gur të rrugëve, tulla e sende të tjera që ishin detyruar t’i mbajnë, pasi policia qysh në fillim të saj filloi ta përdorë dhunën e gazin lotsjellës, për shpërndarjen e turmës. Diku aty rreth orës 16.00 në pjesën jugore të Besianës apo fushës e cila gjendet në mes hekurudhës, motelit Besiana e lagjes të Rastelicëve e Blakajve, njësia speciale e policisë, kishte filluar t’i sulmoi e të shtijë me armë kundër masës së madhe e demonstruesve. Derisa policia shtinte me armë, nënën tjetër nga shtëpitë e këtyre lagjeve, qytetarët kishin filluar t’i kundërpërgjigjeshin policisë me armë zjarri, për t’ia ndal turrin njësive speciale të ardhura nga Serbia, përgjatë rrugës magjistrale Nish-Besianë-Prishtinë.

Me kohë, qytetarët dhe demonstruesit ishin përgatitur e pozicionuar në rrugë, ku kishin vendosur pengesa e barrikada nga materiale të ndryshme. Ata kishin parkuar autobus, kamion, traktor, gur, vegla të punës e sende të tjera. Në rrugën magjistrale Nish-Besian-Prishtinë, demonstruesit kishin filluar të bënin edhe legjitimimin e njerëzve, kurse ata që ishin pak të dyshimtë, ktheheshin prapa nga kishin ardhur, çarmatoseshin nëse kishin armë e pastaj liroheshin. Aty kah ora 18 demonstruesit janë përqendruar para Bashkisë së Besianës, ku organizatorët e qytetarët e tjerë mbanin fjalime të zjarrta kombëtare e politike, që mbaheshin lartë nga duart e protestuesve për t’u parë nga i tërë populli. Në mbrëmje, aty diku kah ora 21.00, masa filloi të largohet nga rrugët, e të shpërndahet, pasi kishte filluar të bie terri i mbrëmjes.

Të nesërmen më 2 prill 1981 demonstrata filloj prapë nga SHMT-ke, e që masës i prinin Muharrem Ismajli, Pajazit Jashari, Gjylë Krasniqi, Sabri Hamiti, Ibush Llapashtica, Rukije Ajvazi, Refik Shala, Behxhet Mehmeti, Fatime Gjata, Rukije Selimi, Ejup Shala, Xhafer Jashari, Avdi Gjata, Hamit Hamiti, Isak Mustafa Mehmet Begolli Qamërie Shala, etj. Ditën e dytë të demonstratës iu bashkëngjitën edhe pjesa më e madhe e profesorëve e arsimtarëve të shkollave fillore e të mesme të Besianës, të cilët mundoheshin t’i përcillnin nxënësit e tyre e t’i udhëzonin që mos të ndahen nga turma e protestuesit se munden të lëndohen e të rrahën nga policia. Gjatë demonstrimit nëpër qytet, demonstruesit ndihmoheshin me gjëra ushqimore me sende e ndihma të tjera e herë pas here, nëse edhe paraqitej nevoja siç ishin: blerja e gjërave ushqimore,

pallomave, limonit, portokajve, mollëve, qepëve e zarzavateve tjera ato i blenin dhe i jepnin vet popullsia. Në mëngjesin e 2 prillit nga Besiana u nisën të shkojnë disa dhjetëra autobus të mbushur me demonstrues për qytetin e studentit, për t'i ndihmuar motrat e vëllezërit, djemtë e vajzat e tyre student që ishin duke u ndeshur ballë për ballë me policinë. Dita e dytë e demonstratës në Besianë ishte shumë më e madhe për nga numri, mosha, kualifikimi, për nga organizimi dhe rregulli pasi në te ishin hyrë edhe profesor, edhe punëtorë edhe student e fshatarë që kishin ardhur dhe u bashkuan me djemtë e vajzatë e veta që ishin nxënës e nxënëse në shkollat e mesme në Besianë.

Për, pjesëmarrjen e një numri të madh të profesorëve në demonstrata së bashku me nxënësit e tyre, dëshmojnë edhe vlerësimet e udhëheqësve më të lartë të Kosovës kur dalin para opinionit për vlerësimin e demonstratave të vitit 1981, që ndër të tjera Fadil Hoxha thotë: 'Mendoj se duhet thënë profesorëve dhe arsimtarëve që mos ti përfshijmë të gjithë, kanë rënë në provim edhe atë, kanë rënë shumë seriozisht dhe duhet të theksohen ata profesor dhe drejtor shkollash që janë treguar luftarak e të vendosur, dhe që i kanë penguar fëmijët të dalin në rrugë të merren shembull si duhet luftuar armiku'.[105]

Diku, kah mesi i ditës, Gjylë Krasniqi tek moteli Besiana iu drejtua masës me një fjalim të zjarrtë prej një atdhetareje të flakët, duke iu ngritur demonstruesve moralin, energjinë e forcën dhe duke ia sqaruar rëndësinë e demonstratës e kërkesave të drejta të shqiptarëve, që duhet t'i gëzojnë, mirëpo këtë pushteti jugosllavë ia ka mohuar pas luftës shqiptarëve të Kosovë e të Llapit. Populsia e fshatrave të Klysyrës, Rimanishtës, Majacit, Barilës,, Besisë, Vranidollit (Dafinetit) etj, si edhe ata të Prishtinës, kishin organizuar demonstrata në rrugën magjistrale Prishtinë-Besianë në Besi, tek ura mbi hekurudhë një barrikadë të fuqishme për ta pasur nën kontroll situatën e rënduar e cila nga çasti në çast, vinte duke u bërë më e ashpër dhe më e rrezikshme[106]

Kordoni i policisë serbe prej 30 kamionësh të njësive speciale u detyruan të ndalen nga grupi i të rinjve, që me gur e një pushkë gjuetie, arritën t'i çarmatosin plotësisht dhe të ia marrin komplet armatimin dhe pjesët tjera që i kishin pasur me vete. Më vonë

[105] ' Kosova sot '-18 nëntor 2006. Fejton , Çfarë tha udhëheqja Kosovare për demonstratat e viti 1981.
[106] Avdi Gjata, Kujtime.

këta demonstrues të rinj u dënuan në tri grupe me burg të rëndë prej 1 viti deri në 15 vite, më shumë se 37 veta.[107]

Këto tri grupe demonstruesish, arritën t'ia marrin gati të gjitha armët që ishin nisur për Kosovë e për t'i veshur e armatosur popullsinë serbe të Kosovës siç ishin: Pushkët automatike, automatik 47, mitraloz, maskat, e jelek kundër plumb. Aty u ndezën edhe tre kamion që u vendosën në mes të rrugës. Kjo çarmatosje e ushtrisë, pati rëndësi të shumëfishtë, si nga ana fizike, psikologjike e morale në popull, pasi ishte sulmi i parë i organizuar pas viteve 50-ta ndaj ushtrisë dhe policisë Jugosllave, që arritën t'i çarmatosin njësitë speciale serbe e cila theu edhe mitin që ishte krijuar në psikologjinë e popullit shqiptarë me dhunë, se: 'ushtria jugosllave është e pathyeshme' nga njëra anë, kurse nga ana tjetër, lëvizja arriti të siguroj një pjesë të armëve që ishin shumë të nevojshme gjatë punës së mëtejshme ilegale kombëtare.[108]

Më 2 prill 1981, Beogradi shpalli gjendjen e jashtëzakonshme në Kosovë dhe ndaloi me urdhëresë të posaçme qarkullimin e mbi dy vetave së bashku në vendet publike e cila urdhëresë vlen edhe për qytetin e Besianës. Ndërpreu mësimin në shkollat fillore, të mesme po edhe në Universitet. Mbylli konviktet e nxënësve e ndaloj qarkullimin e autobusëve për bartjen e qytetarëve nga fshatrat në qytet. Masa të njëjta u morën edhe nëpër komunat tjera të Kosovës.[109]

Ndonëse, opinioni ndërkombëtar, demonstratat i cilësoi paqësore, ndonëse kishin karakter demokratik e kombëtarë, në rajonin e Llapit nga çdo republikë jugosllave, erdhën njësi të shumta policësh dhe ushtarakësh. Kundër demonstruesve u përdorën: bomba me gaz lotsjellës, shkopinj gome e kërbaç, gazra helmuese e kimike, armë zjarri, tanke, helikopterë, autoblinda, aeroplan luftarak e mjete tjera të nevojshme. etj.

Ndonëse, kërkesat që u shtruan në demonstratë në Besianë, ishin të drejta, të ligjshme e nuk dilnin jashtë Kushtetutës së RSFJ-së, ato prapë se prapë u cilësuan si 'kundërrevolucionare', ndërsa nxënësit e studentët 'armiq kundërrevolucionar' dhe 'irredentistë shqiptarë'. Këto epitete shërbyen si bazë themelore me të cilat përcaktoheshin, karakterizoheshin, dhe dënoheshin demonstruesit e demonstratat deri në çlirimin e Kosovës nga sundimi serb. Këto shprehje politike u përdorën për të legjitimuar e justifikuar dhunën si edhe masat e mjetet e dhunës që i zbatuan pa i

[107] Shih Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, nr. 147/81
[108] Po aty.
[109] Broshura , Shtypi i huaj për ngjarjet në Kosovë, Tiranë,1981,f, 42

ndërprerë në këto ngjarje. Ndaj organizatorëve të demonstratës në Llap, pushteti përdori masat më drastike që mund ti përdorë një popull në mes të Evropës. Ai i rrahu i keq trajtoi i torturoi, i arrestoi dhe i dënoi me burgje deri në 15 vjet që ishte një shok për opinionin e brendshëm e të jashtëm botëror.

Vrasjet dhe mizoritë ndaj shqiptarëve, bëheshin edhe gjatë qëndrimit të tyre nëpër burgjet e Kosovës siç ishin rasti i Sami Ramës i cili gjatë hetimeve në burgun e Prishtinës, pas një jave, vdes nga torturat e marra nga sigurimi i Prishtinës.. Gjithashtu edhe Xhemajli Berisha në burgun e Prizrenit edhe në burgun e Ferizajt, hidhen nga dritaret të burgosurit për t'i mbuluar gjurmët e dhunës të ushtruar gjatë hetimeve për t'i zbuluar organizatorë dhe pjesëmarrësit e demonstratës. Sipas të dhënave zyrtare na del se nacionalistët. 'shqiptar' gjoja duke mos dashur të tregojnë për organizatorët e shokët e vet, kërcyen nga dritarja e burgut që u lënduan rëndë dhe nga plagët e marra vdiqën.... që nuk është aspak e vërtetë.[110]

U dënuan, po çka nuk u dënua e nuk u bë ndaj studentëve shqiptar që kishin marrë pjesë në demonstratë, u dënuan dhe maltretuanë profesorët e tyre, ngase e kishin përkrahur kërkesën e tyre, 'Kosova Republikë'. Këtë, më së mirë e ilustron rasti i profesorit të Universitetit të Prishtinës, diplomati e politikani shqiptar e një herë edhe Sekretar Krahinor i Kosovës për politikë të jashtme Mr. Ukshin Hoti, për fatin e të cilit nuk dihet ende, po që (realisht dihet, po nuk po kemi dëshirë ta pranojmë të vërtetën, pasi e vërteta sa është e mirë, është edhe e hidhur) pasi që është i vetmi intelektual që publikisht i përkrahu dhe i quajti të drejta demonstratat dhe kërkesat e rinisë së Kosovës të vitit 1981 që është edhe vit i kthesës së rrotës historike për së mbari për popullin shqiptar.[111]

Dënoheshin qytetarët e zakonshëm pse u kishin dhënë ndihmë studentëve, u dënuan edhe ata që i kishin strehuar djemtë dhe vajzat e veta. Dënoheshin gratë e nënat pse mbronin bijtë dhe bijat e veta, e më në fund dënoheshin edhe fëmijët se nesër edhe këta do të bëhen armiq të Jugosllavisë. Ilustrimi më i mirë i dënimit të fëmijëve është marrja në burgun e Besianës të nxënëses së klasës së shtatë të shk.. fillore 'Emin Duraku' në Bajçinë, nxënësen, Merita Gjata pse ia kishte uruar arsimtarit të gjuhës shqipe Bajram H. Gjatës, Ditën e Mësuesit '7 Marsin' në mars të vitit 1985 pasi axha

[110] A. Gjata, vep. e perm, f. 116.
[111] U, Hoti, vep. e përm, f. 96

e daja i saj Avdi Gjata Xheladin Rekaliu ishin veprimtar të Lëvizjes dhe ishte dënuar me tetë vjet burg, që ishte duke i vuajtur në burgun e Zajeçarit në Serbi. Dënoheshin edhe ushtarët shqiptarë kudo që ndodheshin, duke i dënuar për çështje politike edhe pse shprehnin mendimet e tyre për çështjen e Kosovës, por nuk kishin fakte e as argumente të mjaftueshme për vepër penale. Në shërbimin ushtarak jugosllav edhe nga rajoni i Llapit u dënuan disa dhjetëra ushtar shqiptar .

## Dënimet e grupeve ilegale shqiptare në Llap (1981-1990)

Pas demonstratave që u zhvilluan në Prishtinë dhe në qendrat tjera të Kosovës ato u shtrinë edhe nëpër rajone e qytete tjera. .Demonstratat u organizuan edhe në rajonin e Llapit për të cilat u dënuan një numër i madh i grupeve, qytetarëve dhe individëve nga të gjitha gjykatat ekzistuese në jugosllavi, duke filluar nga gjykatat komunale, gjykatat e qarkut dhe gjykatat ushtarake. Dënimet që iu shqiptuan shqiptarëve për veprimtari politike brenda viteve 1981-1990 do t'i paraqes me radhë në bazë të aktvendimeve të gjykatave që iu shqiptuan shqiptarëve për pjesëmarrje dhe organizim të demonstratave si edhe për veprimtari 'armiqësore'. Gjithashtu ne do të mbështetemi edhe në vendimet e Aktgjykimeve të Gjykatave të Kosovës, po edhe të Gjykatave të tjera të Jugosllavisë me radhë.

Emërimi i grupeve dhe organizatave ilegale është bërë kryesisht nga veprimtaria politike e grupit, udhëheqësit të grupit apo organizatës, radhitjes në aktgjykim, apo edhe prej viteve të dënuara.

Në procesin gjyqësor që u mbajt më 22 korrik 1981 kundër grupit të të rinjve në Prishtinë, që morën pjesë në demonstratat e 1e 2 prillit 1981 në Besianë e Prishtinë si edhe në çarmatosjen e ushtrisë dhe kolonës së policisë serbe, akuzohen dhe dënohen 37 pjesëtar shqiptar të cilët i ndajnë në tri grupe. Ndarjen në grupe e bëjnë me qëllim që para opinionit grupet të duken sa më të vogla, jo të organizuara mirë dhe jo të fuqishme me qëllim që ta fshehin forcën dhe punën politike që e kishin bërë organizatorët e Lëvizjes.

Sipas vendimit të Prokurorisë Publike në Prishtinë të 15 korrikut 1981, pas mbajtjes së seancës kryesore, publikuan dhe ngritën aktpadinë me të cilën akuzohen 17

pjesëmarrës që kanë marrë pjesë në çarmatosjen e kolonës së policisë. Ata, afër shkollës fillore në fshatin Besi, kanë bërë vepër penale kundër rregullimit politiko-shoqëror, kundër 'barazisë së kombeve e kombësive' dhe ndryshimit të Kushtetutës së Jugosllavisë me dhunë, thuhet në aktakuzë. Nga ora 11 deri në orën 18.00 grupi i përbërë prej afro 5oo protestuesish para shkollës Nexhmi Mustafa në Besi, kanë brohoritur parullat 'Kosova Republikë' , Unitet' 'Duam Republikë ja me hatër ja me luftë' etj.Të pandehurit e kanë ndaluar kolonën e automjeteve të SPPB të ngarkuar me armë të cilat vinin nga Beogradi e nga Serbia për ta qetësuar situatën. Ata ia kanë marrë një numër të madh të armatimit e pushkëve automatike policisë dhe ushtrisë të cilat ia kanë shpërndarë demonstruesve që protestonin në fshatin Besi[112].

Grupi i përbërë prej 11 vetave të cilët kishin marr pjesë në demonstrata me 1 e 2 prill 1981, kishin arritur t'i çarmatosin policinë serbe në fshatin Besi, me 2 prill që gjithsejtë u dënuan me 105 vjet burg të rëndë. [113]

## 7. 1 Gjykimi i grupit të miturve Besianë

**G**rupi i të miturve i cili mori pjesë në demonstratat e 1 e 2 prillit të vitit 1981 dhe në çarmatosjen e policisë serbe e cila vinte nëpër rrugën që kalon përmes Besianës për në Prishtinë në vendin e quajtur Besi, morën pjesë në çarmatosjen që ia marrin armët organeve të punëve të brendshme të SPPB-së të Beogradit të cilat i kishin të dedikuara për serbët e Kosovës dhe për përdorimin e tyre për ta shuar demonstratën e studentëve dhe popullit shqiptar të Kosovës.

Grupin e të rinjve e përbënin kryesisht djemtë që ishin nën moshën 18 vjeçare dhe ishin 18 veta. Ata u dënuan gjithsejtë me 36.6 vjet burg të tipit të mbyllur që akuzohen për veprimtari 'armiqësore' për përmbysjen e rendit socialist dhe vëllazërim bashkimit të popujve të Jugosllavisë. Me armët e marra protestuesit në afërsi të fshatit kanë mësuar edhe përdorimin e tyre. Pjesën më të madhe të armë vet e kanë fshehur nëpër shtëpitë e tyre me qëllim që më vonë t'i përdorin në veprimtarinë 'kundërrevolucionare'[114]

---

[112] Aktakuza e Prokurorisë Pubblike të Kosovës nr. 1981/1984.
[113] Po aty.
[114] Aktgjykim i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, nr. 11/81

***1.Fadil A. Shala, nxënës (1964), Prugovc, Progos, neni 114 LPJ. 22. 07. 1981 (3 vjet burg)***

***2. Naser R Rexha, nxënës (1965), Rimanishtë, neni 114/LPJ. (4 vjet burg)***

***3. Agim S. Leci, nxënës (1964), Barilevë neni, 135/LPJ. (5 vjet burg)***

***4. Ekrem A Dragush, nxënës (1963), Prugovc, neni, 135/LPJ (3 vjet burg)***

***5. Shemsi M Leci, nxënës (1964), Barilevë, neni 135/LPJ (4 vjet burg)***

***6. Afrim Rr Bllacaku, nxënës (1964), Besi, neni 114/LPJ. (5 vjet burg)***

***7. Veton B Osmani, nxënës (1964), Besi, neni 135/1, 114 LPJ. (1, 6 muaj burg)***

***8. Avni B.Llumnica,nxënës (1964), Barilevë, neni 135/1,114 LPJ. (2 vjet burg)***

***9. Xhafer Q. Fetahu, nx. (1964), Rimanishtë, neni 135/1,114 LPJ. (2 vjet burg)***

***10.Xhemshit K.Keci, nx. (1965), Barilevë, neni 135/1 , 114 LPJ. (2 vjet burg)***

***11. Lutfi H Leci, nx. (1965), Barilevë, neni 135/1 LPK, (SHNP).***

***12. Pajazit H Leci nxënës (1965), Barilevë, neni 114 LPJ, (SHNP).***

***13. Nexhat S Dragusha, nx.(1965) Rrugovc, neni 114 LPJ, (SHNP).***

***14.Osman H Abdullahu, nxënës (1966), Vranidoll, neni 114 LPJ, (SHNP).***

***15. Sami N Abdullahu, nxënës 1966), Vranidoll, neni 135/1 LPK, (SHNP)***

***16. Osman S Abdullahu, nxënës (1965); Sharban, neni 135/1LPK, (SHNP).***

***17. Zenel Rr Krasniqi, nxënës (1965), Lupç, neni 135/1 LPK, (SHNP).***

***18 Ismail A Koliqi,nxënës (1966), Lupç, neni 135/1 LPK, (SHNP).***[115]

Për pjesëmarrje në demonstratën e 1e 2 prillit të vitit 1981 në qytetin Besianës arrestohet edhe i riu Ramë Hajdar Hajdari i cili pas mbajtjes një kohë të gjatë nën hetime nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë, dënohet me katër vjet burg i cili ishte edhe njëri nga demonstruesit më të dalluar e më të emocionuar, edhe njëri nga prijësit e prijësit e demonstratës në Besianë.

***1. Ramë H. Hajdari, nxënës, (1963) ,nga fshati Sikiraq komuna e Podujevës dënohet me neni. 114. LPJ. më 16. 07. 1981 me (4 vjet burg).***

[115] Po aty.

7.2 Gjykata e Qarkut në Prishtinë me nr. 144/1981 iu shqipton dënimin grupit të përbërë Hazir A Fejzës dhe Nazmi H. Shaqirit të cilët dënohen me gjithsejtë 15 vjet burg për pjesëmarrje në demonstratë dhe bartjen e demonstruesve me autobus prej Besiane në Prishtinë me 2 prill të vitit 1981.

***1. Hazir A. Fejza, shofer, (1946) ,nga fshati Dobratin kk.Podujevë, dënohet me nenin 114. LPJ, më 10. 09. 1981 me (8 vjet burg)***

***2. Nazmi Hajdin Shaqiri, shofer,(1947) nga fshati Dumnicë komuna e Podujevës dënohet me nenin 114. LPJ, 10.09. 1981 me (7 vjet burg).***[116]

## 7.3 Dënohet grupi i përbërë prej Gani R. Lutani dhe Ismet E. Zeneli të komunës së Besianës

Gjykata e Qarkut në Prishtinë, ia filloi gjykimit e dy shqiptarëve për shkak se kanë marr pjesë në demonstratën e 1 e 2 prillit 1981 në Besianë. Këtë grup e përbëjnë Gani R. Lutanit nga fshati Llapashticë dhe Ismet E. Zenelit nga fshati Pakashticë (Albonë) të cilët dënohen me12 vijet burg me nenin 114 të ligjit penal të Jugosllav që është i ligj paraparë me Kushtetutën e Jugosllavisë,për veprim kundër shtetit dhe përmbysjes s'rendit shoqëror.

***1. Gani R, Lutani, punëtorë, (1956) Llapashticë, neni, 114, LPJ, 24. 09. 1981. (7 vjet burg)***

***2 Ismet Ejup Zeneli punëtorë ( 1949), Pakashticë, neni, 114, LPJ, 24, 09, 1981. (5 vjet burg).***[117]

## 7.4 Vazhdon shqiptimi i dënimit të Grupi i Zymber H. Krasniqit nga Besiana.

**G**jatë tërë vitit 1981 nga gjykatat jugosllave e veçanërisht ato të Kosovës vazhdonin dënimin e grupeve të shqiptarëve pa ndërprerë për shkak të pjesëmarrjes në demonstrata dhe organizimin e grupeve ilegale të cilat asnjëherë nuk e ndalën së vepruarit. Për këtë arsye u dënua edhe grupi i ashtuquajtur si grupi i Besisë me

[116] Aktgjykimi, i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë nr. 144/81
[117] Aktgjykimi, i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë nr. 139/81.

gjithsejtë 98 vjet burg, pasi kishin çarmatosur kolonën e policisë jugosllave dhe kishin marrë pjesë në demonstratat e prillit. Sikurse grupet tjera edhe këta akuzohen për prishjen e rendit e të qetësisë si edhe për tentim për përmbysjen e rendit shoqëror të Jugosllavisë.

***1. Zymber H. Krasniqi, bujk (1960), Breznicë, neni 114 LPJ. 28 09.1981. (13 vjet burg)***

***2. Bajram H Syla, nxënës, (1963), Rimanishtë, neni 114 LPJ. (12 vjet burg).***

***3. Qerim M Arifi, bujk, (1961) Rimanishtë, neni. 114 LPJ. (8 vjet burg)***

***4 Nagip S Blaca, bujk, (1961), Besi, neni 114 LPJ. (12 vjet burg)***

***5. Nait Bahtir Statovci, nxënëx, (1962) Prugovc neni 114 LPJ, 28. 09.1981. (10 vjet burg)***

***6. Sadik Rexhep Dragusha, bujk (1949) Prugovc neni 114 LPJ, 28. 09. 1981 (10 vjet burg)***

***7. Shaban Xhafer Dragusha, punëtor, (1957) Prugovc, neni 137 LPJ, 28.09. 1981. (7 vjet burg)***

***8. Ramadan Bajram Rexha, punëtorë (1922) Rimanisht, neni, 137 LPJ, 28.09. 1981. (7 vjet burg)***

***9. Enver Murat Koliqi, i pa punë, (1955), Lupç, neni, 114 LPJ, 28.09.1981. (8 vjet burg)***[118]

***10.Nexhmedin Hasan Pireva, i papunë, (1955) Lupç, neni 114 LPJ, 28.09. 1981. (13 vjet burg)***

***11 Sadik bajram Buja, punëtorë (1956)Bujan, neni, 114 LPJ, 28.09.1981 me (8 vjet burg).***

## 7.5 Shqiptohet dënimi anëtarëve të Organizatës Shaban Shala nga Besiana

Vitet 1980-1981 në historinë moderne botërore njihet si vit i ndryshimeve të mëdha në Evropë po edhe në vendet tjera që sundoheshin nga diktator dhe mbretër të cilët qeverisnin duke u mbështetur në dhunën e shtetit. Edhe tek populli shqiptar në

[118] Shih, Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. nr. 110/ 81.

Jugosllavi, ky vit njihet si viti i lirisë i kthesës së madhe kombëtare e historike që e kishte imagjinuar me decenie të tëra. Veçanërisht i interesuar ishte populli shqiptar i Kosovës i cili gjatë gjithë periudhës së pas luftës nuk kishte pushuar as një moment veprimin ilegal për krijimin e shtetit të Kosovës. E në kuadër të kësaj edhe Llapjanët u dalluan në organizimin dhe veprimin kombëtar kundër robërisë jugosllave. Për këtë qëllim në muajin shkurt të vitit 1980 Salih Xhemajl Salihu e caktoi një takim në shtëpinë e vet ku marrin pjesë 6 pjesëmarrës të cilët u pajtuan që ta themelojnë organizatën ilegale të cilën e emërtuan, Përsëri në këmbë. [119] Në këtë takim, kryetar zgjidhet Salih Salihu, kurse arkëtar Selatin Shala. Me qëllim të veprimit sa më sekret të anëtarëve u caktohen pseudonimet dhe sistemi i punës. Pastaj, Salih Xh. Salihu, angazhohet për t'u pajisur me material dhe me përmbajtje propaganduese, kundër sistemit socialist vetëqeverisës të Jugosllavisë siç janë fletushka 'Bashkimi i Kombit,' 'Libreza të Enver Hoxhës', mbi cilësitë e anëtarit të PPSH-së etj. Këto materiale ua jep të tjerëve me qëllim që t'i frymëzoi dhe t'i bënë anëtar. Me angazhimin e tij arrin që të përfitoi një numër të konsiderueshëm, kryesisht nga radhët e nxënësve e studentëve. Pastaj më vonë me më 25 mars 1981 organizon takimin e dytë në shtëpinë e tij që numri i pjesëmarrësve ishte më shumë se 20 student e nxënës, me ç' rast e formojnë organizatën 'Shaban Shala'. Në këtë takim merr pjesë edhe Gani Koci student i Universitetit të Prishtinës si 'emisar' nga Prishtina[120]

Kryetari Salih SAlihu, në mbledhje e paraqet rendin e ditës prej pesë pikash dhe e shpjegon para të pranishëmve qëllimin e takimit të mbledhjes. Më 26 mars 1981 merr pjesë në demonstratat e organizuara në Prishtinë me flamur në dorë, qëndron në ballë të demonstratave. Pasi tani vetëm gjërat ishin të karta, me 29 mars 1981. merr pjesë në takimin e organizuar me nxënësit e QAMO-së, '8 Nëntori' ku ishin të pranishëm edhe Fehmi Berisha në shtëpinë e Avdi Latifit. Në këtë takim aktualizohet çështja e bojkotimit të mësimit në shkollat e mesme dhe daljen në demonstrata me 1 dhe 2 prill 1981 në Besianë, ku është brohoritur parullat armiqësore 'Kosova Republikë', 'Republikë Kushtetutë ja me hatër ja me luftë', 'Lironi shokët nga burgu', 'Poshtë borgjezia' 'Rroftë Adem Demaçi' etj. Në këto demonstrata pasi organet policore filluan ta përdorin dhunën masa filloi që ti thyej xhamat e lokaleve të cilat ishin pronë

[119] Shih, Aktakuzën e Prokurorisë Publike nr. 153/1981.
[120] Po aty.

shoqërore pastaj deri diku është dëmtuar edhe ajo private e veçanërisht është dëmtuar në përmasa më të mëdha, prona e firmave që ishin pronë e Serbisë.

I akuzuari Fehmi Berisha. veprimtarinë e tij armiqësore e kishte filluar qysh në vitet 1976-1977 që e vazhdon deri në vitet 1981 kur edhe arrestohet nga organet shtetërore. Gjatë vitit 1980 arrin që të furnizohet me literaturë të ndryshme propagandistike siç janë revistat 'Lajmëtari i Lirisë', 'Fronti i Kuq',si edhe materialet e tjera propaganduese kundër Jugosllavisë që ekzistonin në atë kohë. Këto materiale ia shpërndau anëtarëve, shokëve e miqve, ndër ta edhe të akuzuarve Ejup Shalës dhe Hamdi Mustafës etj. Më 28 mars 1981 në oborrin e shkollës QAMO '8 Nëntori' nxënësve të kësaj shkolle iu flet për nevojën e organizimit të demonstratës në Podujevë në shenjë të përkrahjes të demonstratave të studentëve në Prishtinë.[121]

Më 30 mars 1981 shkon në fshatin Dyz, ku e blen edhe materialin e nevojshëm për përgatitjen e pamfleteve, parullave e materialet tjera për ditën e demonstratës. Më 31 mars bëhet një takimi i të akuzuarve nga Hamdi Mustafa, Avdi Latifi, si edhe me dëshmitarin e më vonshëm Xhemajl Hoxha nga fshati Kastrat që të bisedojnë rreth mënyrës se si nesër do ta fillojnë demonstratën me 1 e 2 prill 1981. Aty u vendos që demonstrata të niset nga dy qendrat e mesme shkollore në Besianë. Përkundër dëshirës që kishte nuk arriti të marr pjesë në nisjen e demonstratës, pasi në mbrëmjen e vonë të 31 marsit, arrestohet nga policia që nuk arriti të marr pjesë në 'Dasmën e Madhe që i quanim në at kohë demonstratat.[122]

Pas demonstratës së 1 e 2 prillit 1981 Besianë po edhe në Kosovë, për çdo demonstratë tjetër që organizohej me rastin e përvjetorëve apo ndonjë fete tjetër siç ishte 28 Nëntori apo ndonjë tjetër, kur e ftonim shokun apo dik tjetër për demonstratë i thoshim se a po vjen në dasmë apo je i thirrur nesër në dasmë.

Gjithashtu i burgosuri profesor Ejup Shala pas demonstratave që janë zhvilluara në Podujevë, Prishtinë e shumë qytete tjera të Kosovës, iu ka dëftuar nxënësve të gjimnazit se kjo tregon që shqiptarit asnjëherë nuk i ka munguar trimëria, ku pastaj i udhëzon që ata të bojkotojnë mësimin. Një herë i paska thënë nxënësit Irfan Mustafës se 'nuk ka më mirë se kur populli ngrihet në demonstratë e i kërkon të drejtat e veta, pasi ne jemi të shtypur nga Serbia dhe se ajo na shfrytëzon çdo ditë që nga hyrja e saj

[121] Aktakuza e Gjykatës së Qarkut, ndaj grupi Shaban Shala.
[122] Po aty.

në Kosovë në vitin 1912. Gjithashtu, ai kërkon nga nxënësit që edhe t'i qethin flokët në shenjë solidarizimi me demonstratat.[123]

Edhe Hamdi Mustafa nga fshati Vendenis i cili është profesor në gjimnazin 8 nëntori, përveç veprimtarisë së tij të përshkruar më lartë, në bisedë me Xhemajl Hoxhën e analizojnë situatën dhe e diskutojnë përmbajtjen e programit të televizionit të Prishtinës. Ata në vendet publike demaskojnë lajmet dhe gjykimet e demonstratave që bëheshin përmes televizionit të Prishtinës, duke i quajtur ato gënjeshtra dhe të pa argumentuara, ndërsa komentet e 'Zërit të Popullit' të Tiranës janë reale

Në gjykimet që iu bëhet anëtarëve të grupit thuhet se nxënësit, Sylejman Mustafës, Xhemajl Hoxhës, Xhafer Jasharit, Bedri Avdullahut, dhe Hamit Kopallës ata e kanë lexuar vjershën **Vuajtjet Tona** që e ka shkruar i Selatin Shala. Mandej vazhdon se organizata Përsëri në Këmbë e ka paraqitur edhe programin e saj i cili kishte aprovuar 18 pika të veçanta rreth çështjes së statutit të Kosovës. Gjatë kësaj kohe është bërë edhe shpërndarja e fletushkave si 'Bashkimi i Kombit', pjesë të fletushkës 'Liria'nr. 1 dhe 2 të vitit 1980, 'Fronti i Kuq' dhe 'Lajmëtari i Lirisë' dhe pjesërisht edhe për mbrojtjen e të burgosurve dhe të dënuarve politikë shqiptar.

Në bazë të kësaj aktakuza shkruan se veprimet e të arrestuarëve, Salih Salihut Fehmi Berishës, Avdi Latifi, Selatin Shala, Hamdi Mustafa dhe Ejup Shala e kanë formuar organizatën Përsëri në Këmbë dhe se qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale 'Bashkimit për veprimtari armiqësore' me ligjin jugosllav kundër shtetit dhe bashkimit me Shqipërinë nënë.[124]

## 7.5 Gjykimi i grupit Shaban Shala nga Besiana

Më datën 28. 09 1981 Gjykata e Qarkut në Prishtinë ia shqipton dënimin grupit Shaban Shala të Besianës i përbërë prej gjashtë vetash me gjithsejtë 58 vjet burg

pasi që Gjykata mendon se janë të nevojshme për tu përmirësuar këta të burgosur shqiptar.

***1. Salih Xh. Salihu, studenti lindur më (1960) në fshatin Dumnicë të Vushtrrisë i rritur në Besianë, dënohet me nenin 136. të LPJ më 28. 09. 1981 me 15 vjet burg.***

---

[123] Po aty.

[124] Arkivi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, nr. 153/81.

***2. Fehmi I Berisha, student i lindur më 1955 në fshatin ,Dyz të Podujevës dënohet me nenin 136 të LPJ me 15 vjet burg.***

***3. Selatin Y. Shala, bujk i lindur në fshatin Bajçinë të Podujevës dënohet me nenin 136, LPJ me 11 vjet burg.***

***4 Avdi M. Latifi, Bujk i lindur më 1930 në fshatin Pollatë të Podujevës dënohet me nenin 136, të LPJ me 9 vjet burg.***

***5.Hamdi A. Mustafa,arsimtar i lindur në fshatin Gllamnik të Podujevës dënohet me nenin 136 të LPJ me 4 vjet burg.***[125]

***6. Ejup H. Shala, profesori i lindur në fshatin Konushevc Podujevës dënohet me neni, 133 të LPJ me 4 vjet burg.***

## 7.6 Shqiptimi i dënimit të Grupit të Hajrullah L. Dragushës të Besianës.

Në Prishtinë sot më 20.10. 1981 filloi dënimi i grupit nga Besiana për veprimtari 'armiqësore' kundër Jugosllavisë për shkak se marr pjesë në demonstratat e 1 e 2 prillit të vitit 1981 në Besianë, Prishtinë dhe në Besi. Gjithashtu ata janë pjesëmarrës në çarmatosjen e kolonës policore dhe ushtarake e cila ishte duke bajtur armatim për nevojat e policisë dhe të mbrojtjes së popullsisë gjatë demonstratave të cilët kanë bërë cenimin e ligjit dhe rendit kushtetues të Jugosllavisë që kishin për qëllim përmbysjen me dhunë të pushtetit shoqëror thuhet në Aktgjykimin e Gjykatës së Prishtinës.[126] Për këtë qëllim anëtarëve të këtij grupi iu shqipton dënimet si vijon më poshtë.

***1. Hajrullah L. Dragush i lindur në fshatin Prugovc dënohet me nenin 114. LPJ më 20. 10. 1981. me 3 vjet burg.***

***2. Agim L. . Leci, i lindur në fshatin Barilevë me neni 114. LPJ dënohet me 12 vjet burg të rëndë.***

***3. Agim S. Selmani, i lindur më 1960 në fshatin Barilevë dënohet me neni 114. LPJ me gjithsejt 13 vjet burg***

***4. Ibush H. Kelmendi, i lindur më 1950 në fshatin Prugovc me nenin 114. LPJ me gjithsejtë 10 vjet burg***

---

[125] Shih, Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P.nr.153/81.
[126] Shih Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P.nr.147/81.

***5. Osman Z. Krasniqi i lindur në fshatin Bërnicë dënohet me nenin 114 të LPJ me 10 vjet burg.***

***6. Vehbi Q. Leci i lindur më 1957 në fshatin Besi dënohet me nenin 114 të LPJ me 11 vjet burg.***

***7. Zijadin R Hosha i lindur në qytetin e Prishtinës më 1961 dënohet mecenin 114 të LPJ me 15 vjet bur***

***7. Sami M. Leci i lindur në fshatin Barilevë më 1961 dënohet me nenin 114 të LPJ me 14 vjet burg.***

***8. Ruzhdi I. Hajdini i lindur në fshatin Mirovc të Podujevës më 1956 dënohet me nenin 114 të LPJ me 15 vjet burg.***[127]

## 7.7 **Shqiptimi i dënimi i grupit të Nexhmi Balajt nga Besiana**

Grupi i përbërë prej 5 vetave nën drejtimin e profesor të gjuhës dhe letërsisë Nexhmi Balës i cili veprimtarinë kombëtare e kishte filluar gjatë vitit 1979 deri në burgosjen e tij sot më 6. 10. 1981 fillon dënimi i grupit i cili kishte për qëllim përmbysjen e pushtetit të Jugosllavisë vetëqeverisëse e socialiste thuhet në Aktgjykimin e Gjykatës në Prishtinë. Pas arrestimit u dënuan nga Gjyqi i Qarkut të Prishtinës, më 13 gusht 1981 me dënime të rënda dhe pas daljes nga burgu i ndalohej ushtrimi i detyrës së mësimdhënësit për pesë vjetë.[128]

Grupi i përbërë prej 5 anëtarëve i cili kishte marrë pjesë në demonstratat me 1 e 2 prill të vitit 1981 në Besianë ishte dënuar me gjithsejtë 37 vjet burg për shkak se janë angazhuar për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë dhe copëtimin e Jugosllavisë

***1. Avdullah I. Rama, student i lindur më 1960 në Brainë të Besianës dënohet me nenin 114 të LPJ më 6.10. 1981. 1 vjet burg.***

***2. Nexhmi Adem Balaj, profesor i lindurmë 1949 në Rimanishtë dënohet me nenin 114 të LPJ, 6. 10. 1981 me 11 vjet burg.***

***3. Musa Jahir Musa, nxënës i lindur më 1962 në fshatin Dobratin të Besianës dënohet me nenin 114 të LPJ me 11 vjet burg.***

---

[127] Shih Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut, P. nr. 47/81, Arkivi i Gjykatës së Qarkut - Prishtinë

[128] Shih, Aktgjykimi P. nr. 119/81, Arkivi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.

***4 Fatmir Xheladin Jusufi punëtorë i lindur më 1956 në fshatin Peran të Besianës me nenin 114 të LPJ me 9 vjet burg.***
***5. Halim Muharrem Avdullahu, punëtori lindur më 1939 në fshatin Dumnicë të Besianës me nenin 114 të LPJ me 4 vjet burg.***[129]

## 7.8 Dënimi i punëtorëve të Kosovatransit të Besianës nga Gjykata Komunale në Podujevë

Në Aktgjykimin e Gjykatës në Besianë iu shqiptohet dënimi Halil Durmishit dhe Veli Lupçit pasi që me 2. Prill. 1981, shofer në 'Kosovatrans' të Podujevës të cilët autobusët i vendosën në rrugën Prishtinë-Podujevë-Nish, afër motelit Besiana, me qëllim që ta bllokojnë rrugën për të penguar ardhjen e policisë serbe në Kosovë, pastaj u bashkuan me demonstruesit dhe kanë brohoritur parullat Kosova Republikë, Republikë Kushtetutë, Lironi shokët nga burgu, Bashkim Unitet etj dënohen me burg.[130]

***1. Halil Fetah Durmishi, shofer (1942), Herticë, Podujevë, neni 200/1, LPK, 8.09. 1981 me 1.6 vjet burg .***
***2. Veli Avdullah Lupçi, shofer 1937, Lupç të Podujevës me nenin 200/1, LPK me1.6, vjet burg )***[131]

## 7.9 Shqiptimi i dënimit të grupi të Bedri Blakçorit nga Besianë

Për pjesëmarrje në demonstratat thuhet në vendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë fillojnë dënimet e grupit të Bedri Blakçorit nga fshati Letanc të komunës së Besianës. Dënimet e nxënësve, studentëve dhe punëtorëve nuk u ndërprenë edhe përkundër burgosjeve dhe masave që kishte marrë pushteti dhe organet e sigurimit të Kosovës dhe ato Jugosllavisë. Në organizimin për shënimin e përvjetorit të demonstratës në Besianë mori pjesë në organizimin edhe grupi i Bedri Blakqorit nga Besiana i cili

[129] Po aty.
[130] Aktgjykimi me nr. 179/ 89, Arkivi i Gjykatës Komunale në Podujevë
[131] Po aty.

kishte për qëllim prishjen e Vëllazërimit e Bashkimit me qëllim që Kosova të bëhet Republikë, në kuadër të Jugosllavisë vazhdon më tej Aktgjykimi. Për këtë arsye Bedri Blakqori e përpiloi dhe e shtypi me makinë pamfletin me përmbajtje 'armiqësore' me titull: Në pritje të përvjetorit. Në të njëjtin pamflet, grupi u bëri thirrje qytetarëve që të organizohet për shënimin dhe festimin i përvjetorit të demonstratave të 11 marsit të vitit 1981.[132]

***1. Bedri Fetah Blakçori, nxënës i lindur më 1964 në fshatin Letanc të Podujevës dënohet me nenin 133 LPJ më 16. 07. 1982 me 1.vjet burg.***

***2. Nexhmi Hysen Sefa, nxënë i lindur në fshatin Reçicë të Podujevës dënohet me neni 133 të LPJ me 1 vjet burg.***

***3.Ejup Muharrem Kopalla, nxënës i lindur më 1963 në fshatin Obrançë të Podujevës dënohen me nenin 133 LPJ me 1.6 muaj burg.***

***4. Halil Muharrem Kopalla, student,(1961) nga fshati Obranç të Podujevës dënohet me nenin i133 LPJ me 3 vjet burg.***

***5. Zymer Isuf Hyseni, student i lindur më 1957 në fshatin Sllatinë të Podujevës dënohet me nenin 133 LPJ me 1vjet burg*** [133]

***6. Skender Ali Rrahimi, laborant i lindur më 1958 Prishtinë dënohet me nenin 133 LPJ me 1 vjet burg.)*** [134]

## Demonstrata e vitit 1982 në Besianë dhe dënimi i organizatorëve të saj

Një vjetori i demonstratave të Kosovës, Besianën me rrethinë e gjeti të rrethuar me ushtri e polici të armatosur deri në dhëmb të ardhur nga të gjitha anët e ish Jugosllavisë. Në ditën e 11 marsit të vitit 1982 në qytetin e Besianës organizatorët arritën të fillojnë demonstratën e planifikuar për këtë ditë edhe përkundër masave të organeve policore që i kishin marrë për pengimin e mbajtjes së tyre në qytet. Ajo filloj, fiks në ora 12.00 siç ishte paraparë nga organizatorët dhe pjesëmarrësit e saj. Në organizimin e demonstratës së 11 marsit të vitit 1982 në Besianë, barrën kryesor të

[132] Arkivi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. nr. 64/82.
[133] Po aty.
[134] Po aty.

organizimit e kishte bërë Grupi Marksist Leninist, dega e Llapit e cila ishte formuar në dhjetor të vitit 1982. Për shkak të organizimit të demonstratës në Besianë u arrestuan një numër i madh që më vonë u dënuan këta anëtar të grupit në krye e të cilit ishte Ali B. Latifi pastaj Bejtush Rr. Jashari, Gani U. Hoxha, Isuf M. Segasha, Isak Rr. Çerimi, dhe Gjyle Ahmet. Krasniqi (Shota e Llapit) të cilët u arrestuan dhe iu ngrit akuza për prishjen dhe rrënimin e sistemit shoqëror të Jugosllavisë që dënohen me burg deri në pesë vjet. Kurse anëtarët tjerë të grupit që kishin mbetur pa u arrestuar, falë qëndresës e konspiracionit e të arrestuarve që ishin të lidhur familjarisht në mes veti. Grupi që organizoi demonstratën u

nxirr para gjykatës në Prishtinë në korrik të vitit 1982. Pjesa më e madhe e tyre ishin anëtar të grupit Shaban Shala që ishte formuar në shtëpinë e Salih Salihut. Ndërsa, numri më i madh i anëtarëve të tjerë mbetën jashtë arrestimit siç ishin: Hasan Ramadani, Ali Ajeti, Hamit Hamiti, Avdi Gjata, Ramadan Dibrani,Bajram Ajeti, Fatime Gjata, Safet Jashari, Shaban Mulolli, Kadri Maqastena, Hetem Ajeti, Mustafë Llapashtica, Naser Mustafa, Hysen Maqastena, Bedri Ajeti, Nexhat Jashatri, Hetem Ajeti, Çazim Asllani etj. Gjatë demonstratës të 11 marsit të vitit 1982, duke u munduar për t'i ndaluar demonstruesit lëndohen kryetari i Komitetit Komunal të Besianës z. Jetullah Gashi e ai i LS për Besianë, z. Bahtijar Çitaku. Edhe pse organet shtetërore e policore të Kosovës së bashku me ato të Jugosllave kishin bërë përgatitjet e nevojshme për ta ndaluar demonstratën, nuk arritën pasi që organizatorët i kishin paraparë të gjitha mundësit që mund të ndodhin gjatë demonstratës.. Përveç organizimit për demonstratë paqësore, përgatitja është bërë edhe për demonstratë eventualisht jo paqësore, pasi propagandohej se nëse kësaj radhe bëhen demonstrata, policia e ushtria, kanë marrë urdhër që të shtinë me armë zjarri ndaj demonstruesve. Për këtë arsye organizatorët e anëtarët e lëvizjes kemi siguruar një numër të armëve nga revolet, pushkët e automatikët që i kishim vendosur dy- tri ditë para 11 marsit 1982 në shtëpinë e Avdi Latifit, brenda në Besianë.

Me rastin e një vjetorit të demonstratave të vitit 1981, demonstrata shpërthyen në Prishtinë, Besianë, Ferizaj, Vushtrri e .....etj.[135] që në Besianë e disa qytete tjera

[135] Rilindja, 12 marsit 1982.....

demonstruesit u përleshën fizikisht me forcën policore dhe me udhëheqësit komunal të Besianës që kishin dalë për ta penguar demonstratën.[136]

## 7.10 Shqiptimi i dënimit të grupeve ilegale të Besianës gjatë vitit 1982 nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë

Gjatë vitit 1982 Gjykata e Prishtinës për organizimin e demonstratave të 11 marsit të vitit 1982 në Besianë, u dënuan një numër i madh organizatorëve që i ndanë në dy grupe me gjithsejtë 27.6 vjet burg. Pjesa më e madhe ishin nxënës dhe student e që në mesin e tyre kish edhe anëtar që janë dënuar për herë të dytë siç është Gjylë Krasniqi (Shota e Llapit) me nofkën Gaca dhe Pajazit Jashari.[137]

***1. Ali B. Latifi, punëtori lindur më 1055 në fshatin Pollatë të Podujevës, dënohet me nenin 114 LPJ më 19. 07. 1982 me5 vjet burg.***
***2. Bejtush Rrahman Jashari, student i lindur më 1955 në fshatin Brecë të Podujevës dënohet me nenin 114 LPJ me 2 vjet burg.***
***3. Gani Ukë Hoxha, bujk i lindur në fshati Obrançë të Podujevës dënohet me nenin 114 LPJ me 3 vjet burg.***
***4. Isuf Mursel Segashi, i lindur më 1957 në fshatin Popovë të Podujevës me nenin 137 LPJ me 1 vit burg.***
***5. Isak rrahim Çerimi, punëtor i lindur më 1953 në fshatin Llaushë të Podujevës dënohet me nenin 137 LPJ me 1vit Burg.***
***6. Gjyle Ahmet Krasniqi, nxënësee lindur më 1961 në fshatin Bajçinë të Podujevës dënohet me neni 136/2-114 LPJ me 6 vjet burg.***
***7. Pajazit Ali Jashari, nxënës i lindur më 1961 në fshatin Brecë të Podujevës dënohet me nenn 114 LPJ me 2vjet burg.***[138]

## 7.11 Shqiptimi i dënimit nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë ndaj Sylejman Prestreshit

[136] Po aty.
[137] Arkivi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, nr. 86/82.
[138] Po aty

Nga Gjykata e Prishtinës, për organizim dhe pjesëmarrje në demonstrata gjatë vitit 1982 vazhdon dënimi i shqiptarëve me një tendencë rritjeje. Për këtë qëllim dënohet me 2 vjet edhe Sylejman Prestreshi nga neni 114 të LPJ nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë.

***1.Sylejman Prestreshi, daktilograf i lindur më (1953) në fshatin Llapashticë të Podujevës me nenin 114 LPJ. 26.03.1982 me ( 2 vjet burg).***[139]

## 7.12 Shqiptimi i dënimit të Grupit e të rinjve në vitin 1983 në Besianë.

Edhe gjatë vitit 1982 në rajonin e Llapit vazhdojnë arrestimet dhe dënimet e shqiptarëve nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë për organizatorët dhe pjesëmarrësit në manifestimet shqiptare kundër shtetit dhe për kërkesën që Kosova të bëhet Republikë. Sikurse në dy vitet e mëparshme edhe në vitin 1983 në Besianë shpërthyen përsëri demonstratat me rastin e tre vjetorit të demonstratës së studentëve në Prishtinë. Edhe gjatë këtij viti vazhdon arrestimi nga organet e sigurimit shtetëror dhe policia, burgosja e grupeve dhe qytetarëve që më vonë u dënuan nga Gjykata e Prishtinës të cilët kryesisht ishin të rinj që i ndanë në tri-katër grupe, me gjithsejtë 8 vjet burg.[140]
Ndarja dhe dënimi në grupe bëhej me qëllim që organizatorët të dukeshin para opinionit jo grupe të mëdha dhe jo të organizuara mirë për të krijuar huti tek populli shqiptar i Kosovës.

***1. Afrim Osman Tërmkolli, nxënës i lindur më (1963) në fshatin Dumosh të Besianës dënohet me nenin 136/1- 114 LPJ më 3. 03. 1983 me ( 3 vjet burg).***
***2. Rukije Shefki. Ajvazi, nxënëse e lindur më (1964) në fshatin Sveçël të Besianës me nenin 136/2- 114 LPJ me (2 vjet burg).***
***3. Ahmet Ramadan Podvorica, nxënës i lindur më (1966) në fshatin Dumosh të Besianës dënohet me nenin 136/2-114 LPJ me (2 vjet burg).***

---

[139] Arkivi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë nr. 33/82.
[140] Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë nr. 214/82.

***4. Milaim Bejtullah Podvorica, nxënës i lindur më (1964) në fshatin Dumosh të Besianës dënohet me nenin 136/1-114 LPJ me (1 vit burg)***[141]

## 7.13 Shqiptimi i dënimi të grupit politik të Shefqet H. Cakiqit nga Besiana më 25. 03. 1983 në Prishtinë

Gjithashtu edhe gjatë vitit 1983 vazhdon dënimi i grupeve tjera ilegale të organizuar prej Shefqet Cakiqit nga fshati Llapashticë për organizim dhe veprim kundër masave të shtetit dhe shtypjes së qytetarëve shqiptar dhe Kosovës që grupi dënohet me gjithsejtë 22 vjet burg nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë..[142]

***1.Shefqet H. Cakiqi i lindur më (1964) në fshatin Llapashticë të Podujevës me nenin 136/1-114 LPJ me 25.03. 1983.me (6 vjet burg).***
***2.Afrim XH. Fusha, nxënës,(1963),Podujevë-Podujevë neni, 136/1-114 LPJ, me, (6 vjet burg)***
***3. Muhamet N. Ymeri, nxënës i lindur më (1963) në fshatin Bradash të Podujevës me nenin 136/1-114 LPJ me (6 vjet burg)***
***4. Bedri Jahir Ajeti, nxënës i lindur më (1965) në fshatin Mirovc të Podujevës me nenin 136/2.-114 LPJ me (2 vjet burg).***
***5.Ismet H. Cakiqi, nxënës i lindur më (1965) në Llapashticë tëPodujevës me nenin 136/2.-114 LPJ me (2 vjet burg).***[143]

## 7.14 Dënimi i Naim Topanicës nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë 1983

Edhe më tutje nga Gjykata e Qarkut vazhdon dënimi edhe i qytetarëve veç e siç është edhe Naim Topanica nga fshati Sfeçël i cili kishte marr pjesë në demonstratën e Besianës gjatë vitit 1982 e 1983.

---

[141] Po aty.
[142] Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë nr. 2/83.
[143] Po aty.

***1. Naim Topanica, nxënës i lindur më (1967) në fshatin Sveçël të Podujevës me nenin 134/1 LPJ më 27. 08. 1983 me( 1.6 vjet burg)[144]***

## 7.15 Shqiptimet e dënimeve të Grupit të Afrim O Zhitiut gjatë vitit 1984 në Prishtinë

Edhe pse organet më të larta shtetërore, politike, angazhoheshin me të gjitha mjetet propagandistike po edhe ato policore që ta largojnë popullin nga të ashtuquajturit: nacionalist, separatist, njerëz të shërbimeve të huaje të indoktrinuar nga Shqipëria e Enver Hoxha, nuk arrinin në asnjë mënyrë, pasi që populli e kishte heq frikën dhe ishte bindur që liria është në duart e tij e nuk dëshironte që ta lëshojë t'i ikë sikur në vitet e 1912-tës e të 1945-tës. Andaj Gjykata e Qarkut në Prishtinë vazhdon që edhe gjatë vitit 1984 serinë e dënimeve të individëve, e grupit të rinjve që iu shqiptoi më se 40 vjet burg. Në mesin e këtij grupi ishte edhe atdhetari, luftëtari e udhëheqësi më lavdishëm i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare Afrim Zhitiu që më 2 nëntor të vitit 1989 në Breg të Diellit në Prishtinë u vra nga njësitë speciale të policisë së kosovës së bashku me shokun e vet të luftës Fahri Fazliun duke bërë rezistencë të armatosur..[145]

***1. Ilaz X Zhitia i papunë i lindur më (1962) në fshatin Llugë të Podujevës dënohet me nenin 136/2-114 të LPJ me 6. 08.1984 me (7 vjet burg).***

***2. Afrim Osman Zhitia, studenti lindur më (1965) në fshatin Llugë të Podujevës dënohet me nenin 136/2-114 të LPJ me ( 8 vjet burg).***

***3. Ramadan H. Avdiu, student i lindur në Prishtinë më (1964) dënohet me nenin 136/2,114 të LPJ me (8 vjet burg)***

***4. Salih V Sefa , teknik i lindur më (1958) në Prishtinë dënohet me nenin 133/2-114 të LPJ me ( 8 vjet burg)***

***5. Qemajl S Rexhepi, teknik i lindur më (1958) në Prishtinë dënohet me nenin 133/1 të LPJ me ( 7 vjet burg).***

***6. Kadri F Haziri, mashinist i lindur më (1954) në fshatin Bellopojë të Podujevë me nenin 133/1 të LPJ me ( 3 vjet burg).***

---

[144] Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë me nr.52/1981.

[145] Adem Gashi, a...ZH-Vetëtimat e Nëntorit,Prishtinë, 2005 .f, 244.

***7 Rexhep N. Makolli, zdrukthëtar i lindur më (1955) në fshatin Marevc të Podujevë dënohet me nenin 133/1të LPJ me ( 3 vjet burg)[146]***

## 7.16 Shqiptimi i dënimit të grupit FNÇ të Besianës në vitin 1984 në Prishtinë

Gjykata e Qarkut në Prishtinë iu shqipton dënimin të burgosurve të cilët në nëntor 1980 në shtëpinë e Rrahman Bahtirit në Prishtinë Sejdi Veseli bashkë me Rrahman Bahtirin, Agim Sahitin e Islam Krasniqin kanë formuar Organizatën Ilegale Kombëtare e cila veproi kundër RSFJ-së, që dëshirojnë realizimin e të drejtave të plota kombëtare të shqiptarëve, pasi ata mendojnë se shqiptarëve i kanë të kufizuara të drejtat e tyre dhe deklarohen se dëshirojnë të barazohen me popujt e tjerë në Jugosllavi.[147]

Në këtë tubim Sejdi Veseli, ka propozuar që organizata të quhet Fronti i Çlirimit Kombëtar (FNÇ). Pas këtij takimi anëtarë të organizatës janë bërë edhe Musli Prebreza, Salih Sefa, dhe Hamdi Rafuna. Gjatë këtij viti anëtarë të organizatës janë bërë edhe Tefik Ramadani, Islam Krasniqi, Agim Ahmeti, dhe Rexhep Makolli dhe spec Skender Boshnjaku mjek në spitalin e Prishtinës.[148] Në shtator të viti 1981, organizata është zgjeruar me anëtarë të rinj siç janë: Jahir Imeri, vëllau Shemsi Veseli, Xhevat Haliti, dhe Esat Brajshori që numëronte diku rreth 80 anëtarë.[149]

Në vitin 1982 në mbledhjen e mbajtur në Kodrën e Trimave shkollën fillore Zenel Hajdini, në Prishtinë. Në këtë mbledhje organizata e merr emrin Fronti Nacionalçlirimtar, që aty edhe e aprovohet statuti dhe programi e organizatës 'Ilegale armiqësore' FNÇ-së.[150]

Të gjithë anëtarët e organizatës i kishin marrë edhe pseudonimet e tyre ku: Sejdi Veseli-Guri, është zgjedhë sekretar i përgjithshëm i FNÇ-së. Anëtarët e organizatës funksiononin në sistemin e treshit që furnizoheshin me materialet propaganduese nga

---

[146] Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. nr. 89/84.
[147] E. Çeku, f .633.
[148] Po aty, f. 634.
[149] Po ty, f. 635.
[150] Po aty.

diaspora, nga organizatat tjera ilegale në Kosovës, si edhe artikujve e shkrimeve që i përpilonin vet anëtarët FNÇ-së.[151]

Gjatë dhjetorit të vitit 1983 numri i anëtarëve të organizatës ishte rritur dhe ishte e nevojshme të zgjerohet edhe më shumë veprimtaria politike që për këtë qëllim u formuan Komitetet e vendit, regjioneve që ishin caktuar edhe delegatët të cilët do ta udhëheqin organizatën dhe do të themelojnë Komitete të reja të vendit.[152]

Në dhjetor të vitit 1983, sekretari i FNÇ-së Sejdi Veseli-(Guri), kontaktonë me organizatat tjera ilegale që vepronin në Kosovë e viset tjera të shqiptarëve në Jugosllavi. Ata pastaj filluan që t'i koordinojnë aktivitetet dhe punët e përbashkëta me qëllim të realizimit të kërkesës gjithë popullore shqiptare që Kosova të bëhet Republikë.

***1 Sejdi R Veseli, tekniki lindur më (1949) në fshatin Orllan të Podujevës dënohet me nenin 136/1-114 të LPJ më 6.08.1984 me (14 vjet burg).***

***2 Rrahmon H Bahtiri, punëtor i lindu më (1954) në fshatin Brainë të Podujevës dënohet me nenin 136/1-114 të LPJ me (13 vjet burg).***

***3 Shemsi R Veseli, student i lindur më (1961) në fshatin Orllan të Podujevës dënohet me nenin 136/1-114 të LPJ me (11 vjet burg).***

***4 Esat SH. Brajshori, student i lindur më (1963) në fshatin Sharban, Podujevës dënohet me nenni 136/1-114 të LPJ me (11 vjet burg).***

***5 Musli A Prebreza, teknik i lindur më (1962) në fshatin Vranidoll të Podujevës me nenin 136/1-114 të LPJ me (10 vjet burg).***

***6.Hamdi Xh. Rafuna, punëtorë i lindur më (1958) në fshatin Gjurishec të Prishtinës dënohet me nenin 136/1 114. të LPJ me(9 vjet burg)***

***7 Sabri S. Sopi, i papunë i lindur më (1963) në fshatin Mramor të Prishtinës dënohet me nenin 136/1-114 të LPJ me (10 vjet burg).***

***8 Agim R. Sahiti, teknik i lindu më (1956), Kishnapole, të Gjilanit dënohet me nenin 133/1 LPJ me ( 8 vjet burg).***

***9 Islam Sh. Krasniqi, depoist i lindur më (1956) në fshatin Majanc të Podujevës dënohet me nenin 133/1 të LPJ me (6 vjet burg).***

---

[151] Po, aty, f. 639.
[152] Po aty, f. 640.

***1o Tefik R Ramadani, defektolog i lindur më (1954) Prishtinë dënohet me nenin 133/1 të LPJ me (6 vet burg).***

***11 Muhamet J. Kryeziu, punëtorë i lindur më (1956) në Prishtinë dënohet me nenin 133/1 të LPJ me (3 vjet burg)***

***12 Skender M. Boshnjaku,mjek spec i lindur më (1948) në Vushtrri dënohet me nenin 133/1 të LPJ me gjithsejtë (4 vjet burg)[153].***

## 7.17 Shqiptimi i dënimeve nga Gjykata e Qarkut të Prishtinës kundër OMLK-së dega në Llap më 18. 6 1984.

***Foto gjatë gjykimit të grupit OMLK-së dega në Llap. Më 18.06.1984 në Gjykatën e Qarkut të Prishtin*** Në Prishtinë,vazhdon shqiptimi i dënimit të organizatës së OMLK-së, dega e Llapit për shkak të organizimit dhe veprimtarisë 'armiqësore' kundër rregullimit shoqëror të Jugosllavisë dhe bashkimit të Kosovës me Shqipërinë. Shqiptimi i dënimeve bëhet kundër dhjetë anëtarëve të grupit të OMLK-së dega së Llapit nën drejtimin e Bajram Ajetit jurist, Ismet Begollit e Sherif Konjufcës gazetar të RTV të Prishtinës, Bajrush Behramit student, Kadri Llugaliut student, Avdi Gjatës profesor, Ali Ajetit student, Sabri Hamitit punëtor, Shaban Mulollit punëtor, dhe Hamit Hamitit inxhinier për shkak se janë organizator e pjesëmarrës të demonstratave në komunën e Besianës gjatë viteve 1981- 1983.

---

[153] Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë nr. 99/84

Më tutje gjykata vazhdon të shprehet se ka vërtetuar se Ismet Begolli, Sherif Konjufca dhe Mustafë Xhemajli gazetar të TVP=së me qëllim të minimit të RSF të Jugosllavisë kanë formuar celulën e grupit 'armiqësor' të cilën e kanë quajtur OMLK(Grupi Marksist Leninist i Kosovës).Ata kanë përcaktuar detyrat që duhet t'i realizoi grupi, puna aktive dhe e pandërprerë drejtë realizimit të kërkesës që Kosova të ketë statusin e Republikës. Përveç kësaj, është vendosur q të marrin aksione për shpërndarjen e revistave të botuara nga organizatat ilegale, të organizohet populli që të dalë në demonstratë, dhe në fund nëse Kosova nuk bëhet Republikë të armatoset populli për një kryengritje të armatosur kundër Jugosllavisë. Për t'i arritur këto qëllime ata kanë mbajtur disa mbledhje që kanë biseduar rres situatës politike dhe demonstratave të viit 1981që i kanë konsideruar të drejta.

Për këtë qëllim Ismet Begolli si anëtar i këtij grupi ka përpiluar artikullin me të cilin ka arsyetuar parullën Kosova Republikë që ia ka shpërndar Mustafë Xhemajlit, Sherif Konjufcës, Bajram Ajetit, Avdi Gjatës e të tjerëve për ta lexuar e shpërndarë anë e mbanë Llapit e Kosovës. Gjatë kësaj kohe Ismet Begolli gjatë muajit dhjetor 1982 në shtëpinë e Musa Jupollit bashk me Bajram Ajetin formoi celulën tjetër të GMLK-së [154] . Duke e forcuar aktivitetin e vet organizata Ismet Begolli në qershor 1983 e përpiloi artikullin me përmbajtje armiqësore me titull Komunikata Në Prishtinë Bajram Ajeti gjatë vitit 1983 në Prishtinë nëpërmes Enver Topallit është njohur me Nuhi Berishën që ishte udhëheqës i organizatës LRSHJ që nga ai ka marrë mbi 80 gazata të Zërit të Kosovësnr. 4 dhe 5 që ato të shpërndahen edhe në Llap.Gjatë vitit 1981 në Podujevë Bajrush Behrami dhe Kadri Llugaliu e kanë formuar grupin ilegal që janë bërë anëtarë edhe Shaqir Hasani , Xhafer Spahiu, dhe Qunë Hajdini.

Në të njëjtën kohë gjykata ka vërtetuar se Avdi Gjata profesor i historisë është bërë anëtar i GMLK-së gjatë dhjetorit 1983 në Prishtinë, në shtëpinë e Fatime Gjatës-Maliqi në rrugën Robert Gajdiku.[155]

Gjithashtu Avdi Gjata dhe Hamit Hamiti në vitin 1980 kanë formuar Organizatën Ilegale të Llapit e cila ka vepruar pa ndërprerë nga ajo kohë e deri më sot. Këta aktivitetin e kanë përqendruar kryesisht në shkollat e mesme të Besianës ku ishin edhe vet mësimdhënës.

---

[154] Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. nr. 100/1981.
[155] Po aty.

Gjithashtu anëtarët e tjerë të kësaj organizate si Ali Ajeti i cili pas vuajtjes së dënimit më 1989 duke protestuar me rastin e vizitës së parlamentarëve Evropian në Kosovë vritet nga njësia speciale e Kosovës dhe ajo Jugosllave. Ndërsa Sabri Hamiti, Shaban Mulolli dhe Hamit HAmiti janë angazhuar në shtrirjen dhe zgjërimin e organizatës dhe shpërndarjen e materialit propagandues. Për këtë arsye Gjykata iu shqipton dënimet Ismet Begollit, Sherif Konjufcës, Bajrush Behramit Kadri Llugaliut, Avdi Gjatës, Ali Ajetit Sabri Hamitit, Shaban Mulollit dhe Hamit Hamitit me vuajtjen e dënimit siç vazhdon më poshtë.[156]

***1. Bajram Jahir Ajeti, jurist i lindur më (1954)në fshatin Mirovc të Besianës dënohet me nenin 136/1-114 të LPJ mishërim në( spitalin e Beogradit më së paku 3 vjet).***

***2. Ismet Zenel Begolli, gazetar i lindur më (1955) në fshatin Kaçandoll të Besiansëdënohet me nenin 136/1-114 të LPJ me (12 vjet burg)***

***3. Sherif R. Konjufca, gazetari lindur më (1952) në fshatin Llugaxh të Lipjanit dënohet me nenin 136/1-114 të LPJ me ( 8 vjet burg.)***

***4 Bajrush Fazli Behrami,student i lindur më (1956) në fshatin Dobratin të Besianës dënohet me nenin 136/1-114 të LPJ me (10 vjet burg).***

***5. Kadri H. Llugaliu, student i lindur më (1952)në fshatin Surkish të Besianës dënohet me nenin 136/1-114 të LPJ me ( 8 vjet burg).***

***6 Avdi Hysen Gjata, profesor ) i lindur më(1954) në fshatin Bajçinë të Besianës dënohet me nenin 136/2-114 të LPJ me ( 8 vjet burg.)***

***7 Ali Adem Ajeti, student t(i vrarë) i lindur më (1954) në Sveçël të Besianës dënohet me nenin 133/1 të LPJ me ( 4 vjet burg).***

***8 Sabri Shaban Hamiti, i papunë i lindur më (1954)në fshatin Sveçël të Besianës dënohet me nenin 133/1 të LPJ me (4 vjet burg)***

***9 Shaban Nuhi Mulolli, i papunëi lindur më (1954) në fshatin Shajkovc të Besianës me nenin 133/1 të LPJ me (4vjet burg).***

***10 Hamit Raif Hamiti, ing. i lindur më (1954) në fshatin Repë të Besianës me nenin 133/1 LPJ me (3 vjet burg)[157].***

---

[156] Arkivi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.

[157] Aktgjykimi I Gjykatës së Qarkut në Prishtinë nr. 100/84.

## Post skriptum

Pas vrasjeve të vëllezërve Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe Kadri Zekës më 17 janar 1982 në Untergrupenbach të Gjermanisë të cilët ishin duke e kurorëzuar bashkimin e të gjitha organizatave dhe grupeve ilegale shqiptare që ishin duke vepruar në Evropë, diplomacia e Jugosllavisë mendoi se e kishte zhdukur udhëheqjen kryesore të ' terroristëve' shqiptar të Kosovës dhe viseve tjera shqiptare në Jugosllavi. [158]

Vetëm një muaj më vonë më 17 shkurt të vitit 1982 në Ankara të Turqisë, përfaqësuesit e dy organizatave të fshehta NÇK (S. Novosella),LNÇKVSH (Xh. Durmishi), PKMLSH e (A. Prapashtica), në prezencë të ambasadorit shqiptar në Turqi, e më vonë edhe përfaqësuesi i grupit të OMLK-së ( Xh. Shatri), e shpallën të formuar Lëvizjen për Republikën Shqiptare në Jugosllavi (LRSHJ).[159] Kjo marrëveshje u botua në numrin e parë të gazetës 'Zëri i Kosovës' tani edhe organ i LRSHJ-së e cila e zgjodhi edhe Komitetin Qendror prej 15 anëtarëve.[160]

Bashkimi grupeve ilegale në diasporë, e shtroi nevojën e bashkimit edhe të grupeve ilegale në Kosovë e viset tjera shqiptare në Jugosllavi. Pas bisedës që patëm me Bajram Ajetin që punonim bashkë në Kosova-trans të Podujevës nga muaj shtator i vitit 1981 pasi më diferencuan në gjimnazin '8 Nëntori', e që tani e kishim fituar gati besimin e plot në mes veti për situatën në Kosovë për punën e lëvizjes dhe zgjerimin e organizatës më tutje, ai më tha se duhet ta gjejmë një vend të sigurt sepse diku në maj apo në qershor, do të mbahet Kuvendi i Lëvizjes Ilegale Kombëtare, që do të marrin pjesë përfaqësuesit e organizatave e grupeve ilegale, pasi që janë pjekur kushtet për veprim më të koordinuar për t'u bashkuar në një lëvizje të përbashkët (LRSHJ). Në bisedë që bëra me motrën time Fatime Gjata-Maliqi e cila ishte anëtare e Grupit Ilegal të Llapit u morëm vesh se nëse banesa e saj i plotëson kushtet, mundemi që ta mbajmë Kuvendin.[161] Në nëntor të vitit 1983 në banesën e Fatime Gjata-Maliqit e cila gjendej në rrugën e ish 'Robert Gajdikut', tek shtëpitë e hoxhallarëve. Në banesë kemi shkuar me Bajramin për ta shikuar e që aty edhe jam bërë edhe anëtarë i grupit të

[158] Ismet Rashiti, 25 vjetori i demonstratave të vitit 1981, Epoka e RE, 18 prill 2006.
[159] Po aty.
[160] Sabri Novosella, intervistë në gazetën Zëri, 23 mars 1992.
[161] Kujtime, Avdi Gjata, Fatime Gjata-Maliqi, dhjetor 1983.

OMLK-së, ku e kam dhënë betimin përpara tij. Betimin së pari e lexonte Bajrami kurse unë i përsëritsha fjalët një nga një pas tij, që qëndronim në këmbë me qëndrim gatitur përpara flamurit që e kishte qëndisur motra para se të martohej e që rrinte në mur para nesh. Aty kemi biseduar edhe për shumë gjëra të tjera e veçanërisht për përdorimin e sistemit të treshit, për ruajtjen e konspiracionit të organizatës e rrjedhën e punës së lëvizjes . Në shtëpinë e Fazli Shaqirit e kemi caktuar që këtu do të mbahet Kuvendi i Lëvizjes së shqiptarëve në Jugosllavi. Ai nuk u mbajt, pasi që në dhjetor të vitit 1983 u arrestua numri më i madh i anëtarëve të të gjitha grupeve anë e mbanë Kosovës.[162] Mund të them lirishtë dhe me përgjegjësinë më të madhe se nuk është mbetur rajon i Kosovës dhe i krahinave tjera shqiptare në Jugosllavi që nuk kanë rënë në burg grupe dhe individ shqiptar që janë marrë me veprimtari politike. Këtë e dëshmojnë të gjitha aktgjykimet e grupeve të Gjykatave të Qarkut e Gjykatave Komunale që dënonin çdo ditë pa ndërprerë grupe dhe qytetarë shqiptarë. Mjafton vetëm të shfletosh një gazetë të Kosovës në gjuhën shqipe dhe të bindesh pasi që nuk ka ditë që nuk mbahet një seancë gjyqësore që dikush do të dënohet nga ndonjë komunë e Kosovës .Arrestimet e panumërta e shumë të mëdha qytetarëve e grupeve e penguan mbajtjen e **Kuvendit Shqiptar** të caktuar nga Lëvizja Ilegale Shqiptare për muajin maj apo qershor të vitit 1984 që është një dështim e një humbje e madhe për Lëvizjen e popullin shqiptar si edhe për vet lirinë dhe Republikën e Kosovës. [163]

## 7.18 Gjykata e Qarkut në Prishtinë ia shqipton dënimin Isak Bektesh Mustafës për veprimtari 'armiqësore' kundër RSFJ-së.

I pandehuri z. Fehmi Ademi biri i Ramës dhe Hanifes, i gjinisë Halili i lindur me 4. 12. 1950 në fshatin Sllatinë, tani jeton në fshatin Polanicë, KK, Podujevë. Është fajtor sepse e ka thyer fotografinë e shokut Tito, që e ka bërë në mënyrë publike para qytetarëve. Me këtë rast ka bërë vepër penale, shkelje të prestigjit të RSFJ-së nga neni 157/1 të LPJ. E gjykon me 1 vjet burg .

---

[162] Kujtime : Avdi Gjata, Fatime Gjata dhe arkivi privat i yni.
[163] Kujtime, A. Gjata, B. Ajeti , F. Gjata-Maliqi. H. Hamiti, I. Begolli etj.

**1.Fehmi Ramë Ademi, i papunë,(1950) Polonicë,-Podujevë, neni157/1, LPJ 17. 04. 1984 (1 vjet burg).**[164]

## 7.19 Në korrik 1986 fillon në Prishtinë dënimi i grupit nacionalist të Pajazit Jasharit nga Besiana

Edhe gjatë vitit 1986 vazhdon shqiptimi i dënimeve nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë kundër grupeve dhe anëtarëve të lëvizjes shqiptare të rajonit të Llapit i cili me një rezistencë fanatike arriti që për çdo përvjetor të demonstratave të organizon manifestime edhe për kundër masave policore. Lirisht mund të thuhet se është e vetmja komunë që arriti të organizoj demonstrata nga viti 1981 deri më 1990 në Kosovë.

I tillë është edhe grupi i Pajazit Jasharit dhe Fadil Lepajës që këta të dy janë të dënuar edhe gjatë vitit 1982 për veprimtari nacionaliste, por menjëherë pas daljes nga vuajtja e dënimit iu bashkuan Lëvizjes Ilegale për ta bërë Kosovën Republikë. Për këtë qëllim Gjykata e Qarkut iu shqipton këto dënime grupit të tyre të shkruara më poshtë[165]

***1 Pajazit A .Jashari, student i lindur më (1964) në fshatin Brecë të Podujevës dënohet me nenin 136/1-114 të LPJ më 21.07.1986 me (11 vjet burg)i dënuar edhe në vitin 1982.***

***2 Fadil Ilaz Lepaja, Student i lindur më (1962) në fshatin Bajçinë të Podujevës i dënuar me nenin 136/2-114 të LPJ me (11 vjet burg)i dënuar edhe në vitin 1982.***

***3 Sadik B. Buja punëtor i lindur më (1956) në fshatin Bujan dënohet me nenin 136/2-114 të LPJ me ( 9 vjet burg).***

***4 Fitim Rr. Selimi, student i lindur më (1960) në fshatin Banullë të Lipjanit dënohet me nenin 136/2,-114 të LPJ me ( 2,6 vjet burg).***

***5 Ramadan K. Emini, student i lindur më (1955) në Ferizaj dënohet me nenin 136/2-114 të LPJ me (5 vjet burg).***

***6 Hazir Hafir Gashi, student i lindur më (1963) në Ferizaj dënohet me nenin 136/2-114 të LPJ me ( 2 vjet burg.)***

---

[164] Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. nr. 45/1984.
[165] Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Prishtinë, P.nr. 147/1981.

***7 Agim Hamit Gashi, hotelier i lindur më (1954) në Lipjan dënohet me nenin 136/2-114 të LPJ me ( 2.6vjet burg.)***

***8 Besim Rr. Baraliu, student i lindur më (1959) në fshatin Bukosh me nenin !36/2-114 të LPJ me ( 8 vjet burg)***

***9 Nazmi H. Llapashtica, bujk i lindur më (1947) në Dyz të Besianës me nenin 133/4 të LPJ me (1.6 vjet burg).***

***10 Hetem R. Ajeti, punëtor i lindur më (1947) në fshatin Sveçël të Besianës dënohet me nenin 133/4 të LPJ me ( 1 vjet burg).***[166]

## 7.20 Vazhdojnë shqiptimet e dënimeve të grupeve nga Llapi. Grupi i Ibush Llapashticës dhe Rukije Selimit më 1988.

Edhe gjatë vitit 1988 në Besianë vazhduan demonstratat dhe protestat për formimin e Republikës së Kosovës të organizuara nga individ, grupe dhe organizata të ndryshme. Një nga ato është edhe grupi i Ibush Llapashticës që kishte për detyrë rrënimin e pushtetit, minimin shoqëror e ekonomik të përcaktuar me kushtetutë, dhe ndryshimin antikushtetues të rregullimit federativ të RSFJ-së. Të gjithë anëtarët e grupit siç ishin Ibush Llapashtica, Ali Sheholli, dhe Naser Hasani janë kryesisht të mitur, ndërsa Mirhidin Idrizi, Rukije Selimi që ishte e dënuar edhe më parë, Tefik Gashi e Ragip Xhaka të moshës madhore, në nëntor të vitit 1981 në shtëpinë e Ragip Xhakës, në Emshir (Kalabri) të Prishtinës, formuan grupin ilegal 'armiqësor', Heronjt e Rinj, ndërsa Fadil Rexhepi, Sherif Vrajolli, Naser Bekteshi dhe Bedri Shala u bënë anëtarë të grupit.[167]

Në mbledhjen e dytë të cilën e kanë mbajtur në Pallatin e Rinisë 'Bora e Ramizi' në Prishtinë. Në këtë mbledhje anëtarët e grupit i morën edhe pseudonimet me qëllim të ruajtjes së konspiracionit të grupit. Grupi kishte për qëllim organizimin e demonstratave, shkruarën e parullave dhe angazhimin e anëtarëve të rinj me qëllim të zgjerimit të veprimtarisë kombëtare për formimin e Republikës së Kosovës.[168]

---

[166] Arkivi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, nr.147/86.
[167] Prokuroria Publike e Qarkut , PP. nr. 293/ 87. Prishtinë, Aktakuzë., f. 2.
[168] Po aty.

Nga viti 1981 e deri në maj të vitit 1987, anëtarët e grupit kanë shkruar parulla, kanë shpërndarë pamflete, kanë thyer fotografinë e Titos etj. Ndërsa anëtarja e grupit Rukije Selimi në fakultetin Filozofik të Prishtinës shpërndanë pamfletin me titull 'Thirrje'[169]

Këta të rinj, nëpër shumë vende në Prishtinë, shkruan parullën Kosova Republikë si në shkollën Bujqësore, në Fakultetin Filozofik, në Mensën e Sudentëve, në rrugën e Mostarit, në fshatin Majanc të Besianës, në Dyz, Tërnavë të Llapit, në shkollën teknike 19 Nëntori në Prishtinë, në asfaltin Prishtinë-Besianë e në vende tjera publike të Kosovës.[170]

Për shkak të aktivitetit dhe pjesëmarrjes në organizimin demonstratave dhe propagandimin e parullës Kosova Republikë gjatë demonstratave Gjykata e Qarkut në Prishtinë i dënon me vuajtje të dënimit këta anëtar të grupit Heronjtë e Rinj.[171]

***1 Ibush X. Llapashtica,i papunë i lindur më (1964)në fshatin Dyz të Podujevës dënohet me nenin 136/1-114 të LPJ më 4.04.1988 me( 6 vjet burg).***

***2 Ali Rr. Sheholli, punëtori lindur më (1964) në fshatin Hërticë të Podujevës dënohet me nenin 136/1-114 të LPJ me ( 5 vjet burg).***

***3 Mirhidin R. Idrizi, i papunë i lindur më(1963) në fshatin Majanc të Podujevës dënohet me nenin 136/1-114 të LPJ me (5 vjet burg).***

***4 Rukije Musli Selimi, e papunë e lindur më (1964) në fshatin Kaçibeg të Podujevës dënohet me nenin 136/1-114 të LPJ me (3 vjet burg).***

***5 Fadil A. Rexhepi, i papunëi lindur më (1963) në fshatin Teneshdoll të podujevës dënohet me nenin 136/1-114 të LPJ me (3 vjet burg).***

***6 Sherif Isuf Vrajolli, punëtorë i lindur më (1963) në Prishtinë dënohet me nenin 136/1-114 të LPJ me ( 3 vjet burg).***

***7 Tefik I Gashi, i papunë i lindur më (1963) në fshatin Majanc të podujevës dënohet me nenin 136/1-114 të LPJ me ( 4 vjet burg).***

***8 Naser H. Hasani, punëtor i lindur më ( 1965) në Prishtinë dënohet me nenin 136/1-114 të LPJ me (3 vjet burg).***

---

[169] Po aty.
[170] Rukije Selimi, Kujtime.
[171] Shih Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.

***9 Ragip A Xhakli, kontrollori lindur me (1963) në komunën e Prishtinë dënohet me nenin 136/1-114 të LPJ me ( 3 vjet burg).***

***10 Naser A. Bekteshi, punëtor i lindur më (1961) në komunën e F. Kosovës dënohet me nenin 136/1-114 të LPJ me ( 3 vjet burg).***

***11 Bedri Z. Shala, punëtori lindur më(1964) në fshatin Hade të Prishtinës dënohet me neni 136/1-114 të LPJ me (6 muaj burg)[172]***

## 7.21 Shqiptimi i dënimeve të Grupit të Nexhat Maliqit nga Besiana në vitin 1988 – 1989

Fundi i viteve 1988-1989 ishin vitet më të vështira që kalonte populli shqiptar i Kosovës pas luftës së Dytë Botërore pasi që qeveria e Serbisë ia mori Kosovës Kushtetutën me dhunë në krye me Sllobodan Millosheviqin. Edhe përkundër kësaj populli shqiptar i Llapi po edhe krahinave tjera në Jugosllavi nuk e ndali veprimtarinë e vet për formimin e Republikës së Kosovës. Rezistenca e shqiptarëve në njërën anë dhe dhuna serbe në anën tjetër kishte krijuar raporte të paparashikueshme në Kosovë Për këtë qëllim atdhetar dhe revolucionarët e kishin të qartë se rezistenca dhe lufta duhet të rritë fuqinë nëse mendojnë të mbesin në trojet e veta në Kosovë.

Për të dobësuar aktivitetin kombëtar të shqiptarëve Gjykatat në Prishtinë vazhdonte shqiptimin e dënimit të grupeve e organizatave. I tillë ishte grupi i Nexhat Maliqit nga komuna e Besianës që më 24 prill të vitit 1989 dënohet me nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë me dënime të rënda. Grupin e përbënin kryesisht të rinjët nën drejtimin e Nexhat Maliqit nga Dumnica e Llapit.[173] Grupi akuzohej për veprimtari kundër shtetit dhe shkëputjen e Kosovës nga Serbia dhe bashkimin e saj me Shqipërinë. Dënimet iu shqiptohen sipas pozitës në grup dhe aktivitetin e rrezikshmërinë e anëtarit të grupit, që mund ti shohim në vazhdim të punimit.

***1 Nexhat A. Maliqi, student i lindur më (1968) në fshatin Dumnicë të Podujevës dënohet me nenin 136/2-114 LPJ më 26.04.1989 me ( 5 vjet burg).***

---

[172] Po aty.

[173] Arkivi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.

*2 Hajredin H. Hyseni, student i lindur më (1968) në fshatin Ballovc të Besianës dënohet me nenin 136/2-114të LPJ me (5 vjet burg).*
*3 Fidaim F. Gashi, student i lindur më (1969) në fshatin Bajçinë të Besianës me nenin 136/2-114 të LPJ me (3 vjet burg).*
*4 Skender B. Murati, student i lindur më (1967) në fshatin Llapashticë të Besianës me nenin 136/2-114 të LPJ me (1 vjet burg.*
*5 Fahri H. Zebica, student i lindur më (1969) në fshatin Letanc të Besianës dënohet me nenin 136/2-114 të LPJ me (3 vjet burg)*
*6 Hysen Xh.Jashari, student i lindur më (1969) në fshatin Bradasht të Besianës me nenin 136/2-114të LPJ me (3.6 muaj burg).*
*7 Fikrije. T. Musa, studente e lindur më (1968) komunën e Podujevës dënohet me nenin 136/2-114 të LPJ me (1.6 vj burg)*
*8 Bajram. B. Hajrizi, student me (1968) të Besianës më nenin 136/2-114 të LPJ me (1.6vjet Burg)*
*9 Naser S. Beka, student i lindur më (1967) në fshatin Dobërdol të Besianës me nenin 136/2-114 të LPJ me (3 vjet burg).*
*10 Nezir M. Haziri, i papunë i lindur më (1967) në fshatin Bradash të Besianë dënohet me nenin 136/2 114 të LPJ me (3 vjet burg).*
*11 Ruzhdi. Kiçmari, nxënës i lindur me (1971) në fshatin Bradash të Besianës dënohet me nenin 136/2-114 të LPJ me (nuk ka të dhëna) si duket mbahet në burg deri sa del në gjyq.*
*Grupit i përbërë prej 11 anëtarëve të cilët u nxorën në gjykatë dënohen me gjithsejtë 29,6 vjet burg të rëndë. Ndërsa një numër i anëtarëve lirohen nga dënimi para se me dal në gjyq apo edhe gjatë hetimeve.*[174]

## 7.22 Shqiptohet dënimi nga Gjykata e Qarkut ndaj Gani Ejupit dhe Sami Ramadanit në Prishtinë më 27. o7 1989.

Me aktgjykimin e kësaj gjykate të datës 11. 07. 1989. Gani Ejupi dhe Sami ramazani janë shpallur fajtor për veprën penale kundërrevolucionare i rregullimit

[174] Po aty.

shoqëror nga neni 114 të LP, të RSFJ-së dhe përmbysjen e rendit Kushtetues Të RSFJ-së Ndaj këtyre të dy të pandehurve gjykata iu shqiptoi gjithsejtë 5.6 vjet burg të rëndë duke iu vazhduar edhe më tutje paraburgimi sepse sikur të njëjtit të gjenden në liri do t'i shqetësojnë qytetarët.[175]

***1.Gani Ejupi i papunë,(1965), Podujevë, neni 114, LPJ më 27. 07. 1989.***

***2. Sami R Ramadani, i papunë (1963), Ladovc, 114, LPJ, 27.07.1989[176]***

## 7.23 Gjykata e Qarkut në Prishtinë e dënon Isak B. Mustafën me 4 vite.

Gjykata e Qarkut në Prishtinë i shqiptoi dënimin Isak Bektesh Mustafës teknik i lindur më 1962 në fshatin Gllamnik( Vendenis), nga i ati Bekteshi dhe e ëma Adilja e gjinisë- vajzërisë, Halili me nenin 134/1 të LPJ me 28. 07. 1986 me Aktvendimin P. nr. 184/86 me burg me kohëzgjatje prej 5 vjet burg për shkak të prishjes së rendit shoqëror dhe marrëdhënieve ndër nacionale në Kosovë.

1. Isak Bektesh Mustafa, teknik (1962), Gllamnik- Vendenis, neni 134/1, LPJ. 28. 07. 1986

(5 vjet burg).

# K a p it u ll i II

# Fillimi i fushatës antishqiptare e Beogradit dhe rezistenca shqiptare

Pas ngjarjeve të vitit 1981, statusi shoqëroro-politik e juridik i shqiptarëve dhe i vet Krahinës Autonome të Kosovës, erdhi duke u minimizuar. Qeveria serbe miratoi një numër të madh vendimesh e masash për këtë qëllim. Kjo dukuri u bë më e dukshme posaqërisht pas ardhjes së Sllobodan Millosheviçit, kryetar i Partisë Komuniste të Serbisë më 1987, i cili u mbështet në forcat më konservatore e ultra nacionaliste serbe.

I inkurajuar nga heshtja e Evropës dhe i republikave tjera jugosllave, ndaj problemit të Kosovës, si edhe për ta rritur autoritetin e tij politik, Millosheviqi sensibilizoi

---

[175] Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë nr. 119/ 89.

[176] Po aty.

opinionin serb për pozitën e disfavorshme kushtetuese, territoriale, ekonomike e shoqërore të Serbisë në Federatën Jugosllave.[177]

Duke e para ndjerë rrezikun e ndërprerjes së lidhjeve të drejtpërdrejta me Federatën, shqiptarët e Kosovës iu përgjigjën mitingjeve serbe me kundër mitingje gjatë vitit (dimrit), 1988-1999. Kërkesat e shqiptarëve u rrudhën, u zvogëluan dhe u reduktuan vetëm në ruajtjen e Kushtetutës së vitit 1974. Megjithatë, kjo ishte shkak i mjaftueshëm që në Kosovë të ndërmerreshin arrestime , pushime nga puna, dhe të largoheshin nga skena politike të gjithë ata udhëheqës shqiptarë që kishin filluar t'i rezistonin politikës shoviniste serbe.[178]

Në këtë situatë të ndezur, më 23 shkurt të vitit 1989 në Kuvendin e Serbisë u miratuan projekt-amendamentet serbe që parashihte ndryshimin e Kushtetutës së Kosovës pa pëlqimin e krahinave autonome.[179]

Miratimi i këtyre projekt-amendamenteve u prit me zemërim nga tërë populli i Kosovës. Në shenjë proteste dhe pakënaqësisë së pushtetit serb, ndërmarrjet, fabrikat shkollat, fakultetet dhe institucionet e tjera kulturore në tërë Kosovën kishin mundësi të funksionin. Edhe të gjitha zejtaritë private e shoqërore e kishin ndërprerë aktivitetin punën e tyre prodhuese. [180]

Protestat kishin filluar në ditën e enjte (17. nëntor) 1989, pas mëngjesit, një orë dy para fillimit të Plenumit të Kosovës, më shumë se tre mijë xehetarë të Trepçës kishin vendosur që të nisen për në Prishtinë për ta mbrojtur Kushtetutën e Kosovës.[181]

Pas dite, xehetarëve iu bashkuan, punëtorët e Ramiz Sadikut, Xehtarët e Kishnicës e Novo Brdës, studentët e Prishtinës, nxënësit dhe tërë populli shqiptarë i Kosovës, që numri i tyre arrinte në disa qindra e mijëra demonstrues. Protestat kishte vazhduar tërë natën, mirëpo, kur demonstruesit kuptuan për ndërrimet e Kaqusha Jasharit dhe Azem Vllasit, numri i të pa kënaqurve, rritej prej orës në orë, nga të gjitha anët e Kosovës.[182]

Megjithatë, kulmi i ngjarjes së 'nëntorit shqiptar' është shënuar më 19 nëntor, kur nëpër një rrebesh të madh të shiut dhe të ftohtit në Prishtinë, kishin ardhur mbi

---

[177] G. Autorësh, vep e përm, f.371
[178] Po aty.
[179] 'Rilindja', 04. 05. 1989, Reagimet e Shqiptarëve, f, 5-6.
[180] Po aty.
[181] Blerim Shala, Kosovo krv i suze, Ljubljan. 1990. f. 9
[182] Po aty, f. 11

300.000 mijë njerëz, për të mbrojtur Kushtetutën e Kosovës, duke brohoritur Azem Vllasi e Kaçusha Jashari.

Për këtë arsye, mund të deklarohemi se jeta politike e ekonomike në Kosovë ishte paralizuar plotësisht. Deri sa në Beograd me 28 mars u miratuan amendamentet, e që ajo ditë u kthye në festë të vërtetë, në anën tjetër në Ferizaj, Prishtinë, Podujevë (Besianë), Prizren, Lipjan, Pejë, Mitrovicë, Rahovec Gjakovë etj, shpërthyen demonstrata që të gjitha televizionit e vendit dhe të huaja e tregonin policinë dhe ushtrinë Jugosllave në Prishtinë. Duke e kuptuar se po afrohej shkatërrimi i autonomisë së Kosovës, popullata e Kosovës nuk kishte rrugë tjetër pos t'i filloi një sërë protestash e demonstratash.

Më 20 shkurt, më shumë se 1300 xehetar të Trepçës me dëshirën e vet, ngujohen në horizontin e nëntë,që publikisht i kishin bërë me dije tërë udhëheqjen e vendit se nuk e kanë ndërmend me dalë nga nëntoka, derisa nuk plotësohen kërkesat e tyre prej nëntë pikave. Ato kërkesa të cilat ishin edhe një lloj peticioni që iu kishin drejtuar instancave më të larta shtetërore të Jugosllavisë, ku insistohet para se të gjithave që mos të bëhet ndryshimi i pikave kryesore të Kushtetutës, si dhe të ndërrohen; Rrahman Morina, Hysamedin Azemi, dhe Ali Shukriu. [183]

Pas tetë ditësh, pushteti informoi dorëheqjen e Morinës, kështu që minatorët i dhanë fund protestës së tyre, ndërkohë me udhëzimin e Beogradit, Morina e 'tërhoqi' dorëheqjen e tij. Në të njëjtën kohë në Kosovës u dërguan trupat policore e ushtarake, ku u shpall gjendja e jashtëzakonshme që edhe filloi qërimi i hesapeve me qytetarët e Kosovës. Qindra e mijëra veta që morën pjesë në protesta apo në greva, u arrestuan. Ndër ta ishte edhe Azem Vllasi, i cili formalisht u padit 'për veprimtari kundërrevolucionare me qëllim për të rrezikuar rendin shoqëror'[184]

Gjithashtu, opinionit jugosllav më 21 shkurt është njoftuar për peticionin e 215 intelektualëve shqiptarë të cilët kërkonin që statuti politik i Kosovës i vitit 1974, të mos ndryshohet dhe të ndalohet ndjekja politike antishqiptare.

Në pjesën më të madhe të qyteteve të Kosovës e veçanërisht në Podujevë, Ferizaj, Gjilan, është paralizuar plotësisht jeta e qytetarëve, nuk ka lidhje në mes të qyteteve,

[183] Neol Malcolm, Kosova një histori e shkurtër, Prishtinë. 1998, f,358.
[184] Po aty.

që është vështirësuar jeta me gjërat themelore për jetesë, për shkak të solidarizimit me minatorët e Trepçës.

Për këtë arsye më 23 mars 1989, u mblodh Kuvendi i Kosovës në rrethana të jashtëzakonshme, pasi që para godinës së parlamentit ishin vendosur tanke dhe autoblinda, sikur në Kuvendin e Prizrenit, (8-10 korrikut) të vitit 1945, kur delegatët shqiptarë kishin qenë të detyruar të votojnë kundër vullnetit e dëshirës së popullit shqiptar, nën trysninë e gjendjes së jashtëzakonshme dhe tytave të armëve.[185].

Qëndrimi i qeverisë serbe e ajo jugosllave, ishte në kah të kundërt me proceset e liberalizimit, që po ndodhnin në Evropën Qendrore e Lindore. Ndërsa, populli i Kosovës, nën ndikimin e klimës së re demokratike që po ndihej në Evropën Lindore, e braktisi udhëheqjen komuniste krahinore e cila ideologjikisht ishte e njëjtë me ideologjinë që udhëhiqnin krerët e Beogradit.[186]

Ndërsa, në qershor të vitit 1990, u shpallën një valë e re dekretesh, zyrtarisht të paraqitura si 'masa të përkohshme', në saj të 'Ligjit për veprimtarinë e organeve të republikës në rrethana të jashtëzakonshme'. Këto masa të përkohshme, të cilat mbetën të përhershme, do të përfshijnë edhe suspendimin e gazetës në gjuhën shqipe 'Rilindja', mbylljen e Televizionit të Kosovës dhe Akademisë së Arteve e të Shkencave të Kosovës si edhe dëbimin nga puna e disa mijëra nëpunësve shqiptar të shtetit.[187]

Shumë nga delegatët që kishin marrë pjesë në votimet para ndërtesës së kuvendit me 2 korrik 1990, organizuan një mbledhje tjetër më 7 shtator në qytezën e Kaçanikut në fshehtësi të thellë, në të cilën proklamuan Ligjin Kushtetues për 'Republikën e Kosovës' që do të vlejnë për shtetin e ardhshëm të Kosovës..

Për këtë qëllim intelektualët shqiptarë të Kosovës, krahas kërkesave kombëtare, shtruan edhe kërkesa të tjera me karakter politik, ekonomik, shoqëror e juridik. Ata kërkuan zgjedhje të lira, lirinë e fjalës, lirinë e shtypit, ekonomin e tregut dhe kështu çështja kombëtare e Kosovës u bë pjesë e lëvizjes për demokraci e cila filloi të tërheq ngadalë edhe vëmendjen e opinionit të evropianëve.[188]

---

[185] Grup autorësh, vep e përm,f.342.
[186] A. Lalaj, vep e perm, f. 176
[187] Po aty.
[188] J. Router, vep e përm, f. 97

Në vazhdën e këtyre ngjarjeve, edhe ish anëtarët komunist shqiptar të organeve të Krahinës Autonome të Kosovës, i hodhën librezat e LKJ-së dhe filluan ti krijojnë partitë e tyre të reja demokratike siç janë: Lidhja Demokratike e Kosoës, Partia Parlamentare, Partia Fshatare, Partia Socialdemokrate, Partia Demokristiane, Partia Liberale, Partia e Unitetit Kombëtar, Partia Popullore etj.

## Rezistenca e shqiptarëve të Llapit kundër marrjes së Autonomisë nga Serbia

Muaji mars i vitit 1989, është muaji më i rëndi në pesëdhjetë vitet e fundit për popullin shqiptar, pasi Kosovës me forcën e policisë dhe të ushtrisë iu morr Autonomia e fituar me shumë mund e gjak gjatë gjithë historisë. Demonstratat e protestat që kishin filluar në janar nga minatorët e Trepçës, si edhe demonstratat e protestat kundër marrjes së Autonomisë së Kosovës, vazhdojnë ende edhe në rajonin e Llapit.. Në të gjitha qendrat e policisë dhe gati në të gjitha objektet e shkollave e qendrat urbane, ishin vendosur njësitet speciale të policisë së Bashkuar të Jugosllavisë. Ato u vendosën edhe në rajonin e Llapit. Nën trysninë e këtyre masave shtetërore, ishte tepër e domosdoshme që të bëhen demonstrata, për të dëshmuar se shqiptarët, kanë vendosur që me çdo kusht të mbrojnë Autonominë e Kosovës.. Në frymën e këtij vendimi u organizuan demonstrata edhe në Besianë. Demonstratat masive u organizuan më 27 mars të vitit 1989 ( të ngjashme me ato të nëntorit të vitit 1988 në Prishtinë), kur kreu i kolonës kishte arritur në Prishtinë e fundin e kishte në Lluzhan. Demonstruesit u tubuan afër Shtëpisë së Kulturës në Besianë dhe pastaj vazhduan demonstrimin e tyre drejtë qendrës së qytetit në drejtim të Komunës.

Përpara demonstruesve, doli grupi i policëve i komanduar nga Jetullah Kuqi, që ishte edhe Komandant i policisë në Besianë. Jetullah Kuqi bashkë me policinë kishte dalë përpara demonstruesve për t'i penguar e shpërndarë popullin që mos të protestojnë. Në atë rast disa demonstrues e kanë kapur dhe e kanë tërhequr komandantin e policisë në mesin e tyre. Policët u munduan ta tërheqin dhe ta largojnë atë nga masa, gjë të cilën nuk ia arritën.. Në at moment, dikush nga anash, shtiu me

armë zjarri në Komandantin e Policisë i cili mbeti i vdekur në vend. Aty u plagos edhe polici serb Zoran Koraç, i cili ishte së bashku me Jetullah Kuçin. Vrasja e tij mbeti enigmë edhe sot e kësaj dite.[189]

Gjithashtu, atë ditë në Besianë pati edhe konflikte të tjera në mes demonstruesve dhe policisë. Në orët e vona të pas ditës, policia filloi të shtijë në demonstrues me armë zjarri ku u plagosën mbi 20 veta.

Rezultat dhe epilog i kësaj situate ishin; Vrasjet e demonstruesve, shtirja me armë, lufta, barrikadat, burgosjet masive, gjendja e luftës, ora policore, gjaku, kufomat e pavarrosura e kjo ishte pamja e tragjedisë së Llapit, në javën e fundit të marsit, pas shpalljes në Beograd më 28 mars amendamentet e Kushtetutës Serbe. Sipas versionit zyrtar, mund të kuptojmë se ora policore është shpallë më 27. mars 1989 që fillon prej orës 20 në mbrëmje e mbaron në ora pesë në mëngjesit, që është ndaluar edhe shëtitja e më shumë se dy vetave nëpër qytete. Të gjitha shkollat janë mbyllur, kurse çdo tentim për t'i kundërshtuar organet shtetërore,(policinë, ushtrinë apo udhëheqësit politikë), do të bëjë vepër penale që do të ndëshkohet me ligjet Jugosllave[190], thuhej në urdhëresën e policisë.

Në ditën e 27 marsit, shihet shumë mirë se milicia kishte qenë mjaft e hutuar për ecurinë e zhvillimit të ngjarjeve në Besianë, edhe pse dy apo tri ditë, përpara shpërthimit të demonstratave kishte informata se kjo do të ndodh. Është shumë interesant të përmendet se i ashtuquajturi 'Fronti i Podujevës' që më së shumti e përbënin të moshuarit që me pushkë i sulmonin edhe helikopterët nga minaret e xhamive, që njeri prej tyre edhe është goditur. Besiana tri ditë ishte plotësisht nën kontroll nga populli, përderisa është dashur që njësit speciale të intervenojnë me tanke policore, helikopter, mjete të motorizuara ushtarake etj.[191]

Gjatë muajit mars 1987, anëtarët e grupit ilegal të LPRK-së, kishin marrë vendim që të formonin edhe krahun ushtarak të saj, pasi gjatë këtyre viteve në Kosovë, ishte bërë radikalizmi i situatës. Ata kishin vendosur që Ali (Adem) Ajeti të jetë përgjegjës e komandant i gueriles shqiptare në rajonin e Llapit dhe asnjë aksion i armatosur të mos

---

189 Safet Zejnullahi, E vërteta, kurrë nuk doli në dritë, Zëri,28 nëntor 1991.
190 B. Shala, vep e përm, f. 27.
191 Po aty, f.28.

bëhej pa lejen e tij, ndërsa, përgjegjësit politik dhe koordinatorët e qendrës të grupit gueril të Llapit, do të zgjidhen më vonë nga anëtarët e LPRK-së.[192]

Gjatë demonstratës së 27 marsit, grupi gueril Ilegal i Llapit ishte i armatosur, por përdorimi i tyre mund të lejohej vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe kur është në rrezik lëvizja kombëtare, por çdo herë duhet njoftuar me kohë Komandanti i Çetës[193].

Atë ditë, pati edhe vrasje të tjera, pasi policia shtiu me armë zjarri në demonstrues. Si rezultat i kësaj është edhe vrasja e Mehmet Ejupit nga fshati Vendenis, tek hekurudha e afër stacionit të trenit në Besianë, i cili në trupin e tij kishte marr 17 plumba të kalibrit 7.62 të pushkës automatike M-70 të përdorura nga ana e milicisë serbe. [194]

Realisht, sot më së shumti bëhet pyetje se sa njerëz janë të vrarë e të plagosur në këto ndodhi të përgjakura që e kanë tronditur Kosovën. Të dhënat zyrtare e 24 të vdekurve, përveç emrit të Jetullah Kuqit, emra të tjerë nuk përmenden, pasi që politikës shtetërore nuk i konvenon. Mirëpo, nga ajo që është duke u dëgjuar, në Kapelën e të vdekurve në Prishtinë janë numëruar 180 kufoma, dhe pasi nuk ka vend në frigorifer, kufomat i kanë vendosur edhe në tokë.[195]

Si duket, udhëheqja partiake e Kosovës dhe ajo Serbisë nuk i kanë llogaritur zhvillimin e ngjarjeve në këtë mënyrë, e posaçërisht pas ndërrimeve kushtetuese dhe demonstratave të marsit të vitit 1989. Ato u kishin premtuar qytetarëve se pas ndërrimeve kushtetuese do ta vendosin rendin dhe qetësinë në tërë territorin e Serbisë, se do të jetojnë shumë më mirë e më qetë në tërë shtetin e vetë të pandarë. Megjithatë, realiteti po tregon krejtësisht të kundërtën se këtu, mund të jetohet sot për nesër.

Shqiptarët, që për asnjë çmim nuk dëshirojnë të dorëzohen përpara ndërrimeve kushtetuese dhe ta pranojnë robërinë kushtetuese, përsëri shqiptarët llapjanë në Besianë, përsëri ia filluan protestave, vendi që në kohën e fundit është bërë barometër politik i Kosovës. Në këtë qytezë, me 30 maj 1989 më shumë se 3 mijë demonstrues

---

[192] F. Pushkolli, vep.e përm, f .121
[193] Bajram Ajeti, Sabri Kiçmari, Kujtime, 13.02. 2011. Besian.
[194] B. Kurti, vep e përm, f. 68
[195] B. Shala, vep. e përm, f. 29.

edhe pse ishte vështirë të mendohet se mund të bëhej ndonjë demonstratë, shpërtheu protesta ku kërkohej që Krahinës t'i kthehej statuti i para 23 marsit.[196]

Fillimin e protestave në Besianë, mund ta lidhim shumë lehtë me vizitën e delegacionit të parlamentit Evropian që (kishte ardhur për ta shikuar shkeljen e të drejtave të njeriut në vend) gjegjësisht në vendin ku pushteti jugosllav nuk po mundet ta qetësoj situatën edhe pse qyteti i Besianës është rrethuar e mbuluar me hekur e policë me helmeta e armë të zjarrit.

Në Besianë, intervenimi i menjëhershëm i policisë ishte shumë i egër, sipas udhëzimeve të preferuara, posaçërisht për Kosovën., që në atë konflikt ushtarak u përdorën edhe armët e zjarrta nga milicia speciale që më në fund demonstruesit i detyruan të largohen në periferi të qytetit, drejtë fshatit Mirovc, që t'i zënë më lehtë. Njësia speciale në këtë aksion e vrau ish të burgosurin politik dhe Komandantin e Grupit Ilegal të Llapit, Ali Ajetin i cili ishte dënuar me pesë vjet burg në vitin 1984 për veprimtari 'armiqësore'[197].

Jehona e demonstratave të 30 majit 1989 ishte shumë e madh, jo vetëm në rajonin e Llapit, po edhe në viset tjera të Kosovës. Në të njëjtën ditë, deri te prishja e situatës politike dhe demonstratat kishte ardhur me pak vonesë, edhe në Therandë, Prizren, e Prishtinë, pasi kishin dëgjuar për demonstratat e Besianës. Në këto demonstrata më së shumti janë dëgjuar parullat: Kosovë, Liri, Nuk është Kosova Jugosllavi, Kosova nuk është Serbi, Serbi nuk do të jesh më mbretëri, Rrahman Morina tradhtar, Poshtë Millosheviqi, është kënduar edhe kënga Besa-Besë, Besën ta kam dhënë, për Kosovën do të vdesim te tanë etj.[198]

Duke i marrë parasysh të gjitha këto të dhëna, Llapi është rajon i veçantë, sa i përket ligjeve e kontrollimit nga ana policore . Për këtë qëllim me 1 nëntor 1989 në Prishtinë pa kurrfarë arsyeje Jakup Hoti inspektor i lartë i sigurimit nga Bardhashi i Besianës e vret Bedri Ilaz Sokolin i cili merrte pjesë në demonstratat e shqiptarëve në Kosovë, si kundërshtim kundër fillimit të gjykimit të Azem Vllasit në Mitrovicën e (Titos), dhe14 'kundërrevolucionarëve' të tjerë shqiptar[199].

---

[196] Alternativa Demokratike, Lubjanë, mars 1990, Shqiptarët pas marrjes së autonomisë së Kosovës.
[197] Po aty, f. 17.
[198] B. Shala, vep e përm, f. 42.
[199] Po aty, f, 68.

Dëshiroj, ta citoj, deklaratën e kryepolicit serb në Kosovë, i cili thotë: Ne e kemi lehtë ta qetësojmë Kosovën, sepse atje demonstrojnë shqiptarët, të cilët mund të vriten lirisht e mos të përgjigjet asnjeri. Kemi kompetenca, por edhe askush nuk guxon të merret në përgjegjësi, pavarësisht sa shqiptar vriten[200].

Llapjanët, jo vetëm që rezistonin ndaj gjenocidit dhe dhunës që ushtronte pushteti serb, ndaj popullit të shqiptar të Kosovës, po edhe shqiptarëve në viset tjera të Jugosllavisë, një numër i madh i tyre ishin prijatar të lëvizjes dhe grupeve ilegale kombëtare shqiptare nga vitet 1980 e deri në vitin 2000. Një ndër ta është edhe Afrim Zhitiu nga fshati Lugajë, i cili gjatë vitit 1984, ishte dënuar me 8 vjet burg të rëndë, edhe pse ishte i mitur, ndërsa bashkëluftëtari i tij, Fahri Fazliu nga fshati Llaushë i Besianës (1963), i cili jetonte në Breg të Diellit. Afrimi Zhitiu dhe Fahri Fazliu, ishin prijatar dhe organizator të Lëvizjes Ilegale Kombëtare dhe i një numri të madh të demonstratave. Afrimi ishte i ditur për organizimin e punës ilegale dhe ato ushtarake, pasi ishte në krye të LPRK-së. Për këtë qëllim, Afrim Zhitiu e kishte përkrahur dhe e kishte lejuar formimin e krahut ushtarak i cili u quajt,Qeta e Llapit, pasi situata politike dhe gjendja e shqiptarëve vinte duke u keqësuar për çdo ditë, nga dhuna dhe masat serbe, pas marrjes së Autonomisë së Kosovës.[201]

Në luftën heroike, Fahri Fazliu, bashkë me Afrim Zhitinë, dolën nga baza e tyre që fshiheshin për një kohë të gjatë,e që pastaj vazhdojnë që të shkojnë në banesën e Fahriut, të cilët, përcilleshin hap pas hapi prej policisë serbe dhe njësisë speciale të Kosovës nën komandën e N. I,. me qendër në Ajvali afër Prishtinës. Kjo ishte me të vërtetë një vdekje madhështore e cila bëri jehonë nga Perëndimi në Lindje të rruzullit tokësor pas një qëndrese, aq sa ishte madhe, ishte edhe krenari e shqiptarëve. [202]

Rezistenca popullore e grupeve ilegale dhe popullore, vazhdoi me demonstrata edhe gjatë vitit 1990, jo vetëm në qytetin e Besianës, po edhe në fshatrat për rreth saj. Gjatë kësaj kohe, duke protestuar në Lupç pranë rrugës Besianë-Prishtinë mbetën të vrarë edhe nxënësit, Ylfete Humolli dhe Bedri Maksuti.[203]

Gjithashtu, vala e rezistencës së popullit dhe organizatorëve edhe përkundër masave shtetërore, gjatë vitit 1990, ajo vinte duke u rritur, po edhe vala e vrasjeve dhe

---

[200] Shih,Politika, Beograd, 12 nëntor 1989.
[201] F, Pushkolli, Vep e , f, 188.
[202] Adem Gashi, a... Zh Vetëtimat e Nëntorit, Prishtinë 2005, f. 259
[203] Fehmi Krasniqi, Majasi-lugina e Kaçanollit me rrethinë 1912-2000, Prishtinë 2006, f.188

burgosjeve shtohej për çdo ditë. Për këtë arsye më 12 e 13 shtator, milicia e Serbisë e ndihmuar nga makineria ushtarake Jugosllave, i rrethojnë familjet e Manollëve në Pollatë të Besianës. Gjatë këtij sulmi, vriten Besim Latifi dhe Skender Manolli, ndërsa u rrahën dhe u torturuan të gjithë anëtarët e familjeve të tyre.[204]

Gjatë vitit 1991 duke rezistuar kundër policisë serbe, në rrugën Besianë-Krpimeh në fshatin Peran të KK,. Besianës, vritet edhe Ragip Hoti nga fshati Bardhash përsëri nga komuna e Besianës[205].

Pasojat e kësaj gjendjeje të mbikëqyrur në Llap, mundemi ta shikojmë në kuadër të këtyre ngjarjeve të njëpasnjëshme edhe gjatë vitit 1994, kur edhe vritet një luftëtarë i madh i lirisë së Kosovës dhe udhëheqësi i Qetës së Llapit Hasan Ramadani me nofkën (Galani) në shtëpinë e tij në Albanik ( Shajkovc), i cili ishte dënuar me burg edhe në vitin 1984 me Grupin Ilegal të Llapit që i digjet edhe tërë shtëpia.

Në korrik të vitit 1990, Serbia ndërmori masa të ashpra në Kosovë e Besianë. Masat administrative u ndërmorën edhe në Kuvendin Komunal të Besianës. Masa të posaçme u vendosën edhe në ndërmarrje e shkolla. Arsimtarët dhe profesorët nuk pranuan planet dhe programet mësimore e cila u bë shkas që për të gjithë të ndërpritet mësimi. Ndërsa dy shkollave të mesme iu mor edhe lokali shkollor. Praktikisht në Besianë u vendos regjimi ushtarako-policor serb me tërë fuqinë që kishte. Me veprimet që vazhdonin serbët, bënin edhe pastrimin etnik që arriti shkallën e gjenocidit. Lirisht mund të themi se shqiptarët janë vënë plotësisht jashtë ligjit. Për këtë qëllim në rajonin e Llapit shumë qytetar filluan të interesohen për sigurimin e armëve pasi që e vetmja mundësi është që dhunës t'i përgjigjet me dhunë, pasi që llapjanët e kanë vështirë ta durojnë dhunën e mbuluar me maskën qeveritare.

Për këtë arsye, gjatë vitit 1981 ishte përhap fjala se kur Kosova do të bëhet Republikë, 'Llapi do të ta shpallet Krahinë Autonome e Shtetit të Kosovës[206]'.

Një rol të veçantë për mbrojtjen e çështjes shqiptare në Kosovë, luajtën edhe shoqatat, Nënë Tereza, Shoqata e Intelektualëve Llapjan, dhe dy shoqata të rëndësishme në Kosovë. Këto, ishin Shoqata e Filozofëve dhe Shoqata e Sociologëve si dhe Shoqata e Shkrimtarëve të Kosovës. Një rëndësi shumë të veçantë e vendimtare për kohën, luajti edhe Lëvizja gjithë popullore për pajtimin e gjaqeve nën drejtimin e

[204] B. Kurti, vep e përm, f. 73
[205] F. Krasniqi, vep e përm, f, 337.
[206] B. Shala, vep e përm., f. 94

prof. Anton Çetës, që i ndihmoi në bashkimin e plotë të shqiptarëve dhe ndërkombëtarizimin e tij.

## Diferencimet ideo-politike të shqiptarëve në Llap

Gjatë, gjithë kohës së sundimit të Jugosllavisë komuniste, në Kosovë ka vazhduar në lidhshmëri politika e ndjekjes, burgosjeve, vrasjeve, shtrigave dhe e diferencimit. Ky proces pas vitit 1981, është ashpërsuar e zgjeruar në të gjitha shtresat e popullsisë.

Pas, demonstratave të vitit 1981, nën presionin e udhëheqjes serbe, diferencimin të parët e kanë kërkuar anëtarët e LK. të Kosovës. Ky diferencim famëkeq u shtri si në rrafshin horizontal ashtu edhe vertikal, e që shkoi, deri tek nxënësit e shkollave të mesme e fillore, madje ai hyri edhe ndërmjet familjeve shqiptare. Për këtë fenomen, është shkruar shumë në mjetet e informimit, e njëkohësisht është diskutuar edhe në çdo mbledhje e në çdo vend të Kosovës.

Organet partiake e shtetërore menjëherë pas demonstratave, filluan të zbatonin procesin e diferencimit në të gjitha lëmit e jetës, duke filluar nga familja e deri atje ku punohej e mësohej. Mirëpo, shënjestër e pushtuesit ishte, universiteti, ngase edhe më herët ishte sulmuar nga shumë politikanë vendorë siç janë:Azem Vllasi; Ali Shukriu, Sinan Hasani etj, duke e quajtur 'bastion të nacionalizmit shqiptar'. Për këtë arsye i tërë dufi dhe mllefi i nacionalistëve serb dhe vasalëve të krijuar shqiptar zbrazej në te.[207]

U miratuan shumë qëndrime, duke filluar nga Komiteti Qendror i LKJ-së, KQ të LKS-së, KK të LKK-së e duke përfunduar deri te bashkësitë lokale. U shkruan shumë libra, broshura, tekste e informata për 'nacionalizmin shqiptar'. Por ai që i dha 'vizë' çdo veprimi antishqiptar ishte 'Programi aksionar i veprimit të LK të Kosovës, në luftë kundër forcave armiqësore dhe kundërrevolucionare për stabilizimin e gjendjes politike në Krahinë' të cilën e miratoi Komiteti Krahinor i LKK-së me 23 maj 1981 në Prishtinë.[208]

---

[207] Wolfgan Petrisch e RobertPhiler, Rrugë e gjatë në luftë, (Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare 1989-1999 ), Prishtinë, 2002, f. 119.

[208] Programi aksionar i LKK-së, në luftë kundër forcave armiqësore dhe kundërrevolucionare në Kosovë për stabilizimin e gjendjes në Krahinë, 23 maj 1981.Prishtinë

Pas, miratimit të dokumentit aksionar filloj fushata e mbajtjes së mbledhjeve partiake në Universitete, shkolla të mesme e fillore dhe në institucionet tjera në Komunën e Besianës. Të gjitha këto diferencime bëheshin nga anëtarët e LK të Kosovës duke filluar nga ata me funksione më të larta deri tek ata në fshat, ku janë shkruar mjaft në shtypin e kohës. P. sh. 'Zëri i rinisë', citonte Ali Shukriun, njërin nga udhëheqësit që i shkaktoi më së shumti dëm Kosovës, thotë: Të gjitha këto tregojnë se në luftën për një diferencim sa më konsekuent për zbulimin e elementëve armiqësor si edhe izolimin e tyre'[209]

Askush në Kosovë nuk duhet të mashtrohet se me gjykimin që u kemi bërë demonstratave dhe organizatorëve të tyre e kemi mundur armikun e klasave.[210]

Me këtë, nuk kishte marr fund procesi i diferencimit në komunën e Besianës e sidomos në shkollat e mesme dhe fillore të këtij rajoni. Bartësit e diferencimit nëpër qendrat shkollore e luanin Organizatat Themelore të Lidhjes së Komunistëve (OTHLKJ)-së të çdo institucioni.

Pas demonstratave të 1 e 2 prillit të vitit 1981, në gjimnazin '8 Nëntori' në Besianë për shkak të diferencimit, u larguan nga procesi mësimor një numër i madh i mësimdhënësve për shkak të diferencimit. Politik ,siç janë:

1 Ejup Shala, prof i gjuhës dhe letërsisë shqipe. U vra në luftën e UÇK-së nga ushtria e policia serbe,në fshatin Konushefc.

2 Shukri Rexhepi, profesor i gjuhës angleze, u dënua me dy muaj burg.

3 Muhamet Bllaca, profesor i gjuhës shqipe. u dënua me dy muaj burg.

4 Hazir Raçi profesor i informatikës i dënuar me dy muaj burg.

5. Hamdi Mustafa, prof i gjuhës frëngjishte, u dënua më vonë me 8 vjet burg.

6. Ramadan Dibrani inxhinier i elektroteknikës u dënuar me dy muaj burg.

7. Avdi Gjata profesor i Historisë i larguar nga gjimnazi '8 Nëntori' ,u dënua me 8 vjet burg , si punëtor i Kosova-transit në Besianë.

8 Ismet Begolli, jurist (gazetar) u dënua me12 vjet burg.

9. Hamit HAmiti, inxhinier i mak SHLP. u dënua me 3 vjet burg.

10 Mehmet Shala , arsimtar i anglishtes, 1 muaj burg.

---

[209] 'Zëri i rinisë'16.05. 1981. Prishtinë.

[210] 'Rilindja'18. 04. 1981, Prishtinë.

Profesorët që u diferencuan dhe u larguan nga procesi mësimor gjatë viteve 1981-1990 për shkak të pa përshtatshmërisë ideo-politike dhe përkrahës të kërkesës Kosova Republikë.

1 Mr. Ibrahim Bajgora, profesor i historisë. 13. Ejup Dibrani, prof i matematikës

2. Agim Blakçori, profesor i historisë. 14. Nazmi Kllokoqi----

3. Avdi Gjata , profesor i historisë 15. Mehmet Breznica, SHL e Dramës

4. Ismet Ahmeti, prof i gjuhës shqipe. 16. Nuhi Sokoli, SHLP, Ed. Fizike.

5. Idriz Gashi , skulptor, prof i artit

6 Avdullah Blakqori, prof. i gjuhës e shqipe.

7. Emin Emini, prof i sociologjisë

8. Ismet Konushevci, inxh. SHLT.

9. Fatime Gjata, inxhi. SHLT.

10. Ramadan Kaçiu, inxhi. SHLT.

11. Muharrem Blakçori, arsimtar i matematikës.

12. Lutfi Hasani, arsimtar i matematikës.

13. Halide Gjata, arsimtare e matematikës

Të gjithë këta profesor ishin të angazhuar drejtë për së drejti, ose tërthorazi në demonstratën e prillit të vitit 1981.[211]

Emrat e profesorëve që u burgosën-dënuan pas demonstratës të 27 marsit 1989.

Enver Potera.

Arsim Kopalla profesor i

Sabit Osmani profesor i matematikës

Hava Hysen Bllaca.- profesoreshë e Biologjisë.

Arsimtarët që u dënuan gjatë vitit 1989 për angazhim e aktivitet politik për mbrojtjen e autonomisë së Kosovës.[212]

Nxënësit e Qendrës '8 nëntori' që u dënuan e u larguan nga muaji mars i vitit 1981, e deri në prill të vitit 1989.

1. Ruzhdi Kiçmari, 10. Sebahate Hoxha. u përjashtua.

2. Nazmi Ajeti 11. Besim Bulliqi- u përjashtua.

3. Mirvete Ajeti. 12. Shpëtim Maliqi- u përjashtua.

---

[211] Kujtime, Ramadan Dibrani, Hamit Hamiti, Idriz Gashi, Idriz gashi dhe Avdi Gjata.

[212] Kujtime, Sabit Osmani, Hava Hyseni, Enver Potera.

4. Hidajete Behrami 13. Halim Rrmoku- u përjashtua
5.Hafije Zebica. 14. Tefik Gashi u dënua me burg.
6. Naser Azemi. 15. Mehridin Idrizi, u dënua me burg
7. Drita Hoxha. 16. Ibush llapashtica, u dënua me burg.
8. Fatmir Svishta. 17. Berat Begu. u dënua me burg.
9. Safet Ajeti 18. Enver Potera. u dënua. Me burg.

Emërat e nxënësve të cilët u diferencuan dhe emrat e atyre që u burgosën me burg në demonstratën e viti 1989.[213]

Diferencimi ideopolitikë nuk kishte të ndalur. Ai bëhej nga grupet e aktivistëve të LK-së të Besianës që ishin zgjedhur menjëherë pas demonstratave të vitit 1981. Ai nuk kishte fund, pasi anëtarët shqiptar të organizatave themelore të LK-së e kishin kuptuar shumë vonë, qëllimin e politikës serbe të diferencimit. Ai nuk kishte filluar, vetëm për pjesëmarrësit e përkrahësit e demonstratave dhe të nacionalistëve shqiptar, por, kishte filluar me për futjen e vëllavrasjes, ndërmjet shqiptarëve e dobësimin e përgjithshëm të rezistencës të shqiptarëve në Jugosllavi që në të ardhmen, t'i sundojnë më lehtë.

## Formimi i partive politike shqiptare në rajonin e Llapit

Pas marrjes së Autonomisë së Kosovës më 23 mars 1989 dhe shumë ngjarjeve e lëvizjeve të paparashikueshme që ndodhën në këtë vit në Kosovë, që fundi i vitit 1989, ishte një përfundim tragjik për shqiptarët. Me politikën e egër fashiste që ushtronte Serbia ndaj shqiptarëve të paparë ndonjëherë më parë, u detyruan më në fund të bashkëngjiten rezistencës shqiptare e mbrojtjes së Kosovës, edhe ata shqiptar, që deri dje ishin në pozita të larta shtetërore e institucionale, e që ishin angazhuar për ta ruajtur gjendjen e mëparshme që iu garantonte kushtetuta e vitit 1974.

Ndërsa, në anën tjetër, një numër i qytetarëve serb që ishin nëpër institucionet shtetërore e kulturore në Kosovë, filluan të merrnin rol politik, pas një numri të madh dorëheqjesh të anëtarëve serb, më 1988, të cilët dëshironin të bëheshin anëtarë të një

[213] F. Krasniqi, vep. e përm, f. 125.

organizate të shkrimtarëve serbë, për të hyrë në polemikat dhe kundërshtimet me kolegët e tyre shqiptarë që pasuan më vonë.[214]

Për këtë qëllim, Shoqata e Shkrimtarëve Shqiptar e paraqiti platformën e pikësynimeve politike kombëtare shqiptare që hasi në një përkrahje të gjerë, duke e shëndërruar Shoqatëne Shkrimtarëve...në një embrion të 'Lëvizjes popullore'[215], në krye me shkrimtarin Dr. Ibrahim Rugova i cili u bë më vonë edhe lideri më autoritar shqiptar në Kosovë.

Kjo lëvizje e gjerë politike më 23 dhjetor të vitit 1989 ,do të kaloi në parti politike në LDK, që është edhe partia e parë legale në Kosovë, me të cilën filloi edhe jeta legale pluraliste shqiptare në Kosovë.

LDK-ja ishte partia më masive që kishte për qëllim mbrojtjen e popullit shqiptar në Kosovë në mënyrë paqësore, dhe angazhohej për ndaljen e dhunës që e shkaktonte e organizonte Serbia mbi shqiptarët e Kosovës.[216].

Ishte organizatë e parë politike që u formua legalisht në kohën e fillimit pluralist në Kosovë e Jugosllavi e cila është regjistruar në Qeverinë Jugosllave të Vllado Kambovskit. Këtu qëndron edhe rëndësia 'historike' për veprimtarinë e popullit shqiptar në mënyrë kolektive dhe të organizuar nën regjimin e S. Millosheviqit, për t'i mbrojtur interesat kombëtare jo vetëm në Kosovë por edhe në viset tjera të Jugosllavisë.[217]

LDK-ja, po edhe partitë tjera shqiptare në Kosovë, gjatë vitit 1990 arritën t'i formojnë degët e veta në të gjitha komunat e Kosovës, e që ajo u realizua edhe në komunën e Besianës e cila numëronte mbi 50 mijë anëtar.

Më 15 janar të vitit 1990 një grup qytetarësh e intelektualësh shqiptar në krye me dr. Fehmi Pushkollin në çajtoren e Majacit e mbajtën mbledhjen themeluese të Degës së LDK-së në Besianë ku zgjodhën Këshillin Nismëtarë me 15 anëtarë. Në këtë formë filloi punën Dega e LDK-së në Besianë që filloi të bëhej anëtarësimi i qytetarëve me një shpejtësi të madhe. Pas mbajtjes së kuvendit të Degës së LDK-së në Besianë. Kryetar i degës u zgjodh Dr. Rexhep Gjergji me 15 anëtar të kryesisë.Tani Dega e LDK-së së bashku me anëtarët e saj filloi t'i kryej detyrat e saj rreth përgatitjes për

---

[214] N. Malcolm, vep e përm,, f. 362
[215] Po aty.
[216] Jemes Petifer e Vickers Miranda, Çështja shqiptare, Tiranë 1998, f. 177
[217] Osman Ismajli, Partitë Politike Shqiptare dhe Çështja e Kosovës(1989-1998), Prishtinë, f, 23.

zgjedhjen e Nëndegëve dh Aktiveve. Në kuadër të LDK-së ishin formuar 17 Nëndegë, të cilat i kishin zgjedhur edhe aktivet e tyre. Aktivin e përfaqësonte kryesisht një fshat, që edhe aktivi e zgjidhte Kryesinë e vet prej 15 anëtarëve. Pas zgjedhjes së përfaqësuesve të LDK-së së bashku me anëtarët e partisë dhe popullit u organizuan shumë aktiviteti të rëndësishme për Kosovën siç ishin: Mbajtja e Referendumit, zgjedhjet për Kuvendin e Republikës dhe Kryetarin e Republikës.[218]

Në fillim në kuadër të LDK-së kryheshin të gjitha aktivitetet si: organizimi i ndihmave solidare,vazhdimi i punës arsimore, sigurimi i mjeteve financiare për arsimtarët si dhe detyra të tjera të nevojshme që paraqiteshin brenda Lëvizjes Kombëtare në këtë pjesë të Kosovës. Më vonë në Besianë u formuan edhe degët e partive të tjera politike si. Partia Parlamentare, Partia Fshatare, Partia Shqiptare Demokristiane, Partia e Unitetit Kombëtar, Partia Social Demokrate e të tjera.

- Partia Parlamentare- Dega në Besianë. Agron Jaha Kryetar.
-Partia Fshatare - Dega në Besianë, Ismet Fejzullahi Kryetar.
- Partia Shqiptare Demokristiane, Besianë, Nazmi Halimi. Kryetar.
- Partia e Unitetit Kombëtar 'UNIKOMBI' Bajrush Behrami Kryetar.

Edhe degët e këtyre partive politike ishin zgjedhur me mbajtjen e Kuvendit të Degëve me votime të fshehta demokratike, që Kryesia e Degëve kishte numrin e anëtarëve të rregulluar me Statutin e Partisë. Gjithashtu, degët e partive i kanë zgjedhur edhe Nëndegët e Aktivet e partisë.

Të gjitha këto parti politike angazhoheshin për ngritjen politike dhe kombëtare të popullsisë. Politika pushtuese serbe nuk arriti të pengojë dhe të ndërprenë aktivitetin paralel të organeve të pushtetit në komunën e Besianës si njësi administrative e politiko shoqërore të Republikës së Kosovës, në mesin e të cilës nuk pranohet pushteti robërues i Serbisë.

## Të burgosurit politikë dhe partitë politike në Llap

Është një përvojë dhe rregull nga historia që territoret, kombet e popujt e ndarë më dysh, tresh apo më shumë vende , të aspirojnë të bashkohen. Rrethanat që kishte kaluar

[218] F Pushkolli, vep e përm, f. 339.

e kalonte popullsia shqiptare jashtë shtetit shqiptar në federatën jugosllave dhuna e vazhdueshëm dhe sistematike i ndihmoj mbajtjes gjallë aspirata për zgjidhjen e çështjes kombëtare.

Në këtë mënyrë, ndjenja e bashkimit me Shqipërinë dhe e çlirimit, nuk është ide e importuar nga jashtë, po ajo është e konstruksionit shpirtëror e psikologjik i popullit shqiptar. Me gjithë zhvillimet, statusi i tyre politik, krahasuar me republikat tjera të Jugosllavisë, ishte përsëri i ulët duke mbetur ashtu siç ishte, pra i pa mbyllur. Shqetësimi dhe përpjekjet e shqiptarëve të Kosovës për prosperitet, gjithnjë ishte e fokusohej në atë, si të pavarësoheshin nga Serbia e të arrinin statusin e republikës. Pas ngjarjeve të viti 1981, mbi shqiptarët si popull,, dhuna kombëtare u shtua, e sidomos pas ardhjes së Sllobodan Millosheviqit në krye të shtetit serb. Në mars të vitit 1989 S. Millosheviqi i hoqi Kosovës autonominë. Shqiptarët përsëri u ngritën në demonstrata paqësore e protesta, të paktën për të ruajtur at që e kishin fituar në vitet e 70-ta. Gjendja e krijuar në Kosovë, në rrugën e tyre drejt vetëvendosjes nuk kishte më kthim prapa.

Për këtë qëllim në dhjetor të vitit 1989 shqiptarët e Kosovës arritën që ta formojnë patinë e parë politike legale 'Lidhjen Demokratike ' në krye me Ibrahim Rugovën. Ky vit është edhe vit i fillimit të krijimit të pluralizmit politik në Kosovë. Pastaj, vazhduan të krijohen edhe partitë tjera politike në të gjithë Kosovën. LDK-ja ishte partia e parë dhe kishte edhe rrolin dominant në proceset politike që zhvilloheshin gjatë kësaj kohe në të gjitha trojet shqiptare në Jugosllavi. Këtu qëndron edhe rëndësia historike për orientimin dhe veprimin e popullit shqiptar në mënyrë kolektive. Është shumë reale dhe e qartë pse populli shqiptar e priti me padurim këtë parti politike, duke i dhënë edhe besimin e plot që ajo ta udhëheqë në rrugën drejtë lirisë së dëshiruar kaq shumë nga ky popull i robëruar me dekada nga robëria sllave.

Derisa LDK-ja ishte formuar në fund të muajit dhjetor të vitit 1989 dhe vazhdonte konsolidimin e saj gjatë vitit 1990, pushteti jugosllav nën drejtimin e Stipe Shuvarit, bëri një amnisti për pjesën më të madhe e të burgosurve politik, për të arsyetuar para opinionit ndërkombëtar se qe gjendja politike në kosovë ka filluar të qetësohej, gjë e cila nuk ishte e vërtetë. Kjo amnisti u bë, pasi Serbia ia hoq Autonominë Kosovës e cila mbeti vetëm nën juridiksionin serb.

Situata e krijuar dhe rreziku që i kanosej popullit shqiptar, nga regjimi policor serb, i detyroi të burgosurit politik shqiptar që t'i përveshën punës organizative politike dhe mos të bëjnë as më të voglin pushim pasi që koha nuk priste. Gjithashtu, ne gjendeshim përpara një dileme shumë të madhe rreth 'mundësisë' së krijimit dhe veprimit legal të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në Kosovë, nën pushtimin dhe sundimin serb. Megjithatë unë (A. Gjata), mora iniciativën që ne të burgosurit të mbajmë një mbledhje ku do të bisedojmë dhe do të marrim vendim si do të veprojmë në situatën në të cilën gjendemi. Takimin e caktuam në shtëpinë e Avdullah Ramës më 23 mars 1991 e cila gjendet në Besianë. Në mbledhje ishin prezent:Avdullah Rama, Avdi Gjata, Fadil Lepaj, Hamit Hamiti, Fehmi Berisha, Ejup Shala, Nexhmi Bala, Gjeladin Rekaliu, Avdyl Mustafa, Hasan Ramadani, Ramadan Dibrani etj. Mledhjen e hapi Avdi Gjata me një pikë të rendit të ditës.

Angazhimi apo mos angazhimi i të burgosurve në partitë politike të formuara legale. Pasi që unë u mundova që ta shpjegoj situatën tepër të rënduar politike dhe u mundova që ta sqaroj mendimin tim rreth angazhimit në parti politike që isha për po, fjalën ia dhashë pjesëmarrësve të tjerë në mbledhje. Të gjithë pjesëmarrësit të cilët në fjalët e tyre analizonin situatën e krijuar në komunën e Besianës dhe të Kosovës, shprehnin mendimin për po ose edhe jo. Problemi më i madh që u shtrua gjatë mbledhjes ishte : Si ka mundësi që një popull i robëruar t'i lejohet krijimi i partive politike legale që të punojnë për krijimin e shtetit e çlirimin e vendit, gjë të cilën nuk e njeh shkenca e historisë. Tubimi gjatë punës së tij nuk kaloi pa mendime e kundërthënie të mëdha në mes pjesëmarrësve e diskutuesve të mbledhjes. Më në fund pas përpjekjeje të madhe dhe një polemike të ashpër u arrit kompromisi që me votim të hapur të vendoset kjo çështje. Në fund të mbledhjes u vendos që: Nëse qytetarët ku jeton i burgosuri politik kërkojnë që të bëhet anëtarë i LDK-së apo partive tjera duhet të bëhet e nuk është mirë të refuzohet nga shkaku i asaj se nga viti 1981 në një mënyrë apo në një tjetër na kanë përkrahur.

Gjithashtu u mor qëndrim se nëse ata kërkojnë që të zgjidhemi në kryesitë e partisë duhet të pranojmë po gjithmonë duke e respektuar statutin dhe votimin e anëtarit të partisë.

Është, shumë interesant se në pjesën më të madhe të rasteve është vepruar ashtu siç është marrë qëndrim në mbledhjen e mbajtur të marsit në Besianë. Gati pjesa më e

madhe e të burgosurve politik u zgjodhën në organet drejtuese të partive duke filluar nga aktivi e deri në kryesitë e partive. Në komunën e Besianës një numër i të burgosurve u zgjedhën në këto vende:

- Hamit Hamiti u zgjodh kryetar i Nëndegës së Dytë në Besianë dhe delegatë
- Xheladin Rekaliu u zgjodh kryetar i Nëndegës së Parë në Besianë
- Avdi Gjata u zgjodh kryetar i Nëndegës së Bajçinës në Besianë.
- Avdyl Mustafa u zgjodh kryetar i Nëndegës së Gllamnikut(Vendenisit).etj.

Përveç që një numër ishin zgjedhe nëpër aktive, nëndegë e degë një numër i tyre u zgjodhën edhe në organet më të larta të kryesive të partive politike të Kosovës dhe delegat të tyre që të gjithë me tërë autoritetin dhe angazhimin e tyre ndihmuan në homogjenizimin e popullit shqiptar. Ata, ishin angazhuar në të gjitha detyrat më me përgjegjësi e të rrezikshme siç ishin; organizimi i mbajtjes së procesit mësimor , organizimin e Shoqatës Nëna Terezë dhe shpërndarje e ndihmave për popullsinë shqiptare, organizimi dhe pjesëmarrja në pajtimin e gjaqeve si edhe në të gjitha detyrat dhe obligimet që dilnin gjatë asaj kohe.[219]

## Qëndrimi i Shqipërisë ndaj ngjarjeve në Kosovë 1981-1989

Fuqia dhe pjesëmarrja aq e madhe e shqiptarëve në demonstratat e viteve 1981-1990 e shqetësuan mjaft shumë Shqipërinë, Jugosllavinë, vendet e Ballkanit po edhe vetë Evropën, pasi asnjëherë nuk kishin llogaritur se shqiptarët në Jugosllavi mund të protestojnë aq fuqishëm e në këtë mënyrë. Për Shqipërinë këto ngjarje ishin tepër shqetësuese për faktin se në Jugosllavinë e asaj kohe jetonin gati gjysma e popullsisë shqiptare në Ballkan.

Prandaj me të drejtë Shqipëria ishte e shqetësuar për demonstratat e vitit 1981 dhe ndërhyrjet ushtarake e policore të Federatës Jugosllave, kundër shqiptarëve në Kosovë që kërkonin të drejtat e veta elementare, të drejta të barabarta me popujt tjerë në Jugosllavi.[220]

Për shkaqet themelore të krizës në Jugosllavi,që në këtë rast ishte Kosova, kryetari i Shqipërisë Enver Hoxha e konsideronte se ishte diskriminim i statutit të Kosovës dhe

---

[219] Procesverbal i mbledheje së 23 . 03. 1990, Besianë, Kujtime A. Gjata, H. Hamit, F. Lepaja

231 E. Çeku, vep e përm, f, 261-262.

shqiptarëve, niveli i prapambetjes ekonomike në Kosovë dhe pjesët tjera shqiptare në Jugosllavi, shkeljet e të drejtave të njeriut, të drejtave arsimore e kulturore të popullit shqiptar nga vetë Federata Jugosllave.[221]

Shkeljet e të drejtave kombëtare e njerëzore kundër shqiptarëve, ushtrimi i dhunës dhe represionit të vazhdueshëm fizik, psikik, mbi popullin shqiptar në Kosovë, duke përdorur mekanizma për shfarosjen apo pastrimin etnik të shqiptarëve që bënë Jugosllavia kundër tyre.[222]

Në ditarin e vet sekret, Enver Hoxha shkruante se faktori shqiptar në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë ka qenë faktori më i përbuzur politikisht e ekonomikisht, po ashtu kishte gjendje të rëndë në arsim e kulturë, por faktori shqiptar ka qenë më i durueshmi e më i dëgjuari, por edhe më i zgjuari dhe njëkohësisht më realist në kaosin politiko-ekonomik ku ishte zhytur Jugosllavia pas Luftës së Dytë Botërore, ishte Kosova.[223]

Shqipëria më 8 prill 1981 përmes Tiranës zyrtare dhe gazetës zyrtare të saj 'Zëri i Popullit', e shprehu qëndrimin e vet politik zyrtar për demonstratat dhe ngjarjet në Kosovë. Me këtë rast, Shqipëria zyrtare dënoi ashpër përdorimin e dhunës policore e ushtarake të Jugosllavisë kundër popullit shqiptar. Ndërsa i gjithë populli shqiptar, doli në mbrojtje të drejtave të popullit shqiptar në Kosovë, duke u solidarizuar me demonstratat dhe kërkesat e tyre për Republikën e Kosovës.[224]

Në krye të politikës shqiptare për mbrojtjen e shqiptarëve në jugosllavi i priu udhëheqësi i Republikës Popullore të Shqipërisë, Enver Hoxha[225] i cili asnjëherë nuk pranonte që Shqipëria kishte ndërhyrë e as ishte nxitëse e provokuese për çështjen e Kosovës.

Shqipëria respektonte parimet e Kombeve të Bashkuara për shtetet sovrane dhe mosndërhyrjen në punët e brendshme të shteteve të tjera, pra as në punët e brendshme të Jugosllavisë. Por mes tjerash, Enver Hoxha konsideronte se shteti shqiptar nuk mund të rrinte duarkryq dhe të pranonte heshtur kur shkeleshin, dhun oheshin e

---

[221] Dokumente sekrete të CIA-së për Kosovën, qëndrimi i Shqipërisë, për Kosovën, Koha Ditore, 21. 2. 2005, f. 8.
[222] Po aty.
[223] Lisen Bashkurti, Diplomacia e Vetëizolimit, Tiranë, 2004, f, 600.
[224] Po aty
[225] Enver Hoxha, Ditari politik për çështje ndërkombëtare 1980-1981, për përdorim të brendshëm.

maltretoheshin shqiptarët përtej kufirit shtetëror nga një shtet fqinjë, që kishte nënshkruar Deklaratën Universale të Drejtave të Njeriut.[226]

Për këtë arsye, Tirana u konsiderua nga Jugosllavia dhe u identifikua si nxitëse e trazirave në Kosovë. E vërteta nuk ishte ashtu, ngase Tirana asnjëherë nuk u përfshi drejtpërsëdrejti në Kosovë, gjatë asaj kohe, pasi që edhe gjendja ekonomike e Shqipërisë nuk ishte në pozitë të mirë. Jugosllavia ishte e vetëdijshme dhe krejt e ndërgjegjshme për rëndësinë që kishte për shqiptarët Shqipëria, qasja e saj në qëndrueshmërinë për Kosovën por edhe për vetë Jugosllavinë në tërësi.[227]

Mënyra e sjelljes së Shqipërisë gjatë viteve në vijim përbënte pengesën kryesore dhe serioze për Beogradin, pasi ajo i inkurajonte shqiptarët e Kosovës, që u jepte shpresë, guxim e vetëdijesim për të qëndruar në rrugën e tij të drejtë për liri e barazi kombëtare, theksonte Enver Hoxha.[228]

Më 17 prill 1981, politika shqiptare doli haptas dhe qartas në mbrojtje të kërkesave të demonstratave të studentëve dhe popullit shqiptar në Kosovë për Republikën e Kosovës, duke saktësuar edhe kërkesat: Kosova do të qetësohet kur të hiqet shtetrrethimi, të tërhiqet ushtria, të lirohen të burgosurit politikë, dhe djemtë e vajzat t'u kthehen familjeve të tyre.[229]

Përkrahja e shtetit shqiptar ndaj çështjes së Kosovës ishte serioze dhe në përputhje me kërkesat e shqiptarëve të Kosovës që të jenë të realizuar dhe të jenë të robëruara. Politika e Shqipërisë pas këtyre ngjarjeve duket qartë më e hapur më e interesuar për zgjidhjen e çështjes shqiptare si një problem kombëtar, duke dhënë sinjale sensibilizimi të çështjes shqiptare edhe si një problem evropian nga Jalta e deri më tani.[230]

Por të gjitha këto qëndrime, komunikata, e intervista, bazën e kanë në qëndrimin zyrtar të Shqipërisë për çështjen e Kosovës në vitin 1981, që paraqiti Enver Hoxha në Kongresin e 8 të PPSH-së, i cili duke i trajtuar gjerësisht zhvillimet politike historike të vitit 1981 në Kosovë, ai midis tjerash tha: 'Politika e Shqipërisë Socialiste ndaj Jugosllavisë ka qenë gjithherë konstante dhe e pandryshuar', por keqësimi i tanishëm i situatës në Kosovë i ka acaruar marrëdhëniet Shqiptaro-Jugosllave. Andaj për të gjitha

[226] Dokumentat e CIA-së, për Kosovësn, Enver Hoxha për Kosovën, Koha Ditore, Prishtinë, 20. 2. 2005.
[227] Vicreks Miranda, Midis Serbve dhe Shqiptarëve, Një histori e shkurtër, Tiranë, 2004, f. 252.
[228] Ethem Çeku, vep e përm, f. 274.
[229] Mehmet Hajrizi, Histori e një organizate politike 2004, f,. 221.
[230] Bedri Islami, Shqipëria dhe Demonstratat e vitit 1981 në Kosovë, Epoka e re , Prishtinë, 7 prill. 2006, f, 10

këto pasojat i mbanë Jugosllavia për shkak të veprimeve kundër shqiptarëve në Kosovë. Shqiptarët në Kosovës përbëjnë një etni, një popull të formuar me shekuj, që ka historinë, gjuhën, kulturën e vetë, të një populli autokton, të cilët i shkëputën e i copëtuan nga mëmëdheu i tyre me ndihmën e Fuqive të Mëdha.[231]

Qëndrimi zyrtar i politikës së jashtme të Shqipërisë, lidhur me gjendjen në Kosovë dhe statusin e Kosovës pati implikime të konsiderueshme të evoluimit e ndërgjegjeje politike, mbarëkombëtare, në rajonin e Ballkanit, pasi deri në këtë kohë Shqipëria qëndronte për idenë e bashkimit të trojeve shqiptare. Më në fund Enver Hoxha mbështeti opsionin për Republikën e Kosovës brenda Federatës Jugosllave.

## Shtypi shqiptar për ngjarjet e viteve 1981-1990 në Kosovë.

Ngjarjet e Kosovës, ia tërhoqën vëmendjen opinionit ndërkombëtar dhe ati të brendshëm në kuadër të Jugosllavisë i cili kërkonte rrugë dhe mundësi të reja për të kuptuar formën, përmbajtjen dhe shkakun e zhvillimeve që ndodhën në Kosovë, gjatë vitit 1981. Ngjarjet e vitit 1981 është një frymë e re politike e cila ngriti nevojën e bashkimit të organizuar politik të ilegales për çlirim e bashkim kombëtar, që u ndie menjëherë pas demonstratave.

Për të zgjeruar ndikimin atdhetar e luftarak tek shtresat e gjëra të popullit, e për të mos lejuar shuarjen e zjarrit luftarak të tyre, ishte e nevojshme thellimi dhe zgjerimi i propagandës së organizuar të shtypit ilegal atdhetar që në Kosovë vinte kryesisht nga Shqipëria.[232]

Në fillim të viteve 80-ta të shekullit të kaluar në Kosovë dhe diasporë do të kenë rol revistat ilegale që botoheshin në diasporë. Revistat më të njohura që u botuan në ato vite kanë qenë: 'Liria', 'Bashkimi', 'Lajmëtari i Lirisë'. etj.[233]

Rol të rëndësishëm, do të thosha historik për mua po edhe për një numër të madh të shqiptarëve për të zgjeruar frymën dhe politikën kombëtare e luajtën Radio Tirana,

[231] M. Hajrizi, vep e përm, f. 227.
[232] Dr. Jakup Krasniqi , Lëvizja për Republikën e Kosovës 1981-1991, f. 51
[233] S. B. Keçmezi, vep e përm, f. 66

Radio Prishtina, si dhe Televizioni Shqiptar e Televizioni i Prishtinës, gjatë viteve 70-80 që ishin vite të Rilindjes Kombëtare.[234]

Ndikimi i shtypit të shkruar nga Shqipëria ishte më i kufizuar, megjithatë edhe një numër bukur i mirë i shqiptarëve gjatë këtyre viteve 1970-80, kishin mundësinë e parapagimit të gazetave nga Shqipëria të cilat vinin në Kosovë me rrugë legale, siç ishte Zëri i Popullit, Punëtori, Shqipëria e Re, Bashkimi etj, të cilat i shpërndanim nga njeri tek tjetri. që ndikuan shumë në krijimin e idesë për bashkimin e të gjithë shqiptarëve në një shtet.[235]

Ngritja intelektuale gjatë këtyre viteve në Kosovë e në diasporë, krijoj mundësinë e nxjerrjes dhe e botimit të revistave ilegale që botoheshin kryesisht jashtë vendit, por që arrinin të shpërndaheshin edhe në Kosovë, ndonëse në një numër më të kufizuar. Revistat më të njohura që u botuan në këto vite kanë qen: 'Liria', 'Bashkimi', 'Lajmëtari i Lirisë' etj.[236]

Përveç gazetave, edhe traktet ishin formë e komunikimit me qytetarët dhe krijimin e ndjenjës kombëtare. Këto gazeta i kishin dhënë vetës detyrë që të bëheshin armë e fuqishme e të drejtave të shqiptarëve për liri, për çlirim e bashkim kombëtar. Revistën ilegale, armiqësore anti-jugosllave 'Lajmëtari i lirisë' e udhëheq Jusuf Gërvalla që ishte organ i (LNÇK) ndërsa Ibrahim Kelmendi revistën 'Bashkimi' që ishte organ i 'Frontit të kuq popullor.'

Gazeta 'Liria' shkruante: 'Liri thërret sot Kosova e robëruar, Kosova e shumëvuajtur e martire, Kosova trime. Bijtë e Kosovës, luftuan në shekuj për liri, kundër armiqve të shumtë e të egër që lakmonin fushat tona të gjëra, malet tona të bukura, e pasuritë e shumta që ka toka jonë...[237]

Ndërsa 'Lajmëtari i lirisë' do të shkruajë:'Përzënia e shqiptarëve nga trojet e veta, zhdukja e tyre fizike, kolonizimi i trojeve shqiptare me element sllavë nuk ndihmuan në realizimin e qëllimeve të ulëta, të shovinistëve në zhdukjen e popullit shqiptar, sepse populli ynë është i mishëruar me vendin e vet.[238]

Gazeta ilegale 'Liria' organ informativ i organizatë ilegale 'OMLK'-së edhe pas demonstratave studentore të vitit 1981 vazhdonte rrugëtimin e saj me plot sfida e

[234] Avdi Gjata, mendim personal.
[235] Kujtime.
[236] J. Krasniqi, vep e përm, f.39
[237] Po aty, f, 52.
[238] Vep e përm, f. 54.

suksese edhe pas demonstratave të vitit 1981. Të gjitha gazetave e revistave ilegale që botoheshin në këtë kohë demonstratat ia rritën besueshmërinë përpara opinionit të brendshëm dhe të jashtëm, pasi ato kishin mbështetje reale për tematikën që ato merreshin. Dhe kryesisht ato iu kushtonin ngjarjeve që tronditën jo vetëm Jugosllavinë po edhe tërë rajonin. Në temën 'Përpara drejtë fitores' autori shkruante se: Forcat ushtarake policore fashiste të borgjezisë serbe mbuluan sërish me zjarr e hekur Kosovën tonë të shtrenjtë... Ata nuk u mjaftuan me gjakun e bijve dhe bijave tona më të mirë që lau rrugët e Kosovës në masakrën e përgjakshme të marsit dhe prillit, por mbushën edhe burgjet e tyre famëkeqe me mijëra petrita e sokolesha shqiptare në Kosovë dhe Jugosllavi.[239] , pastaj autori vazhdon: 'Popull shqiptar , ne bijtë e tu besnik deri në vdekje bëjmë thirrje që për të drejtat tona të ligjshme, lufta kundër masave të egra shoviniste antishqiptare të organizohet me guxim e heroizëm .... Rruga e rezistencës e luftës së vendosur, është rrugë e vetme e fitores, rrugë e vetme e realizimit të drejtave tona....Dëshmorët tanë të lavdishëm, dhanë jetën në demonstrata duke thirrur: 'Rroftë populli shqiptar,' 'Rroftë Republika,' 'Rroftë liria,' 'Përpara drejtë fitores' etj. [240]

Ndërsa, nëpër traktet të cilat ishin një formë tjetër e shtypit ilegal gjatë viteve 1970-80, shkruhej: 'është detyrë e çdo shqiptari të ndershëm që të luftojë me guxim kundër sunduesve revizionist. Punëtorë, fshatarë, rini revolucionare e Kosovës, popull punonjës mos duro shtypjen e egër revizioniste, organizohu, në greva, ashtu si punëtorët trima të 'Ramiz Sadikut' në prag të Majit, organizohuni, në bojkotime në demonstrata: në luftë e çdo ditë atje ku ndodheni etj.[241]

Në vitin 1974, pati një dyzenë ngjarjesh politike si në drejtimin legal ashtu edhe në at ilegal. Gjatë këtij viti filloi të dalë revista ilegale e organizatës 'Grupi Revolucionar' me emrin 'Zëri i Kosovës,' që ishte organ informativ i saj[242], i cili doli vetëm me dy numra.

Në shkrimin me titull me 1 maj 1993 ZIK shkruante se, kombi shqiptar aktualisht gjendet në fazën më të rëndë të kohës së tij, përveç që ra nën okupimin më të rëndë ai sërish u rinda midis shteteve të Ballkanit të dala nga ish-Jugosllavia. Partitë politike

[239] Përpara drejtë fitores ;' revista 'Liria;' nr. 4-5 1981, f, 1.
[240] Po aty, f, 2.
[241] GMLK:'Trakt', 13. 06.1978.
[242] Metush Zenuni, 'Lëvizja Popullore e Kosovës dhe roli i saj në formimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Punim diplome për Master), Prishtinë. 2009. f, 79.

shqiptare në vend marrin qëndrim të drejtë lidhur me UÇK-në dhe të ndryshojnë mënyrën e veprimit të tyre me format pacifiste, ato ende po vazhdojnë me fjalor të njëjtë si at të pushtuesit.[243]

Ndërsa në shkrimin tjetër: ‘ Mbrojtja e Kosovës është e drejtë e pacenueshme e patjetërsueshme dhe obligim e nder i madh i çdo qytetari’[244], që publikohet deklarata e LPK-së, që i jepte përkrahje UÇK-së.

‘Zëri i Kosovës’, ishte gazeta u LPK-së që me shkrimet e veta të ndryshme argumentonte se rezistenca dhe lufta e popullit shqiptar në Kosovë është e drejtë ngado që të shikohet, si nga e drejta natyrore për të jetuar i lirë çdo qytetar, si nga pikëpamja e të drejtave të njeriut, po edhe nga pikëpamja kushtetuese e Kushtetutës së Republikës së Kosovës si edhe nga Konventa Ndërkombëtare.

Të gjitha veprimet konkrete që i merrte Lëvizja Ilegale Kombëtare dhe më vonë UÇK-ja, kundër pushtetit serb në Kosovë dhe të gjitha komunikatat për shtyp që i lëshonte ajo e që nuk i botonte shtypi shqiptar në Kosovë, ose i shtrembëronte, ‘Zëri i Kosovës’ i botonte ato me qëllim të njoftimit të opinionit me luftën e drejtë të popullit tonë.

‘Zëri i Kosovës’ arriti të bëhet zëri i shqiptarëve në mbarë viset shqiptare të sunduara nga pushtuesit sllav, zëri i studentëve, i shqiptarëve jashtë atdheut, por edhe zëri i luftëtarëve të UÇK-së dhe i aksioneve të tyre ushtarake.’ Zëri i Kosovës’ mbrojti drejtësinë, realitetin, të burgosurit, patriotët, ata që për atdheun, rrezikuan jetën e tyre duke e internacionalizuar kërkesën e drejtë të shqiptarëve.[245]

Në këtë drejtim vend të rëndësishëm luante gazeta ‘Zëri i popullit’ organ i Partisë së Punës së Shqipërisë. Lufta e popullit të Kosovës për të drejtat e tyre kundër atyre që e shfrytëzojnë dhe e shtypin është e drejtë, që meriton përkrahjen e popujve të Evropës dhe të mbarë botës...’[246] Në faqet e ‘Zërit të popullit ‘ mbështeteshin kërkesat e Kosovës si më të domosdoshme të kohës.

Me titull ‘Kosovës po i vriten djemtë nga serbomëdhenjtë ‘lajmëronte ‘Zëri i popullit’. Sipas agjencisë së lajmeve gjermano-perëndimore në afërsi të qytetit

---

[243] Mbledhja konsultative e LPRK-së, Prill 1993, gazeta javore,’Zëri i Kosovës’ organ i LPK-së, nr.6.1 maj 1993.
[244] Gazeta javore,’Zëri i Kosovës’ nr. 18, 1 maj 1996.
[245] Fazli Veliu, UÇK-LPK, f 54-55.
[246] Gazeta ‘Zëri i popullit ‘, Tiranë, dt. 13 qershor 1981.

Shtutgard në Gjermaninë perëndimore 'të dielën më 17 janar 1982 natën vonë u vranë kosovarët Bardhosh Gërvalla, Jusuf Gërvalla e Kadri Zeka[247].

Në artikullin e 16 shtatorit 1990, 'Zëri i popullit' shkruan: Terrorizimi serb pasohet me akte vrasëse, arrestime e tortura, njoftohet nga Prishtina më 13 shtator 1990 se 'njësi të policisë serbe rrethuan fshatrat Pollatë, Repë dhe Metohia nën pretekstin e kërkimit të armëve dhe hapën zjarr kundër banorëve të tyre. Dy të rinj shqiptar bënë të ditur agjencia Rojter u vranë nga armët e policisë, Skender Hamit Monolli dhe Besim Hashim Latifi, plotësim i imi, ndërsa 30 veta u arrestuan...[248]

Me titull; 'Kronika e terrorizmit policor gjatë dhjetë vjetëve' fatkeqësisht për shqiptarët është tepër e pasur. Komiteti i Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut në Kosovë publikoi listat e të vrarëve dhe të plagosurve sipas të cilit janë 34 të vrarë dhe 204 të plagosur.[249]

Se në Kosovë e në Serbi, kur është fjala për shqiptarët, që moti funksionon shteti policor, për këtë kanë pasur rastin të binden më shumë se 600.000 shqiptarë, të cilët duke filluar nga viti 1981 e deri më sot u përpunuan në mënyra të ndryshme policore. Mirëpo, shteti policor, kur është fjala për shqiptarët funksionon për mrekulli edhe në nivel të federatës jugosllave, për këtë shqiptarët e Kosovës u bindën e po binden për çdo ditë[250]. Dhe me shumë të drejtë ngrihet zëri: ' Turpërohu Jugosllavi', Por, s'ka turp atje kur turpi është pjesë e vetë sistemit të qeverisjes serbe dhe jugosllave, apo të qeverisjes jugosllave nën qeverisjen serbe.

Në 'Rilindjen' e 3 prillit 1981 është botuar deklarata e Xhavit Nimanit, kryetar i KSA të Kosovës, për ngjarjet e Marsit e të 1e 2 prillit 1981, ku thuhet: 'Në krahinën tonë këto ditë jemi ballafaquar me vështirësi të mëdha të cilat janë pasojë e sulmeve të forcave të brendshme dhe e veprimtarisë së forcave të jashtme armiqësore që janë të organizuara të veprojnë ndaj Kosovës dhe në Kosovë. Në demonstratat me karakter armiqësor nga pozita nacionaliste shqiptare, me 11 e 26 mars si edhe me 1 e 2 prill të vitit 1981 sot këto forca janë të përqendruara për aktivitet e veprimtari armiqësore kryesisht në Prishtinë e qytete të tjera.[251] Ky udhëheqës i lartë jugosllavë i shqiptarëve të Kosovës e pranonte se demonstratat ishin të organizuara nga armiku i brendshëm

[247] Gazeta , 'Zëri i popullit',Tiranë, dt. 20 janar 1982.
[248] Gazeta 'Zëri i Popullit',Tiranë, datë 16 shtator 1990, f, 4 .
[249] 'Altenativa', nr. ¾, Lubjanë, mars –prill 1990, f, 164-166.
[250] Po aty, Jusuf Ferizi , Turpërohu Jugosllavi, f. 130.
[251] 'Rilindja' 03. 4. 1981. Prishtinë.

dhe i jashtëm kundër vetëqeverisjes jugosllave. Jo pse ndoshta ai kishte dëshirë, po kështu i kishte thënë .nëna parti.

Në të njëjtën ditë në 'Rilindje 'ishte botuar Komunikata për media e dalë nga mbledhja e përbashkët e Kryesisë së KQ të LK të Serbisë ku thuhej:'Dy kryesitë konstatuan se fjala është për aktivitet të organizuar armiqësor të drejtuar kundër sistemit kushtetues të bashkësisë sonë socialiste vetëqeverisëse . Qëllimi i këtij aktiviteti është de stabilizimi i KSA të Kosovës, i RS të Serbisë dhe i RSFJ-së. Aksionet e këtyre grupeve kishin për qëllim minimin e vëllazërim-bashkimit të kombësive në Kosovë dhe përmbysjen e sistemit politik të vetëqeverisjes socialiste[252].

Me përvetësimin e tezës së 'kundërrevolucionit' nga Azem Vllasi në vitin 1981 me të drejtë thotë Viktor Meieri, serbët kishin fituar kartën e fuqishme që nuk ngurronin ta hidhnin në lojë me t'u dhënë rasti, që pushteti serb rrallëherë e lejonte rastin t'i dilte nga dora[253].

Pas 36 viteve të Jugosllavisë socialiste në vendin e 'popujve të barabartë,' po vendosej për herë të dytë të shpallej gjendja e jashtëzakonshme në Kosovë thuhej në gazetën 'Rilindja' të 3 prillit 1981 me vendimin e Sekretarit Krahinor të Punëve të Brendshme të Kosovës.[254]

Në fjalën e tij Mahmut Bakalli luftën e popullit e të rinisë shqiptare e vlerëson si luftë të klasave dhe bënë thirrje për diferencim në Lidhjen e Komunistëve, diferencim që u shtri në të gjitha nivelet dhe vazhdoi deri në shkatërrimin e LKJ-së.[255] Nuk vonoi shumë kohë edhe ish-udhëheqësi komunist i Kosovës, Mahmut Bakalli u bë pjesë e diferencimit të mësimit të vet.[256]

Në vlerësimin e ngjarjeve edhe më larg shkoi Dushan Ristiqi i cili në mbledhjen e XVI të Komitetit Krahinor të LK të Kosovës thotë: 'Elementët kundërrevolucionar, përpiqen t'i mashtrojnë masat me disa parulla politike, ekonomike e sociale, por secili sot e ka të qartë se qëllimi i tyre i vërtetë është separatist, pra ndryshimi i kufijve në këtë pjesë të Ballkanit, e kjo do të thotë konflikt i ri i kombeve e kombësive të kësaj

---

[252] Po aty.
[253] Viktor Majer, vep. e cit. f. 114.
[254] 'Rilindja', 3 prill. 1981.
[255] N. Malcolm, vep, e cit. f, 350.
[256] Po aty.

pjese të Ballkanit dhe derdhje  e gjakut, e që  kjo do të thotë; humbje e lirisë dhe e pavarësisë.[257]

Fjala e Fadil Hoxhës para  aktivit politik të Prishtinës më 4 prill tha: Dëshiroj të them menjëherë se një varg ngjarjesh që ndodhën ditëve të fundit në Prishtinë dhe në disa vende të tjera të Kosovës, janë vepër e kurdisur mjeshtërisht me karakter armiqësor. Kjo është vepër e kontrarevolucionit.  Demonstratat e studentëve dhe e disa ekseseve të tjera ishin vetëm pretekst për veprimin e organizuar të armiqve të hapët të Jugosllavisë vetëqeverisëse, socialiste e të pa inkuadruar.[258]

Frika dhe lakmia i kishte bërë ata, jo vetëm Fadil Hoxhën, por të gjithë udhëheqjen e Kosovës, të kishin e të mbanin qëndrim qyqar e kapitullues dhe antishqiptar, sepse e mbrojtën interesin e armikut shekullor të kombit, kurse të drejtat legjitime të popullit i vlerësuan 'nacionaliste', 'irredentiste', 'armiqësore', e 'kundërrevolucionare', ndërkaq rininë shqiptare e quajtën rini 'rrugaçe', 'reaksionare', e hiq më pak se edhe 'plehu i Kosovës'[259], pasi që iu kishte hyrë frika në palcë të kurrizit.

Edhe pse politika në Kosovë mburrej me arsimin si proces në raste të veçanta pranonin se ende kishin probleme me analfabetizmin. Në numrin vijues të 'Zërit të rinisë' që kishin  datën e 7 e  14 marsit 1981, në përmbajtjen e tyre, kryesisht merreshin me  problemet e Organizatës së Rinisë Socialiste në krye me Isa Musafës, e nuk kishin asnjë fjalë për demonstratat e studentëve dhe rinisë së Kosovës e cila për çdo ditë burgosej, diferencohej, dënohej përjashtohej nga procesi mësimor[260].

Në Mbledhjen e XX e KQ të LK të Jugosllavisë Ali Shukriu deklaron se:  Ngjarjet në Kosovë treguan se sa i dëmshëm është oportunizmi ndaj nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar. Udhëheqja e Shqipërisë, nëpërmjet 'Zërit të popullit' është vu haptas në mbrojtjen e nxitjen e aksioneve 'armiqësore' të drejtuara në shkatërrimin e rendit kushtetues të RSFJ-së, nëpërmjet kultivimit të urrejtjes shoviniste ndaj popullit serb por edhe ndaj kombësive të tjera në Kosovë, në Serbi e Jugosllavi.[261]

Gazetat e revistat e Kosovës do të jenë të mbushura me lajme e komente të nënshkruara në masë të madhe me firmën e agjencisë jugosllave të 'Tanjugut'. Ky është argumenti më real që vërteton se udhëheqësit e mediave ishin nënshtruar nga

[257] 'Zëri i rinisë' më 18. 4. 1981., Prishtinë.
[258] 'Rilindja' më 4 prill, 1981, .f, 1.
[259] 'Liria' maj 1981.
[260] 'Zëri i rinisë', 07.3. 1981. Prishtinë.
[261] 'Rilindja', më 08.5. 1981, Prishtinë.

sistemi i regjimit jugosllav. Ky nënshtrim deri në poshtërim kombëtarë nuk ishte vetëm ndaj mediave po ai vlente edhe për politikën e dështuar të udhëheqësve të Kosovës të cilët e kishin marrë vetëm rolin e përkthyesit nga gjuha serb në gjuhën shqipe.

## Shtypi i huaj për ngjarjet në Kosovë 1981-1990

Përveç shtypit legal dhe ilegal shqiptar, interesim të veçantë për ngjarjet në Kosovë ka treguar edhe shtypi i disa shteteve Evropiane, diku më shumë e diku më pak. Mirëpo ka edhe vende që kryesisht e kanë komentuar shtypin Jugosllav e Tanjugun. Ngjarjeve të Kosovës vend të merituar i jep shtypi gjermano-perëndimore, prandaj po e fillojmë me gazetën 'Frankfurter Algemainine Cajtung' të datës 27 prill 1981 shkruan: 'Ndërmjet datës 1 e 4 prill nuk mbeti asnjë zonë e krahinës pa bërë në forma të ndryshme demonstrata dhe greva . Vrojtues të informuar jugosllavë numrin e të vrarëve e çmojnë mbi 30-40 vetë dhe të plagosurve deri në 1000 veta....'[262]

Gazeta daneze 'Socialistisk dagblad', në shkrimin e 29 prillit 1981, me titull 'Lufta në Kosovë synon shpalljen e Republikës', shkruan: 'Demonstratat janë rezultat i përpjekjeve shoviniste të organeve zyrtare jugosllave dhe të serbëve për të ushtruar kontrollin dhe forcën e tyre në këtë krahinë'[263]

Gazeta franceze 'Liberasion' shkruan se qysh prej majit 1981 më shumë se 800 veta janë deklaruar fajtorë për aktet kriminale, nga të cilët 400 kanë marrë dënime që arrijnë deri 15 vjet burg dhe 1.300 të tjerë kanë marrë dënime që janë në kompetencën e policisë, pra më pak sesa një vit.[264]

Gazeta 'Kleine Zeitung nga Korushka të Austrisë shkruan se gjatë trazirave studentore të muajit mars të vitit 1981, në provincën jugore të Jugosllavisë në Kosovë, gjatë manifestimeve të demonstratave të studentëve shqiptarë, u lënduan gjithsejtë 23 demonstrues, ndërsa nga ana e forcave të sigurisë janë lënduar 12 policë.[265] Më tej vazhdon artikulli:'Demonstruesit shqiptar kërkuan lirinë e shtypit' si dhe krijimin e 'Republikës së Kosovës'.

---

[262] Dr, Jakup Krasniqi, Lëvizja për republikën e Kosovës, Prishtinë, 2010, f, 82.
[263] Broshurë, Shtypi botëror rreth ngjarjeve në Kosovë, f, 92.
[264] Shaban Braha, Gjenocidi serbomadh dhe Qëndresa shqiptare (1844-1990) 1991, f. 526.
[265] Eqrem Zenelaj, Vjena zyrtare kishte përcjellë nga afër ngjarjet e vitit 1981, Epoka e re, 11 mars 2011.

Artikulli i shkruar nga Gustav Chalupa në Gazetën 'Klein Zeitung' me 7 prill 1981, që i shkruan dy artikuj në të njëjtën ditë, 10 demonstrues të vdekur, student student, dy pjesëtarë të policisë dhe 57 të lënduar rëndë janë në spital dhe 22 të arrestuar që e deklaron anëtari i LKJ-së Stane Dollanc në 'Sava Centar' në Beograd. Në një pyetje nga gazetari austriak , Dollanc përgjigjet me këto fjalë: A dëshironi ju që t'i keni dy Koreja në Ballkan? A dëshironi që t'i Keni në Ballkan dy Gjermani[266]?

Ndërsa gazeta 'Noje Cyrher Cajtung' jep njoftim të saktë për zhvillimin e ngjarjeve në hapësirën shqiptare në Jugosllavi. E cila konstaton: 'Pakënaqësia e shqiptarëve në Kosovë nuk shprehet vetëm nga grupet më militante shqiptare, të cilat kërkojnë një republikë shqiptare në Kosovë, por ajo shtrihet edhe te 300 mijë shqiptarët në Maqedoni, e 50 mijë të tjerë në Mal të Zi'.[267]

Është mjaft interesant konstatimi i gazetës greke.'To Vima'' e cila shkruan: 'Nuk duhet ta pakësojmë rëndësinë e ngjarjeve që po ndodhin prej shumë javësh në rajonin e autonom të Kosovës në kufi me Shqipërinë, edhe në qoftë se kriza mbytet. Fakt është se autoritetet jugosllave nuk i kursejnë mjetet mbytëse. Këto telashe përbëjnë paralajmërim seriozë'

Edhe gazeta amerikane 'Nju-Jork Tajms' e 27 prillit, pasi thotë se situata me sa duket mbetet e pa stabilizuar, meqë përforcimet e ushtrisë dhe të policisë ndodhen akoma në Kosovë dhe tubimet politike janë të ndaluara, shtron pyetjen:Çfarë ndryshimi do të sillte edhe një republikë më shumë? Pse Kosova të mos jetë republikë, kur 85 për qind të banorëve të saj (1.5 milion) janë shqiptarë etnik.[268]

Nga ana e saj, gazeta italiane 'Koriere dela sera' duke folur për shkaqet e ngjarjeve në Kosovë, Krahinën e cilëson si rajonin më të prapambetur në Jugosllavi[269]

Kërkesa e ligjshme dhe kushtetuese, e Kosovës-Republikë po kundërshtohej dhe po vritej dita-ditës. Gazeta jugosllave 'Veçernje Novosti' e 14 janarit 1984 njoftonte se më 11 janar 1984, në orën 22.oo u rrethuan dy irredentist, Rexhep Mala dhe Nuhi Berisha . Forcat ushtarake-policore urdhëruan që me mjete policore e të blinduara të kapeshin të gjallë, pse kështu ia donte interesi i tyre i veçant.[270]

---

[266] Po aty.
[267] Gazeta zvicerane 'Noje Czrher Cajtung', 25. 04. 1981.
[268] Marrë nga gazeta 'Liria', nr 3. maj. 1981.
[269] Po aty.
[270] 'Veçernje Novosti', 14 janar 1984.

Vala e akuzave dhe e terrorizmit përfshiu edhe trevën shqiptare të Medvegjës. Preshevës, dhe Bujanocit deri në Vranjë. Vetëm në këto tri rrethe, në vitin e kaluar (1983) akuzohen shqiptarët për 575 krime dhe dy herë më shumë për shkelje të tjera ligjore. Kryesore është akuza: 'Kërkojmë bashkimin e të gjitha viseve shqiptare në Jugosllavi dhe u bëjmë thirrje të gjithë shqiptarëve për bojkotim të gjitha masave të organeve shtetërore të angazhuara kundër kësaj veprimtarie armiqësore.[271]

Interesimi për ngjarjet në Kosovë nuk i shpëtoi as gazetës prestigjioze angleze 'The Times', e cila më 20 maj 1981 shkruan:Trupat dhe policia u tundën në Kosovë nga të gjitha anët e vendit për të treguar shqetësimin e gjithë Jugosllavisë për çka po ndodhte atje. Por autoritetet po gjejnë atje akoma një rezistencë të madhe . Të dhënat zyrtare flasin për disa qindra të arrestuar dhe për më shumë se 100 veta që presin të dalin përpara gjyqit për akuza të rënda, por numri i tyre rritet çdo ditë, ashtu si dhe numri i të përjashtuarve mga shkollat dhe universiteti.....[272]. Më 20 maj 1981, 'Di Prese' e Austrisë shkruante:Po shikohet me preokupim të madh fakti që gjendja në Kosovë nuk është qetësuar, me gjithë ndërhyrjen e forcave nga e tërë Jugosllavia. Kompleksiteti i problemeve me të cilat është lidhur kjo ngjarje e vë udhëheqjen jugosllave para detyrave jashtëzakonisht të vështirë.[273]

Borba shkruan: Fadil Hoxha, anëtar në presidiumin e Shtetit e të Partisë, edhe vet shqiptar, i cili në fund të prillit kishte damkosur me turp nacionalizmin shqiptaro madh të rretheve të gjëra në Tiranë, më 23 maj vazhdoi një fushatë shtypi kundër shqiptarëve të Kosovës dhe të Shqipërisë.[274]

Në Konferencën e partisë të LK të Kosovës , më 5 gusht 1981 u vendos që të përjashtohet M. Bakalli, dhe t'i jepej një vërejtje e fundit me përjashtim nga partia.[275] Gjatë zhvillimit të mëtejshëm të 'diferencimit ideologjik-politik', deri në fillimin e gushtit 1981 qenë përjashtuar nga LK të Jugosllavisë ,534 anëtarë.[276] .

## Vlerësimi i demonstratave të vitit 1981-90 nga diplomat të huaj.

[271] Po aty, f, 527.
[272] Vep e përm, f, 83.
[273] Po aty.
[274] 'Borba', 28. 04. 1981.
[275] 'Politika', 06, 08, 1981.
[276] Po aty.

Përveç, shtypit të brendshëm e atë të jashtëm me demonstratat shqiptare të vitit 1981 me analiza e komentet e tyre u morën edhe diplomat të huaj mbi raportet e qëndrimin e 'Zërit të Popullit' Organ i Partisë së Punës së Shqipërisë.

Zëvendësdrejtori i Agjencisë së lajmeve suedeze, Kaje Hellen, për artikullin e 'Zërit të Popullit' kishte thënë se është një analizë e mirë e zhvillimit të ngjarjeve që ndodhën në Kosovë. Ai tha se ky artikull vlen edhe për pakicat kombëtare, të cilave u mohohen të drejtat e diskriminohen në shumë vende të botës.[277]

Diplomati bullgar Nikolla Nikollov i ngarkuari me punë në i Ambasadës bullgare thotë:Në artikullin e gazetës 'Zëri i Popullit' të datës 17.05, 1981, jep ultimatum se Kosova të bëhet republikë, por kjo nuk do të bëhet kurrë, pasi këtë nuk do ta lejon kurrë qeveria jugosllave.[278]

Zigfrid Balon, i ngarkuari me punë i Ambasadës gjermane, artikujt e' Zërit të Popullit', janë të drejtë, u botuan në kohë dhe në momentin e duhur. Kjo situatë do t'i acarojë marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave e mund të jetë për pasoja për të dy shtetet.[279]

Ndërsa Ana Marie Autissien, atashe në Ambasadën franceze 'Artikujt e gazetës 'Zëri i Popullit' janë bërë shkak që jugosllavët të mendojnë se për turbullirat në Kosovë ka dorë Shqipëria Është e drejta e Shqipërisë që të mbrojë kombësinë shqiptare në jugosllavi, por shteti jugosllavë ka të drejtë të marrë masa dhe të mos lejojë krijimin e republikës së Kosovës.[280]

Ambasadori i Guinesë në Dar Es Salam për artikullin e 'Zërit të Popullit', të prillit kishte thënë se e konsideronte të drejtë qëndrimin e Shqipërisë ...çdo vend ka të drejtë të mbrojë vëllezërit e vet që banojnë në një vend tjetër. Kjo nuk mund të quhet ndërhyrje në punët e brendshme. Kështu artikujt ngjallën interes të madh në kancelaritë e ndryshme botërore.[281]

Është për t'u theksuar se, artikulli i 'Zërit të Popullit', i datës 5 qershor 1981 me titull 'Ngjarjet e Kosovës dhe bashkëpunimi i fshehtë sovjet-serbomadh' tërhoqi vëmendjen e kancelarive të vendeve Perëndimore , që anglezët kishin paraqitur interes

[277] Mr. Sabit Syla, Fejton, ' Zëri', Prishtinë, 21. mars, 2011.
[278] Po aty.
[279] Po aty.
[280] Po aty.
[281] Po aty.

të njohur për Tiranën mbi ngjarjet në Kosovë, sidomos lidhur me komplotin sovjeto-serbomadh, duke aprovuar edhe vlerësimet e shtetit shqiptar.[282]

Në mënyrë të ngjashme komentojnë edhe gazeta të tjera të botës., të cilat shprehin mosbesim ndaj të gjitha informatave që japin qarqet zyrtare jugosllave dhe dënojnë dhunën e terrorin e pashoq të titistëve në Kosovë.

Pra e ardhmja e Kosovës nën Jugosllavi mbas ngjarjeve të vitit 1981 shihej si një fenomen i përkohshëm dhe jo afat gjatë nga diplomacia shqiptare dhe ajo evropiane. Me kalimin e kohës gazetat më në zë të ShBA-ve të tilla si 'New York Times', Washington Post' 'Times Herald', 'Word', New York Postetj, botuan mjaft artikuj me vështrim realist dhe simpatizues për shqiptarët dhe kërkesën e tyre 'Kosova Republikë'.[283]

Në shkrimet e tyre gazetarët amerikan e pranonin si të ligjshme kërkesën e shqiptarëve 'Kosova Republikë'; se shqiptarët zinin 85% të popullsisë në Kosovë; se qeveria jugosllave po ndërmerr masa shtypëse dhe terrori ndaj shqiptarëve, se shqiptarët në Jugosllavi kishin statusin e qytetarit të dorës së dytë, etj.[284]

Kjo politikë po e ndërkombëtarizonte çështjen shqiptare dhe po i njoftonte amerikanët e thjeshtë me një realitet ndryshe sa i përket shqiptarëve në përgjithësi. Çështja e Kosovës u bë problem ndërkombëtarë. Ajo tronditi Jugosllavinë dhe pati rrjedhime edhe në republikat tjera të saj, në grindjet në mes tyre. Duhet të theksojmë se ngjarjet që ndodhën në vitin 1981 dhe që u organizuan nga forcat patriotike, ushtruan ndikim rrënjësor në politikën e shtetit shqiptar ndaj Kosovës. Forcat e armatosura të dyja vendeve shpesh herë ishin vënë në gjendje gatishmërie, dhe deklaroheshin se në rast krize të luftës në Kosovë, forcat ushtarake do të hynë në Kosovë.[285]

Përveç vlerësimeve e komenteve pozitive kuptohet që artikujt janë vlerësuar edhe me tone tejet negative qoftë nga shtypi e komentet e diplomatëve të shteteve tjera. Një qëndrim jo realist ka luajtur edhe angazhimi i emisarëve të Beogradit të cilët janë përpjekur në të gjitha mënyrat që t'i shtrembërojnë qëndrimet e Tiranës zyrtare dhe faktet e vërteta të ngjarjeve ë Kosovë. Shtypi i disa vendeve qëndrimin e Shqipërisë e

---

[282] Po aty.
[283] Mr. Ethem Çeku, Kosova në Sfondin e Diplomacisë së Jugosllavisë dhe të Shqipërisë, (1945-1981), Prishtinë. 2008, f, 287.
[284] Po aty.
[285] Po aty, f, 291.

shikonin nga këndvështrimi jugosllav e madje disa vende edhe nuk shkruanin fare për ngjarjet e Kosovës në Jugosllavi. Kështu vietnamezët për ngjarjet e Kosovës nuk kishin shkruar asgjë. As, shtypi Hungarez nuk dha asnjë njoftim për artikujt e 'Zërit të Popullit.' Ata i dhanë vend dhe hapësirë të veçantë përgjigjeve jugosllave ndaj tyre. Ndaj shkrimeve të 'Zërit të Popullit' nuk shkruanin kryesisht shtypi i atyre vendeve të cilat kishin probleme me çështjen e pazgjedhur nacionale në vendet e tyre. Me sa del nga bisedat me zyrtar, kontaktet me funksionar e diplomat botërorë e evropian si dhe komentet e shtypit dhe televizionit dalin në pah edhe qëndrimet e shtetit shqiptar të shprehura në 'Zërin e Popullit', lidhur me ngjarjet në Kosovë siç janë:a). Shqipëria ka dënuar dhunën kundër pjesëmarrësve të demonstratave dhe shkeljen e të drejtave të popullit shqiptarë. Çështja e Kosovës është çështje e vet shqiptarëve të Kosovës,dhe Shqipëria i konsideron të padrejta vendimet e Fuqive të Mëdha në të kaluarën, në bazë të cilave Kosova iu dha Serbisë. c). Tito nuk e mbajti premtimin e dhënë për zgjidhjen e problemit të Kosovës pas luftës. ç). Shqipëria gjithashtu deklarohej si në kohën kur ishte gjallë Tito, ashtu edhe tani deklaron se ajo do t'i vij në ndihmë popujve të Jugosllavisë në rast të ndonjë agresioni sovjetik kundër saj. Në këtë situatë të zhvillimeve të ngjarjeve që kishin filluar të keqësoheshin rrethanat politike dhe ekonomike në të gjitha shtetet komuniste për shkak të ngecjes ekonomike dhe moszgjidhjeve të problemeve nacionale, Shqipëria kishte arritur që ta demaskoi shovinizmin serb e sistemin e dobësuar titist. Në të njëjtën kohë e rritën prestigjin e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare dhe krijuan kushte për një zhvillim të mëtejshëm të marrëdhënieve me vendet e ndryshme perëndimore.

## P ë r f u n d i m i

Pas përfundimit të Luftës së dytë Botërore, shqiptarët Kosovës jo vetëm që u penguan për t'u bashkuar me Shqipërinë, ashtu siç ishin deklaruar në Konferencën e Bujanit, por ndodhi krejt e kundërta, ata u ripushtuan dhe u ndanë në katër njësi të Federatës Jugosllave, në atë të Kosovës, të Maqedonisë, të Serbisë dhe të Malit të Zi.

Organizatat ilegale në Kosovës kanë një histori të gjatë e të kahershme qysh nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit e deri më sot. Pas demonstratës së marsit të përgjakur të

vitit 1981 filloi një dekadë e egër për popullin, filloi një kohë e tentimit për zhdukjen biologjike të shqiptarëve me forma dhe mënyrat më të sofistikuara të mundshme. Me plot të drejtë mund të themi se demonstratat e vitit 1981 për herë të parë e ndërkombëtarizuan çështjen shqiptare para opinionit ndërkombëtar.

Pas ngjarjeve të vitit 1981 të pakënaqur me rrjedhën e ngjarjeve organizatat dhe atdhetare mëhershëm u aktivizuan përsëri në veprimtarinë ilegale. Ndërsa në të gjitha trojet e ish-Jugosllavisë, u formuan organizata dhe grupe të reja ilegale që vepronin kundër shtypjes shekullore okupuese të pushtetit.

Pra, me të drejtë mund të themi se demonstratat kishin karakter të vërtetë kombëtarë dhe kanë pasur për qëllim në rend të parë bashkimin kombëtarë me Shqipërinë, por duke i parë rrethanat që ishin krijuar, kërkesa historikisht e përcjellë brez pas brezi kaloi në kërkesën Republikë që është një kërkesë 'joadekuate' për shqiptarët.

Është e ditur se vetëm dy ditë pas demonstratës së 26 marsit të vitit 1981, me 28 mars, kompetencat e Sekretariatit të punëve të brendshme të Kosovës ia marrin Federata dhe Serbia dëshmi e asaj se, Kosova nuk ka qenë njësi e barabartë me republikat tjera. Nga kjo kohë e deri më 1990 çdo i treti shqiptar kaloi nëpër duart e policisë që do të thotë se ishin mbi 70o mijë veta.

Sa i përket vlerësimit se të gjitha organizatat dhe grupet ilegale që vepruan në Kosovë, kanë pasur orientim marksist-leninist, duhet të kihet parasysh rrethanat e kohës si edhe fakti se ne nuk kemi vepruar për ndryshimin e sistemit shoqëror por për krijimin e Republikës së Kosovës e për Bashkim Kombëtar. Lirisht mund të them se edhe ne jemi munduar që të bëjmë politikë të kohë, kur dihet se edhe Jugosllavia ishte shtet Komunist, kur dihet se shtetin e udhëhiqte një parti politike e ajo ishte Lidhja Komuniste e Jugosllavisë.

Shqiptarët e Kosovës dhe viseve tjera shqiptare etnike asnjëherë nuk ka pasur dilema se me kë duhet të ishin, pavarësisht rrenave shoqërore dhe politike kanë qenë çdo herë për bashkim, pasi fundi i fundit edhe nuk kemi kah të shkojmë, pasi vendi i huaji është i huaji dhe nuk të pranon.

Diferencimi solli pasoja shumë të mëdha për shqiptarët në Kosovë pa dëshirën e tyre, por nga frika, një numër i shqiptarëve e ndihmuan procesin famëkeq, që e penguan mjaftë zhvillimin e proceseve normale dhe të mirëfillta sidomos në arsim, kulturë, po edhe të jetës në përgjithësi.

Mirëpo, demonstratat e protestat e vitit 1981 në Kosovë krijuan një gjeneratë të re dhe mendimin politik krejtësisht ndryshe, Të rinjtë me kërkesa politike për të drejtat kombëtare vetëdijesuan dhe ndërgjegjësuan e forcuan popullin shqiptarë në luftën e gjatë e cila nuk do të shkon shumë kohë e do të filloi. Në të njëjtën kohë bëri edhe sensibilizimin e çështjes shqiptare në Kosovë, që ishte ende i pa zgjidhur.

Një rol të rëndësishëm luajti edhe diaspora shqiptare në Evropë dhe SHBA, me organizimet e tyre dolën në mbrojtje të drejtave dhe lirisë së popullit shqiptar në Kosovë që të jenë të lirë dhe të barabartë në Jugosllavi me popujt tjerë. Diaspora shqiptare arriti ta bind opinionin e botës perëndimore për gjenocidin dhe shkeljen e të drejtave që bënë Serbia ndaj shqiptarëve dhe në një farë forme ishte ambasadore e Kosovës në botë.

Shqiptarët nuk u ndalën së vepruari duke i futur në përdorim format e punës ilegale dhe legale për të realizuar të drejtën e vet Kosova Republikë edhe pas vitit 1981 edhe përkundër vështirësive që krijonte pushtetit serb në at kohë. Ndërsa lëvizjet shtetërore serbe e kishin qëllimin që Kosovën ta fusin nën qeverisjen e saj, që ajo filloi në Kosovë një fushatë për marrjen edhe të atyre pak të drejtave që i kishin fituar me kushtetutën e vitit 1974, që ishte edhe pjesë e Federatës Jugosllave.

Lëvizjet shoviniste dhe programet serbe nga viti 1986 u intensifikuan pas publikimit të Memorandumit të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Serbisë, ku parashihej nënshtrimi i plotë i shqiptarëve dhe fuqizimi i shtetit të Serbisë.Pas ardhjes në pushtet e Millosheviqit më 1987 ishte një sinjal shumë ogurzi pasi ai ishte ngritur dhe ardhur në pushtet duke përdorur çështjen e Kosovës tek serbët që duhet të zgjidhet problemi i pa zgjidhur serb në Jugosllavi.

Grevat e minatorëve të Trepçës dhe demonstratat e fundit vitit 1988, po me theks të veçantë grevat e shkurtit të vitit 1989 nga minatorët ishin bërë mbrojtje e ruajtjes së kushtetutës e cila e cenon autonomin e fituar të Kosovës të vitit 1974.

Po ashtu edhe në mbrojtje të udhëheqësve shqiptar si Azem Vllasin dhe Kaqusha Jasharin që nga trysnia dhe presioni e frika për të rezistuar ndaj pushtetit të Serbisë u detyruan të japin dorëheqje. Këto dorëheqje u pasuan me protesta e demonstrata, greva të popullit shqiptar në Kosovë të cilët e refuzuan dorëheqjen e tyre nga funksionet në Krahinën e Kosovës të cilët e refuzuan dorëheqjet e tyre nga funksionet në Krahinën e Kosovës dhe që ishin ndryshimeve të amendamenteve kushtetuese.

Pas shumë tensioneve politika e Serbisë që ishte e mbështetur nga aparati policor-ushtarak arriti që më 23 mars të vitit 1989 t'i aprovoi ndryshimet kushtetuese, me të cilat autonomia e Kosovës u reduktua dhe mbeti një pako e pa vlerë.

Marrja e autonomisë e vështirësoi edhe më shumë jetën në Kosovë, .pasi që popullit shqiptar iu shtrëngua edhe më tepër laku në fyt, që tani ishte më lehtë të merreshin masa për zhdukjen biologjike dhe shpërnguljen e tyre nga trojet e tyre në jugosllavi. Tani shqiptarët u zhveshën tërësisht nga pjesëmarrja në qeverisje, por filluan që të orientohen në ruajtjen e qetësisë dhe ti nënshtrohen durimit, e organizimin për formimin e partive politike shqiptare apo në fillimin e krijimit të pluralizmit politik në Kosovë. Krijimi i sistemit plural në Kosovë është edhe fillim i krijimit të funksionimit të sistemit paralel në Kosovë.

Të gjitha këto lëvizje si edhe krijimi i institucioneve paralele shqiptare, kishin për qëllim zgjidhjen e çështjes së Kosovës, me politikë paqësore dhe për ndërkombëtarizimin e problemit shqiptar në botë, mirëpo, siç po shihet ideja e pacifizmit-durimit nuk po tregon mjaft qartësi e rreth zgjidhjes së këtij problemit dhe koha nuk po dëshmon se ishte terapi adekuate për rrethanat e krijuara politike në Ballkan..

## BURIMET DHE LITERATURA

A Burimet arkivore

Arkivi i Kosovës

- Fondet :
- Fondi i Komitetit Krahinor i Kosovës dhoma shoqërore-politike dhe e Komunave
- Fondi Federativ

B. Arkivi i Lëvizjes Popullore të Kosovës (LPRK-LPK-së)

C. Arkivat e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë

D. Arkiva e Gjykatës Supreme të Kosovës

E. Arkiva e gjykatës komunale Besianë

F. Arkivat private (personale)të veprimtarëve të Lëvizjes kombëtare Ilegale.

- Aktakuza e ngritur nga Prokuroria Publike ndaj grupit të Salih Salihut, Fehmi Berishës dhe Avdi Latifit nga Gjykata e Qarkut Prishtinë më 20 10. 1981

- Aktvendimi i marrë nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë kundër grupit të Bajram Ajetit, Ismet Begollit e Avdi Gjatës, më 23.05. 1984

- Aktvendim i marrë nga Gjykata Supreme në Prishtinë për vërtetimin e Aktgjykimit të shkallës së parë, kundër grupit të Nexhat Maliqit, Haradin Hysenit me shokët e tij, më 20.04 1989

- Arkivi privat i Fehmi Berishës
- Arkivi privat i Fadil Lepajës
- Arkivi privat i Ismet Begollit
- Arkivi privat i Bajram Ajetit
- Arkivi privat i Gjylë Krasniqit
- Arkivi privat i Rukije Ajvazit
- Arkivi privat i Ali Latufit etj.

**Shtypi shqiptar dhe i huaj**

Zëri i Kosovës (Zvicër)
Rilindja (Prishtinë)
Zëri i Rinis (Prishtinë)
Zëri (Prishtinë)
Bujku (Prishtinë)
Kosova sot (Prishtinë)
Koha Ditore (Prishtinë)
Epoka e Re (Prishtinë)
Zëri i Popullit (Tiranë)

**Shtypi Serb**

NIN (Beograd)
Jedinstvo (Prishtinë)
Veçerni Novosti (Beograd)
Danas ( Zagreb)

Revista shkencore :

Gjurmime Albanologjike (Prishtinë)
Kosova (Prishtinë)
Horizontet e Historisë (Prishtinë)

Studimet Historike (Prishtinë)

Alternativa Demokratike (Ljublanë)

**L i t e r a t u a :**


1. ASHRSH, ‘Studime Historike, Instituti i Historisë nr. 1-4, Tiranë. 1995
2. ASHRSH, Studime Historike, nr. 1-4, Tiranë 1997.
3. ASHRSH, Studime Historike, nr. 3-4, Tiranë. 1998.
4. ASHRSH, Studime Historike, nr. 1-2, Tiranë, 2001.
5. ASHRSH, Studime Historike, nr. 3-4, Tiranë, 2002.
6. ASHRPSSH, E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi, Tiranë 1990.
7. Agani Fehmi, Demokracia në vështrimin Enciklopedik, Tiranë 1999
8. Agani Fehmi, Imponimi i Statutit Minoritar për shqiptarët në Jugosllavi dhe kërkesat e tyre për vetëvendosje, Prishtinë 1995.
9. Aletermatt Urs Etnonacionalizmi në Evropë, Tiranë 2002.
10. Bakalli Emine, Kosova gjatë viteve 1945-1999, ligjërata të autorizuara, Prishtinë 2004.
11. Bakalli Emine, Marrëdhëniet ekonomike Shqiptare-Jugosllave 1929-1939. Prishtinë 1997.
12. Baliu Dreshaj Mirvete, Jusuf Grvalla, Prishtinë 2010.
13. Braha Shaban, Gjenocidi serbomadh dhe Qëndresa shqiptare 1844-1990, Tiranë 1991.
14. Bajrami Arsim, ‘E drejta e Kosovës në Tranzicion’, Prishtinë 2002.
15. Bashkurti Lisen, ‘Diplomacia e vetizolimit’, Tiranë 2004.
16. Baze Mero, ‘Shqipëria dhe lufta në Kosovë’ Tiranë 1999.
17. Buganjski Jonuz, Çështja e Kosovës dhe shkatërrimi i Jugosllavisë, Prishtinë 2006.
21. Buja Ramë, Çështja e Kosovës dhe shkatërrimi i Jugosllavisë, Prishtinë 2007.
22. Bytyqi Enver, E drejta e vetëvendosjes: Rasti i Kosovës, Tiranë 2007.
23. Balidemaj Naim , Tragjedia Kosovare, Prishtinë 2001.
24. Castellan Georges, Historia e Ballkanit,Tiranë 1991.
25. Glenny Misha, Historia e Ballkanit, 1804-1999, Tiranë 2077
26. Grup Autorësh, ‘Historia e Popullit Shqiptar II’, Tiranë 2002
27. Grup Autorësh, Historia e Popullit Shqiptar II, Tiranë 1965.

28. Gashi Adem, a... Zh. Vetëtimat e nëntorit Prishtinë 2005.
29. Danaj Koqo, Koha e demokracisë, apo e shpëtimit kombëtar, Zvicër 1993.
30. Gjeqovi Gjelal, Qëndrimet e shtetit shqiptar ndaj demonstratave të vitit 1981, Studimet Historike, ASHRSH nr.3-4, Tiranë 2001.
31. Çeku Ethem, Mendimi politik i lëvizjes ilegale në Kosovës 1945-1981 Prishtinë 2003.
32. Çeku Ethem, Shekulli i Ilegales, Prishtinë 2004.
33. Avdi Gjat, Bajram Kurti, Resul Bedo, Begzat Baliu, Gjaku i Lirisë 1981-1995, Prishtinë 1996.
34. Hoti Ukshin, Filozofia Politike e Çështjes Shqiptare, Prishtinë 1996.
35. Hasani Sinan, Kosova të vërteta dhe Mashtrime, Prishtinë 1986 Prishtinë.
36. Haxhiu Baton, Lufta ndryshe, Prishtinë 2088.
37. Hoxha Enver, Fjalimi në Kongresin e 8 të PPSH-së të mbajtur më 1 nëntor 1981, Tiranë.
38. Hoxha Enver, Titistët, Kombinati poligrafik, Tiranë 1977/78.
39. Hoxhaj Enver, Çështja e përgjegjësive politike, Memorandumi i Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve(1986), Prishtinë 2003.
40. Hoti Izber, Lëvizja Nacional Çlirimtare në Prishtinë dhe rrethinë, Prishtinë, 1996.
41. Hajrizi Mehmet, Sprova të çlirimit, Prishtinë 2004.
42. Horvat Branko, Kosovsko Pitanje, Zagreb 1988.
43. Jakupi Ali, Dy shtete shqiptare dhe bashkimi kombëtar, Prishtinë 1995.
44. Kohl von Christne/ Libal Wolfgang, Kosova: Nyja e Gordit në Ballkan, Prishtinë 1997.
46. Kosumi Haki, Rritja e lëvizjes ilegale në Kosovë 1981-1990 punim në dorëshkrim.
47. Kosumi Bajram, Koncepte për mendimin e ri politik, Prishtinë 2001.
48. Krasniqi Jakup, Kosova në kontekstin historik, Prishtinë 2002.
49. Krasniqi Jalup, Kthesa e Madhe-UÇK, Prishtinë 2007.
50 Krasniqi Jakup, Lëvizja për Republikën e Kosovës 1981-1991 Prishtinë 2010
51. Krasniqi Fehmi, Majasi-lugina e Kaçanollit me rrethinë 1912-2000 Prishtinë 2006
52. Lalaj Ana, Kosova rrugë e gjatë drejtë vetëvendosjes 1948 -1981, Tiranë 2000.
53. Mjeku Lulzim, Kosova neoshqiptarizma për shekullin e ri, Tiranë 1992.

54. Malkolm Noel, Kosova një histori e shkurtër, Prishtinë 2003.
55. Maliqi Shkelzen, Nyja e Kosovës (As Vllasi as Millosheviqi), Ljubljanë 1991.
56. Meier Viktor, Fundi i Jugosllavisë goditja në Kosovë, Ljublanë 2077.
57. Petifer Jemes e Miranda Vickers, Çështja shqiptare, Tiranë 1998.
58. Pireva Adil, Gjashtëdhjetëeteta shqiptare, Prishtinë 1994.
59. Pushkolli Fehmi, Llapi gjatë historisë, Prishtinë 1998.
6o. Pushkolli Fehmi, Hasan Ramadani (1948-1994), Prishtinë 2004.
61. Pllana Qerim, Metamorfozë shqiptare apo udhëkryq i ri Kombëtar, Prishtinë 1993.
62. Qosja Rexhep, Strategjia e bashkimit kombëtar, Tiranë 1998.
63. Qosja Rexhep, Popull i ndaluar, Prishtinë 1996.
64. Qosja Rexhep, Çështja shqiptare, Prishtinë 1994.
65. Qeku Hethem, Mendimi politik i ilegales shqiptare në Kosovë 1945-1981, Prishtinë 2003.
66. Qeku Ethem, Tezë doktorate, Kosova në Sfondin e Diplomacisë së Jugosllavisë dhe të Shqipërisë 1945-1981, Prishtinë 2008.
67. Rugova Ibrahim, Çështja e Kosovës, Prishtinë 1994.
68. Reka Blerim, Diplomacia preventive dhe Kosova, Prishtinë 1994.
69. Router Jens, Shqiptarët në Jugosllavi, Tiranë 1998.
70. Stavileci Esat, Rrugëtimet dhe labirintet e Kosovës dhe të shqiptarëve, Gjakovë 2009.
72. Stavileci Esat, Për Kosovën dhe çështjen shqiptare, Prishtinë 2001.
73. Syla Gani, Bashk për Liri, Prishtinë 2010.
74. Shala Blerim, Kosovo krv i suze, Ljubljana 1990.
75. Shala Blerim, Vitet e Kosovës (1988-1999), Prishtinë 2003.
76. Ukshin Sylë, Kosova dhe Perëndimi, Prishtinë 2001.
77. Veprimtaria e gruas në Lëvizjen Kombëtare për Çlirim, SHBPK, Prishtinë 2010.
78. Uruqi Dashamir, Kosova dhe e drejta e vetëvendosjes, Shkodër 2001.
79. Veliu Fazli, LPK-ja dhe UÇK-ja, Tiranë 2000.
80. Vickers Miranda, Midis serbëve dhe shqiptarëve, Tiranë 2004.
82. Zajmi Gazmend, Çështja e Kosovës një problem historik dhe aktual, Tiranë 1996.
83. Xhemaili Emrush, Lëvizja Popullore e Kosovës – 20 vjet veprimtari 1982-2002, Prishtinë 2002.

## E. F e j t o n i s t i k a

1. Koha Ditore, fejton, në përkujtim të vitit 1981, 4 prill 2006.
2. Kosova sot, Hakif Bajrami,fejton, çfarë tha udhëheqja kosovare për demonstratat vitit 1981, e hënë 15 mars 2007.
3. Zëri, fejton ekskluziv, Dokumente sekrete të Sekretariatit Federativ për punë të brendshme të RSFJ-së për Kosovën gjatë viteve 1983-1992, gazeta ditore 29 maj 2000.
4. Epoka e Re, Xhafer Durmishi, 25 vjetori i vrasjes së vëllezërve Gërvalla dhe Kadri Zekës, 25 janar 2007.
5. Epoka e Re, Ibrahim Shala Prishtinë, 22.11.2001, botuar në vazhdime, 11-16 mars 2002, Prishtinë.
6. Epoka e Re, Salih Salihu, Prishtinë, 11 mars 2002 botuar në vazhdime, 11 -15 mars 2002, Prishtinë.
7. Epoka e Re, Sabile B. Keqmezi, në 25 vjetorin e Pranverës së vitit 1981, botuar në vazhdime , 9-15 maj 2006, Prishtinë.
8 Epoka e Re, Intervistë e Driton Lajçit, ish- udhëheqës i studentëve në vitin 1997, 1 tetor 2005. Prishtinë.
9. Zëri i rinisë, tryezë e rrumbullakët e Zërit në 15 vjetorin e demonstratave të vitit 1981, flasin Mehmet Hajrizi, Bajram Kosumi,Merxhan Avdyli, Ali Lajçi. 23-30 mars 1996, Prishtinë.

**Territori ku jetojnë shqiptarët**

© Pashtriku.org, Shkurt 2015